Në detyrimet e prapambetura të lindura në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshihen vetëm detyrimet për punimet e kryera por të papaguara në kuadër të financimeve nga fondi për zhvillimin e rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, që nuk perfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njesive të vetëqeverisjes vendore.

Me vendim te Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder” Bashkia Shkoder, jane miratuar detyrimet e trasheguara nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata, me fondet perkatese te tyre. Kjo procedure eshte ndjeke, në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”

Ne detyrimet e prapambetura, te mbartura nga ish-komunat ka edhe procedura me parregullsi ligjore dhe financiare, te pamundura te likuidohen, te cilat do te jene objekt shqyrtimi, ne zbatim te rekomandimeve te lena ne raportin perfundimtar te KLSH-se nr 491/15, date 30.11.2017.

Gjate vitit 2017, Bashkia Shkoder, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.4540 Prot, datë 05.04.2017, nr.10442 prot, datë 04.07.2017, nr.14767 prot, datë 04.10.2017, me nr.132 prot, datë 04.01.2018 per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura te trasheguara nga zbatimi i reformes territoriale.

Gjatë 12-mujorit të vitit 2017, Bashkia Shkoder ka shlyer investime, detyrime të prapambetura ne total 135 milion lekë, të përbëra si më poshtë:
Investime në vlerën 81,914 mijë lekë.
Investimet nga FZHR në shumën 27,047 mijë lekë.
Mallra dhe Shërbime në vlerën 23,999 mijë lekë.
Vendime gjyqësore në vlerën 1,994 mijë lekë.
Të tjera në vlerën 4 mijë lekë.
Në detyrimet e prapambetura kryesisht peshën më të madhe e zënë Investimet prej rreth 33 milion lekë, Investime nga FZHR rreth 15 milion lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth 32 milion lekë.

**Të ardhurat e veta vendore**

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, te ardhurat te tjera dhe donacione. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë vitit 2017 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efiçencë të aseteve të veta, implementimit të proçedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të proçedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuara në lehtësimin maksimal fiskal, kane ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, përmisëm duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpermjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshem të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, jane ulja e taksave të banesave, nivele deri në mimimumin ligjor të lejuar për taksat e ndërtesave për të gjithë bizneset, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulantët etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevoje, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojne etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë,por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Keto politika të lehtesive fiskale kundrejt përmiresimit të shërbimit janë shoqeruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Objektiv i rendesishem gjate vitit 2017 ka qene krijimi i regjistrave të sakte të kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye u fuqizuan më tej strukturat e

konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesore të të ardhurave.

Kështu, të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar duke përmbushur pritshmëritë referuar kapaciteteve të planifikuara.

Objektivi kryesor për sigurimin dhe rritjen e të ardhurave në krahasim me vitin e kaluar u plotësua, duke realizuar 105,879 mijë Lekë më shumë të ardhura se vitin e kaluar, ose 21% më shumë.

Gjithashtu përgjatë vitit 2017 është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e arkëtimeve, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Të ardhurat e veta u realizuan në proçes dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorittë bashkisë.

**Kategorizimi i të ardhurave**

- Taksat vendore:
    - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
    - Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
    - Taksa e fjetjes në hotel
    - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
    - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ZRPP
    - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, agjent DRShTRr
    - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare agjent DRT
    - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri ne 8 milion, agjent DRT

- Tarifat vendore
    - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
    - Tarifa për ndriçimin publik
    - Tarifa për gjelbrimin
    - Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër
    - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
    - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
    - Tarifa për zënien e hapësirave publike

- Të ardhura të tjera:
    - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
    - Të ardhura nga gjoba
    - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e mallrave dhe e sherbimeve etj

**Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore**

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2017 u realizuan në vlerën 612.033 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat me 55% dhe të ardhurat nga tarifat me 40% të totalit.

| **Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore /000 lekë** | **612,033** |
|---|---|
| Të ardhura nga taksat | 335,302 |
| Të ardhura nga tarifat | 241,839 |
| Të ardhura nga burime të tjera vendore | 34,892 |




**Cash Flow i të ardhurave, sipas muajve**

Grafiku i të ardhurave fluide paraqet në baze mujore të ardhurat gjatë vitit 2017.




| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ardhura | 16,212 | 20,096 | 30,467 | 40,688 | 53,585 | 129,45 | 46,702 | 77,717 | 59,989 | 35,086 | 57,790 | 44,243 |

Referuar arkëtimive të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Qershor, periudhë e përcaktuar për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi.

Gjithashtu ka një rritje natyrale në muajin Gusht si efekt i sezonit turistik në plazhin Velipojë, dhe një rritje në fund të vitit falë efektit të masave shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore, afrimit të afatit për përfitimin nga amistia fiskale, dhe arkëtimet në zërin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga kontrollet e ushtruara nga Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit të bashkisë Shkodër.

Falë fokusimit për zgjerim të mëtejshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj.,të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant arkëtimeve, duke siguruar kështu fluiditet financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

**Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin**

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Bashkia Shkodër | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **621,886** | **612,033** | **98%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **343,004** | **335,302** | **98%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 7,250 | 4,528 | 62% |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 250 | 214 | 85% |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 126,374 | 112,893 | 89% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 94,946 | 96,875 | 102% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 21,496 | 4,478 | 21% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 9,932 | 11,541 | 116% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 10,914 | 14,460 | 132% |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 124,000 | 129,066 | 104% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 6,500 | 8,010 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 51,000 | 49,166 | 96% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 60 | 31 | 51% |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 16,656 | 16,934 | 102% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **260,181** | **241,838** | **93%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 140,860 | 133,038 | 94% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 28,344 | 29,754 | 105% |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 19,995 | 21,627 | 108% |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 51,323 | 40,499 | 79% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 10 | 32 | 0% |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 100 | 59 | 59% |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 1,535 | 1,912 | 125% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 3,739 | 4,596 | 123% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 600 | 200 | 33% |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 200 | 302 | 151% |
| Tarifa nga MKZ | 1,925 | 1,366 | 71% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 41,714 | 32,032 | 77% |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 1,500 | 0 | 0% |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 19,659 | 16,920 | 86% |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **18,701** | **34,892** | **187%** |

Tabela e mëposhtme pasqyron në përqindje realizimin e të ardhuravenë raport me planin, sipas secilës Njësi Administrative




Zërat kryesorë që janë me tejkalim në krahasim me e planin e vitit 2017 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, të

ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhurat nga taksa e e kalimit të drejtës së pronësisë, të ardhurat nga taksa e tabelës, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik, të ardhura nga tarifa e gjelbërimit, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimeve të rezervuara, të ardhurat nga kamatvonesat për subjektet dhe të ardhurat nga gjobat e IMT-së.

Të ardhurat për këto zëra janë me tejkalim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguese, si efekt i rritjes së kontrollit në terren, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të takapagueve, rritjes së numrit të aplikimive për leje ndërtimit etj.

Zërat ndikues me mosrealizim të plotë janë taksa e tokës bujqësore dhe tarifa e zënies së hapësirës publike, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin taksa e tokës bujqësore vijon të ketë nivele të ulëta arkëtimi, dhe klimës jo të mirë që po kalon biznesi aktualisht ka reflektuar në rënien e aplikimeve për zënies e hapsirës publike. Si masë për rritjen e të ardhurave nga kjo tarifë është propozuar dhe miratuar një nivel më i ulët i tarifës për zona me interes më të ulët.

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit të të ardhurave për kategorite e taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera në lidhje me arkëtimin.




Diferenca në kategorinë e tarifave nga disa institucine të varësisë, nga tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike, dhe nga disa tarifa të shërbimit administrativ, plotësohen nga të ardhurat nga tarifa të tjera, ndërsa zëri i taksave vendore është realizuar.




Grafiku paraqet raportin e të ardhurave me planin për secilën Njësi Administrative më vehte.

Tabelat ne vijim paraqesin në mënyrë të detajuar zërat e veçantë të të ardhurave të realizuara në lidhje me planin për vitin 2017, për seicilën Njësi Administrative, në vlera mijë Lekë.

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Qyteti | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **428,233** | **465,934** | **109%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **233,810** | **246,896** | **106%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 6,375 | 3,972 | 62% |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 250 | 214 | 85% |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 74,427 | 78,686 | 106% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 68,775 | 71,643 | 104% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 0 | 0 | 0% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 5,652 | 7,043 | 125% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 1,500 | 1,947 | 130% |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 107,480 | 105,260 | 98% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 4,550 | 5,607 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 25,500 | 35,439 | 139% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 31 | 100% |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 13,728 | 15,741 | 115% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **180,653** | **194,395** | **108%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 109,882 | 117,385 | 107% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 27,938 | 29,047 | 104% |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 19,580 | 20,943 | 107% |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 11,649 | 10,099 | 87% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 10 | 32 | 320% |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 100 | 59 | 59% |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 1,423 | 1,283 | 90% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 3,402 | 3,448 | 101% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 600 | 100 | 17% |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 0 | 302 | #DIV/0! |
| Tarifa nga MKZ | 1,590 | 1,213 | 76% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 3,024 | 3,662 | 121% |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 1,500 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 11,604 | 16,920 | 146% |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **13,771** | **24,643** | **179%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Postribë | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **12,315** | **8,135** | **66%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **7,564** | **4,812** | **64%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 125 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 2,869 | 3,136 | 109% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 1,394 | 1,561 | 112% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 1,104 | 1,355 | 123% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 372 | 220 | 59% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 76 | 6% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 195 | 240 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 3,060 | 1,297 | 42% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 135 | 63 | 47% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **4,410** | **2,105** | **48%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 3,492 | 1,930 | 55% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 112 | 175 | 156% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 21 | 95 | 452% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 65 | 172% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 25 | 15 | 60% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 8 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 806 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **341** | **1,218** | **357%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Guri i Zi | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **16,470** | **6,647** | **40%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **10,601** | **4,578** | **43%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 250 | 52 | 21% |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 4,281 | 1,922 | 45% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 1,659 | 1,385 | 84% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 2,422 | 249 | 10% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 200 | 288 | 144% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 121 | 10% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 195 | 240 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 3,570 | 2,166 | 61% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 1,125 | 77 | 7% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **5,527** | **1,957** | **35%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 4,592 | 1,605 | 35% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 129 | 352 | 272% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 21 | 179 | 855% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 167 | 440% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 25 | 5 | 20% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 25 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 806 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **342** | **112** | **33%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Bërdicë | | |
|---|---|---|---|
| **LLOJET E TE ARDHURAVE** | **Plan** | **Realizim** | **%** |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **17,885** | **23,814** | **133%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **12,120** | **18,678** | **154%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 115 | #DIV/0! |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 7,147 | 2,814 | 39% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 2,452 | 1,544 | 63% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 3,920 | 684 | 17% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 776 | 586 | 76% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 13,430 | 1138% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 245 | 302 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 2,805 | 1,710 | 61% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 743 | 307 | 41% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **4,954** | **3,147** | **64%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 4,020 | 2,474 | 62% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 128 | 673 | 527% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 20 | 200 | 1028% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 434 | 1143% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 25 | 38 | 152% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 25 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 806 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **812** | **1,990** | **245%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Velipojë | | |
|---|---|---|---|
| **LLOJET E TE ARDHURAVE** | **Plan** | **Realizim** | **%** |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **92,771** | **79,800** | **86%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **41,981** | **40,864** | **97%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 500 | 162 | 32% |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 18,120 | 19,773 | 109% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 14,334 | 16,583 | 116% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 1,499 | 633 | 42% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 2,287 | 2,557 | 112% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 9,400 | 12,487 | 133% |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 9,440 | 6,023 | 64% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 395 | 487 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 3,825 | 1,531 | 40% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 301 | 402 | 134% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **50,080** | **33,700** | **67%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 9,682 | 3,618 | 37% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 406 | 707 | 174% |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 415 | 684 | 165% |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 38,772 | 28,691 | 74% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 5 | 0 | 5% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 62 | 293 | 477% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 130 | 71 | 54% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 38,556 | 28,327 | 73% |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 805 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **710** | **5,236** | **737%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Dajç | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **14,412** | **5,002** | **35%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **11,169** | **3,331** | **30%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 118 | #DIV/0! |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 6,418 | 1,869 | 29% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 1,745 | 974 | 56% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 4,482 | 779 | 17% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 191 | 116 | 61% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 195 | 240 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 3,315 | 1,103 | 33% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 61 | 0 | 0% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **2,902** | **1,653** | **57%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 1,981 | 1,443 | 73% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | 100% |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 116 | 210 | 181% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 3 | 72 | 2410% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 32 | 85% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 100 | 100% |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 30 | 5 | 17% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 25 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 805 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **341** | **19** | **5%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Ana e Malit | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **9,773** | **3,954** | **40%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **7,127** | **2,755** | **39%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 50 | #DIV/0! |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 3,186 | 1,263 | 40% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 734 | 733 | 100% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 2,254 | 413 | 18% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 198 | 117 | 59% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 74 | 6% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 195 | 240 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 2,295 | 903 | 39% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 270 | 225 | 83% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **2,305** | **1,176** | **51%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 1,384 | 1,122 | 81% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 115 | 53 | 46% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 2 | 41 | 2753% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 7 | 18% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 30 | 5 | 17% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 25 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 806 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **342** | **24** | **7%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Rrethina | | |
|---|---|---|---|
| **LLOJET E TE ARDHURAVE** | **Plan** | **Realizim** | **%** |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **22,241** | **17,053** | **77%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **14,758** | **11,840** | **80%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 41 | #DIV/0! |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 8,714 | 3,019 | 35% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 3,672 | 2,089 | 57% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 4,799 | 363 | 8% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 243 | 567 | 233% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 14 | 18 | 126% |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 1,180 | 4,083 | 346% |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 245 | 302 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 4,335 | 4,259 | 98% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 270 | 119 | 44% |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **6,417** | **3,583** | **56%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 5,461 | 3,388 | 62% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 150 | 195 | 130% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 42 | 10 | 24% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 38 | 127 | 335% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 25 | 14 | 56% |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 25 | 44 | 173% |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 806 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **1,067** | **1,631** | **153%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Pult | | |
|---|---|---|---|
| **LLOJET E TE ARDHURAVE** | **Plan** | **Realizim** | **%** |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **2,051** | **481** | **23%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **760** | **472** | **62%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 147 | 97 | 66% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 101 | 89 | 88% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 39 | 0 | 1% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 7 | 8 | 113% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 95 | 117 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 510 | 258 | 51% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 8 | 0 | |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **966** | **9** | **1%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 110 | 9 | 8% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 51 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 0 | 0 | |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 16 | 0 | |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 15 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 0 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 805 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **325** | **0** | **0%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Shosh | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **2,663** | **274** | **10%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **1,418** | **248** | **17%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 550 | 51 | 9% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 59 | 45 | 76% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 489 | 2 | 0% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 3 | 4 | 139% |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 95 | 117 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 765 | 80 | 11% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 8 | 0 | |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **920** | **25** | **3%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 64 | 18 | 29% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 51 | 7 | 13% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 0 | 1 | #DIV/0! |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 16 | 6 | 34% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 15 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 0 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 805 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **325** | **1** | **0%** |

| Të Ardhurat e veta v. 2017 | Shalë | | |
|---|---|---|---|
| LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan | Realizim | % |
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **3,010** | **938** | **31%** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | **1,637** | **829** | **51%** |
| Të Ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 0 | 19 | |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 514 | 264 | 51% |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 21 | 230 | 1077% |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | 489 | 1 | 0% |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 4 | 34 | |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 0 | 9 | |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 95 | 117 | 123% |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 1,020 | 420 | 41% |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 8 | 0 | |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | **1,049** | **89** | **9%** |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 193 | 44 | 23% |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 0 | 0 | |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 0 | 0 | |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër | 51 | 46 | 89% |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 0 | 30 | 0% |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 16 | 16 | 100% |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 0 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 20 | 0 | |
| Tarifa nga MKZ | 15 | 0 | |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 0 | 0 | |
| Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore | 0 | 0 | |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 805 | 0 | |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | **325** | **19** | **6%** |

**Realizimi i të ardhurave 2017, krahasuar me vitet e kaluara**

| /000 Lekë | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | *Rritja me v. 2016* |
|---|---|---|---|---|
| **Të ardhura nga Taksat** | 302,050 | 250,258 | 335,302 | *85,044* |
| **Të ardhura nga Tarifat** | 166,932 | 238,043 | 241,838 | *3,795* |
| **Të ardhura jotatimore** | 13,872 | 17,852 | 34,892 | *17,040* |
| **Totali** | **482,854** | **506,154** | **612,033** | ***105,879*** |

Krahasuar me vitin 2016, realizimi i të ardhurave ka një rritje të dukshme me rreth 105.879 mije Lekë, ose **21 % rritje të të ardhurave nga viti i kaluar**, ndërsa krahasuar me të ardhurat e vitit 2015 (përfshirë realizimin nga ish-komunat), ka një rritje me rreth 129,179 mijë lekë, ose 27% rrije nga viti 2015.

Krahas te ardhurave te depoziatuara prane Bashkise Shkoder, Federata Shqiptare e Volejbollit (Institucioni Federata të tjera) në shkresen nr. prot. 230 me datë 02.11.2017 me qëllim "Shpërblim për ekipin fitues të volejbolli" ka transferuar shumën 200. 000 mijë lek në Degën e Thesarit Shkodër, per llogari te institucionit Sport Klub Vllaznia.

**Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë nga viti në vit.**

**Taksa e Ndërtesës**




Në përputhje me programin e kryetarit të bashkisë, taksa e ndërtesës është ulur deri në nivelin e lejuar ligjor, minus 30% nga referenca e përcaktuar ne ligjin për taksat vendore.

Edhe pse janë aplikuar lehtësi fiskale incentivues, falë zgjerimit të bazës taksapaguese, krahasuar me vitin 2016, taksa e ndërtesës ka rritur dukshëm nivelin e arketimit me +21%. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 2.658 mijë Lekë nga nga banesat, dhe 2.840 mijë Lekë ndërtesat për qëllime biznesi, me një total rritjeje prej 5.499 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.

Zgjerimi i bazës taksapaguese ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë.

**Tatim fitimi i biznesit të vogël**

Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.

Pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore", që pati si efekt heqjen e tatatimit të thjeshtuar të biznesit të vogël me xhiro nga 0 deri ne 5 milion Lekë, që nga viti 2016 e në vazhdim për qeverisjen vendore u zvogëlua mundësia e krijimit të ardhurat e përvitshme nga ky zë.




Vlera e arkëtuar nga agjenti tatimor në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 është 6 herë më e vogël, me një efekt të konsiderueshëm tek të ardhurat e bashkisë me vlerë -66.198 mijë Lekë. Edhe gjatë vitit 2017 arkëtimet nga agjenti tatimor për këtë taksë pësuan rënie krahasur me vitin e kaluar me minus -8.047 mijë Lekë.

**Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**




Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin 2016 kjo taksë ka një rritje të konsiderueshme në arkëtim me +77,411 mijë Lekë, si rezultat i kërkesave në rritje për ndërtimeve, rritje së kontrolleve në terren nga ana e Inspektoriatit Ndëtimor Vendor, sqarimit të aplikuesve për ndryshimet ligjore, proçeduriale, si dhe trajtimin në kohë të kërkesve.

**Taksa e hotelit**

Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë. Rritja kryesore e të ardhurave të vitit 2017 me një vlerë prej +3,549 mijë Lekë ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të bazës taksapaguese, monitorimeve dhe verifikimeve të herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve ne terren, lehtësimit të arkëtimit në bazë mujore, etj.



**Taksa mbi truallin**




Detyrimi i taksës mbi truallin për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë te Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor.

Krahasuar me vitin e kaluar, arkëtimet gjatë vitit 2017 nga kjo taksë kanë rritje prej +2,623 mijë Lekë, ose rreth 29%.

**Taksa mbi tokën bujqësore**

Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqesorë është ulur me 30%, pra deri në nivelin e lejuar të refencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve.




Rritja e të ardhurave ka ardhur si efekt edhe i proçedurave të verifikimit të kapaciteteve, të ndjekjes së detyrime, bashkrendimit të punës ndërmjet Nj.A, drejtorisë së bujqësisë, agjentit tatimor, zyrave me një ndalesë etj. Si rezultat u arrit që krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat nga kjo taksë të kenë një rritje prej +1,166 mijë Lekë, ose +35%.

**Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë**




Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor. Taksa vendoset nga agjenti tatimor i cili ia tranferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me +1,784 mijë Lekë, ose +29%. Rritja e të ardhurave lidhet me rritjen e procedurave të tjetërsimit të

pronës të kryera nga individë dhe biznese që aplikojnë pranë agjentit.

**Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**

Në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" të ndryshuar, përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë




Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë +1,015 mijë lekë, ose +2%, që është krijuar si realizultat i rritjes së numrit të automjeteve që aplikojnë për regjistrim pranë zyrave te DRShTRr.

**Taksa e Tabelës**




Taksa e tabelës për qëllime reklamimi, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej +340 mijë Lek, ose +2%.

Rritja ka ardhur si rezultat i zgjerimit të bazës takapaguese, evidentimit dhe krijimit në kohë të bazës së të dhënave, verifikimit në terren të kapaciteteve fiskale, si dhe rritjes së aplikimeve.

**Tarifat e Pastrimit, Ndriçimit dhe Gjelbrimit**

Tarifat vjetore që janë arkëtuar nga biznesi për vitin arrijnë në total vlerën e 112,236 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +6,323 mijë Lekë më shumë, ose +6%, që vjen si rezultat i zgjerimit të bazës taksapaguese, si dhe i nxitjes dhe ndjekjes së proçedurave ligjore ndaj subjekteve debitore.

Gjithashtu edhe të ardhurat me vlerë 72,183 mijë Lekë nga tarifat vjetore



të familjeve kanë një rritje krasuar me vitin e kaluar me vlerë +6,097, ose + 9%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i krijimit të mundesive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore, nxitjes dhe sensibilizimit ndaj shlyerjes së detyrimit kundrejt politikave lehtësuese sociale dhe shërbimit të standartizuar referuar perkatësisht çdo tarife, etj.

**Tarifa e parkingut të rezervuar**




Tarifa e parkingut ka pasur rritje në arkëtim krahasuar me vitin e klaur me një vlerë prej +175 mijë Lekë, ose +3%, kryesisht nga rritja e numrit të kërkesave të subjekteve për shfrytëzimin e sipërfaqeve për parkingje të rezervuara si dhe rritjes së numrit të subjekteve të trasportit të shërbimit publik ose privat, që e kanë të përcaktuar zonën e parkimit ose vendodhjen stacionare të autobuzave dhe taksive.

**Të ardhurat nga tarifa e shfrytëzimit të hapësirave publike**

Gjatë vitit 2017 janë arkëtuar rreth 32,032 mijë Lekë nga tarifa e shfrytëzimit të hapësirave publike. Krahasuar me vitin e kaluar, arkëtimet kanë një rënie prej -8,188 mijë lekë, ose -20%, si rezultat i rënies së numrit të aplikimeve për shfrytëzim.

Rreth 88% e të ardhurave nga kjo tarifë u realizua në Plazhin Velipojë.




Kjo e ardhur e konsiderueshme për bashkinë u arrit falë evidentimit të vazhdueshëm të potencialit të kapaciteteve dhe aseteve, formalizimit transparent të marrëdhënieve me bizneset taksapaguese, krijimit të proçedurave të sakta e të thjeshta, si dhe shfrytëzimit efikas dhe në kohë të hapësirave publike kryesisht ranore.

**Të ardhura nga institucionet e varësisë**

Pavarësisht se këto institucione nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave, nëpërmjet grumbullimit të tyre dhe gjetjen e burimeve të reja, ato lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve.




Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë pasur tendencë uljeje ose zerimi kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studenë, grupe rinore etj., gjithsesi falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet i ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2017 janë krijuar rreth 16,920 mijë Lekë të ardhura.

## Analiza e peshës specifike të secilës Njësi Administrative në realizimin e të ardhurave

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2017, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik.

**Realizimi i të ardhurave viti 2017, sipas kategorive dhe njësive**

| LLOJET E TE ARDHURAVE | Qendër | Postribë | Guri i Zi | Bërdicë | Velipojë | Dajç | Ana e Malit | Rrethina | Pult | Shosh | Shalë | Bashkia Shkodër |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ** | **465,934** | **8,135** | **6,647** | **23,814** | **79,800** | **5,002** | **3,954** | **17,053** | **481** | **274** | **938** | **612,033** |
| **TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE** | 246,896 | 4,812 | 4,578 | 18,678 | 40,864 | 3,331 | 2,755 | 11,840 | 472 | 472 | 829 | 335,302 |
| Të Ardhura nga tatimi thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 3,972 | | 52 | 115 | 162 | 118 | 50 | 41 | | | 19 | 4,528 |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e praprambetur) | 214 | | | | | | | | | | | 214 |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 78,686 | 3,136 | 1,922 | 2,814 | 19,773 | 1,869 | 1,263 | 3,019 | 97 | 97 | 264 | 112,893 |
| Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 71,643 | 1,561 | 1,385 | 1,544 | 16,583 | 974 | 733 | 2,089 | 89 | 89 | 230 | 96,875 |
| Të Ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore | | 1,355 | 249 | 684 | 633 | 779 | 413 | 363 | 0 | 0 | 1 | 4,478 |
| Të ardhura nga taksa mbi truallin | 7,043 | 220 | 288 | 586 | 2,557 | 116 | 117 | 567 | 8 | 8 | 34 | 11,541 |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 1,947 | | | | 12,487 | | | 18 | | | 9 | 14,460 |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 105,260 | 76 | 121 | 13,430 | 6,023 | | 74 | 4,083 | | | | 129,066 |
| Të ardhura nga garanci financiare | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 5,607 | 240 | 240 | 302 | 487 | 240 | 240 | 302 | 117 | 117 | 117 | 8,010 |
| Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 35,439 | 1,297 | 2,166 | 1,710 | 1,531 | 1,103 | 903 | 4,259 | 258 | 258 | 420 | 49,166 |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 31 | | | | | | | | | | | 31 |
| Të ardhura nga taksa e tabeles | 15,741 | 63 | 77 | 307 | 402 | 0 | 225 | 119 | | | | 16,934 |
| **TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE** | 194,395 | 2,105 | 1,957 | 3,147 | 33,700 | 1,653 | 1,176 | 3,583 | 9 | 9 | 89 | 241,838 |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 117,385 | 1,930 | 1,605 | 2,474 | 3,618 | 1,443 | 1,122 | 3,388 | 9 | 9 | 44 | 133,038 |
| Te ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 29,047 | | | | 707 | | | | | | | 29,754 |
| Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 20,943 | | | | 684 | | | | | | | 21,627 |
| Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë | 10,099 | 175 | 352 | 673 | 28,691 | 210 | 53 | 195 | | | 46 | 40,499 |
| Të ardhura nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 32 | | | | | | | | | | | 32 |
| Të ardhura nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura | 59 | | | | | | | | | | | 59 |
| Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 1,283 | 95 | 179 | 200 | 0 | 72 | 41 | 10 | | | 30 | 1,912 |
| Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike | 3,448 | 65 | 167 | 434 | 293 | 32 | 7 | 127 | | | 16 | 4,596 |
| Tarifë liçensa tregtimi naftës bruto dhe nënprodukteve | 100 | | | | | 100 | | | | | | 200 |
| Të ardhura nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 302 | | | | | | | | | | | 302 |
| Tarifa nga MKZ | 1,213 | 15 | 5 | 38 | 71 | 5 | 5 | 14 | | | | 1,366 |
| Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 3,662 | | | | 28,327 | | | 44 | | | | 32,032 |
| Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj | 16,920 | | | | | | | | | | | 16,920 |
| **TE ARDHURA TE TJERA** | 24,643 | 1,218 | 112 | 1,990 | 5,236 | 19 | 24 | 1,631 | 0 | 0 | 19 | 34,892 |

Sic shihet në grafikun bashkangjitur, pesha kryesore në realizimin e të ardhura për vitin 2017 mbulohet nga Njësia Administrative qendër (qytet) me 76% të totalit të të ardhurave, dhe nga Njësia

Administrative Velipojë me 13% zënë së bashku 89% të të ardhurave të veta. Njësitë e tjera së bashku kanë arkëtuar rreth 11% të të ardhurave të veta të bashkisë.




**Pesha specifike e zërave kryesorë sipas të ardhurave të krijuara**

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2017 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 22% të të ardhurave të veta, taksa e ndikimit në infrastrukturë 21%, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesat me 16%, taksa vjetore e mjeteve te përdorura 8%, tarifa për zënien e hapësirës publike 5%, tarifa e ndriçimit publik 5%, tarifa e gjelbrimit 4%, taksa e tabelës 3%, tarifa nga institucionet e varësisë me 3%, taksa e fjetjes në hotel 2, gjobat 2%, etj.



## P1 Programi i Administratës Vendore

Mbështetja e programit të Adminsitratës Vendore ka për qëllim krijimin dhe mbështetjen në vazhdimësi të një strukture menaxhuese sa më cilësore e funksionale, që të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë. Përthithja e burimeve njerëzore profesionale në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës ka qenë pjesë e rëndësishme e punës gjatë vitit 2017. Në fokus të Bashkisë së Shkodrës kanë qenë formalizimi dhe përmirësimi i punës dhe shërbimeve administrative, dhe rritja e transparencës.

- Qeverisja vendore në bashkinë Shkodër, për periudhën Tetor 2016 – Maj 2017, është vlerësuar e mirë.
- Të katër treguesit: Efektiviteti & Efiçenca, Llogaridhënia,Transparenca & Sundimi i Ligjit dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në vlerësimin total janë vlerësuar si të mira në Bashkinë Shkodër.
- Efektiviteti dhe Efiçenca është vlerësuar në total si e mirë dhe vëmë re se nënkriteret e këtij dimensioni kanë marrë një vlerësim të mirë.
- Menaxhimin Financiar është vlerësuar shumë i mirë në të gjitha hallkat përbërëse të tij;
- Vendimmarrja e Informuar është vlerësuar e mirë (vlerësimin mesatar e ka marrë përdorimi i platformës GIS; Vleresim shumë të mirë e ka marrë sistemi i raportimit të Bashkisë Shkodër).
- Performanca e bashkisë në bashkëpunimet e saj me donatorët, komunitetin apo institucionet ndërkombëtare eshte vleresuar e mirë, duke e karakterizuar si një bashkëpunim produktiv.
- Shërbimet publike si tregues është vlerësuar në total i mirë. Nga karta e raportimit të qytetarëve kemi vlerësim mesatar në lidhje me masën e kënaqesisë nga marrja e këtyre shërbimeve, ndërkohë që barazia gjinore në qasjen e këtyre shërbimeve ka marrë vlerësim shumë të mirë. Të gjitha pikat e tjera përbërëse të këtij nën-niveli janë vlerësuar si të mira.
- Pjesëmarrja qytetare është vlerësuar e mirë në Bashkinë Shkodër.
- Kuadri institucional ka marrë vlerësimin më të mirë, përkundër vlerësimit mesatar që u është akorduar përfshirjes së palëve të interesuara si dhe pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar.
- Sistemi i buxhetimit me pjesëmarrje është vlerësuar shumë mirë, përkundër vlerësimit mesatar të strukturave të lindura nga iniciativat e qytetarëve në Shkodër.
- Niveli i angazhimit qytetar është vlerësuar mesatar
- Ekzistenca e një platforme efektive dialogu që siguron përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes është vlerësuar e mirë.
- Transparenca dhe Sundimi i Ligjit është vlerësuar i mirë.Informacioni transparent është vlerësuar i mirë dhe i arritshëm. Faqja online web dhe përditësimi është vlerësuar shumë mirë. Transparenca e procedurave administrative është vlerësuar shumë mirë. Karta e raportimit të qytetarve është është vlerësuar në nivelin mesatar.
- Sundimi i ligjit është vlerësuar i mirë në total si edhe në çështjet përbërëse të tij. Perceptimi për nivelin ekorrupsionit është vlerësuar me nivelin mesatar.
- Egzistenca e politikave, strategjive apo planit të veprimit në nivel vendor që lidhet me luftën kundër korrupsionit, është vlerësuar në nivelin mesatar.
- Llogaridhëna ka marrë vlerësim të mirë si kriter i qeverisjes vendore të Bashkisë Shkodër. Mekanizmat e kontrollit janë vlerësuar të mira. Vlerësimin më të lartë, si shumë të mirë e ka marrë ndjekja e rekomandimeve të KLSH-së.
- Komunikimi dhe reagimi në Bashkinë Shkodër na paraqitet si i mirë.
- Përgjigjshmëria e administratës vendore raportohet me një vlerësim total shumë të mirë, ku përgjigjshmëria e kërkesave të komunitetit dhe mesatarja e ankesave të trajtuara plotësisht na paraqiten si shumë të mira.

- Reagimin e pushtetit vendor ndaj ankesave është vlerësuar mesatar, arsye kjo edhe e përqindjes së ulët të qytetarëve të cilët edhe pse kanë patur arsye, nuk kanë paraqitur një ankesë në Bashkinë Shkodër.
- Pozicionimi i Bashkisë Shkodër për të gjitha kriteret e vlerësuara është më i lartë se mesatarja e 61 Bashkive.

Programi për vitin 2017 ka mbështetur disa projekte dhe aktivitete në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara.

## I Pershkrimi i funksioneve dhe objektivave

Funksion i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është :

F1. Administrata vendore

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2017 kanë qenë:

F1.O1 Burime njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive.

F1.O2 Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës

F1.O3 Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre

## II Produktet për vitin 2017

**Aktivitetet dhe projektet që u realizuan për v.2017 janë:**

**P1.F1.O1.A1** Ndërtim i administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administatës së Bashkisë Shkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me 367 punonjës nga këto: 1 i zgjedhur,15 të emëruar politikë, 24 punonjës të policisë bashkiake,15 punonjës të njësisë së menaxhimit të qendrave komunitare,12 punonjës IMT, 201 nëpunës civilë dhe 99 punonjës mbështetës dhe administrativë;

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit,

institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit"; i ndryshuar. Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

**P1.F1.O1.A2** Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Ky aktivitet synonte rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve : personel i ri i rekrutuar (23 punonjës me status të nepunesit civil, 23 punonjes mbeshtetes dhe administrativ ,1 ankesë gjate procesit te rekrutimit nder 23 procese rekrutimi Një ndër detyrat më të rëndësishme të programit Administrim, Menaxhim dhe Planifikim është plotësimi i strukturës organizative me staf të kualifikuar në përmbushje të detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune. Numri i aplikuesve për vendet e shpallura ishte rreth 40 aplikues. Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive". Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit kane qenë punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Shkodër.

**P1.F1.O1.A3** Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës

Ky aktivitet synonte që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryenin trajnime në institucione të tjera trajnuese me inisiativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar shumë trajnime si: trajnime të vijueshme profesionale të audituesve të brendshëm, , trajnime mbi arkivat për stafin e administratës, trajnim të punonjësve të saporekrutuar për detyrat dhe përgjegjësite e pozicioneve të punës, për realizimin e objektivave të drejtorive përkatëse etj,. Këto trajnime janë realizuar me mbështetjen e Bashkisë Shkodër dhe të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

**P1.F1.O2.A1** Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë

Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj.

**P1.F1.O2.A2** Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Shkodrës

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

**P1.F1.O2.A3** Shërbim higjeno-sanitar për administratën e Bashkisë së Shkodrës

Janë krijuar dhe siguruar ambjentet e punës sipas standarteve higjeno – sanitare në funksion të përmbushjes së kushteve të punës.

**P1.F1.O2.A4** Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike, dhe paisje të tjera shtesë) Gjatë vitit 2017 janë realizuar blerja e materialeve hidraulike, elektrike dhe bojera për lyerje.

**P1.F1.O2.A5** Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës. Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave. U dërguan për kontroll teknik në servis të gjitha mjeteve dhe u përcaktuan nevojat emergjente të atyre mjeteve që duhet të riparoheshin .U realizua shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet , si blerja e pjesëve të ndërrimit për këto mjete, shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

**P1.F1.O2.A6** Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja

Shërbimi për organizimin e pritje përcjelljeve synonte garantimin e standartit të shërbimeve të pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve për rreth 150 persona dhe pranimit të ftesave për bashkëpunim me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar dhe është realizuar në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Duke qenë shpesh herë inisiatorë të takimeve të ndryshme me qëllim forcimin e partneritetit, Bashkinë Shkodër e vizituan delegacione të shumta dhe përfaqësues të institucioneve homologe të nivelit lokal, rajonal, dhe ndërkombetar dhe u arrit realizimi i tyre sipas standarteve . Në këtë projekt ishte i përfshirë edhe organizimi i një darke tradicionale për rastin e festave fetare ( Darka për Iftar ), e cila u realizua me procedurë prokurimi.

**P1.F1.O2.A7**Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë. Sherbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë ishte i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësimit të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, workshop-e brenda dhe jashtë vendi . Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.

**P1.F1.O2.A8** Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar blerja e paisjeve të reja si tavolina,karrike ,etazherë, grrila dhe kondicionerë në shërbim të administratës vendore.

**P1.F1.O2.A9** Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik. Janë siguruar 11 ndërtesat dhe inventari ekonomik për vitin 2017.

**P1.F1.O2.A10** Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës. Janë përmirësuar kushtet në zyrat administratës vendore. Është realizuar lyerja me bojë e disa zyrave të administratës vendore, Njësive Administrative e qendrave komunitare si edhe mirëmbajtja e disa objekteve ndërtimore si zyra, korridore, dritare etj në godinën qendrore të Bashkisë dhe lagje.

**P1.F1.O2.A11** Rikonstruksion i rrjetit elektrik të godinës në qendër të Bashkisë së Shkodrës. Ka përfunduar zbatimi i rikonstruksionit të plotë i rrjetit elektrik i godinës së Bashkisë.

**P1.F1.O2.A12** Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake

Është realizuar pajisja me uniforma për Policinë Bashkiake për vitin 2017, bazuar në ligjin 8224 ,datë 15.05.1997 ”Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës, i ndryshuar dhe VKM nr. 333 datë 02.06.1998 për “Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë”, i ndryshuar, dhe urdherat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake.

**P1.F1.O2.A13** Është realizuar shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër projektuar nga Sektori i Aseteve pranë Drejtorisë Juridike, i cili synonte

përmbushjen e detyrimeve që Bashkia Shkodër kishte për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Shkodër, në Qarkun e Shkodrës”

**P1.F1.O2.A14** Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës
Është realizuar ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje).

**P1.F1.O2.A15**Zgjerimi i plotë dhe mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise)

Sisitemi i i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N) është shtrirë në 3 njësitë adminsitrative të mbetura Pult, Shalë dhe Shosh me mbështetjen financiare të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) si dhe në 5 Lagjet e bashkisë Qendër me mbështetjen financiare të buxhetit të bashkisë Shkodër. Tashmë shërbimet adminsitrative mund ti ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në 16 njësi adminsitrative në territorin e bashkisë Shkodër. Gjithashtu, sistematikisht sipas kërkesave teknike të stafit TIK është realizuar mirëmbajtja e shërbimeve, azhornimi i tyre në dokumentacion,format, delegime funksionesh te reja, etj.

**P1.F1.O2.A16**Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV)

Është realizuar mirëmbajtja e Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV) në mënyrë sistematike në mbështetje të kërkesave procedurale të Drejtorisë së të Ardhurave dhe në mbështetje të kërkesave teknike të Sektorit TIK të bashkisë Shkodër.

**P1.F1.O2.A17** Mirëmbajtje 3-vjeçare pajisje Informatike

Është realizuar shërbimi i mirëmbajtjes së paisjeve TIK egzistuese në mbështetje të specifikimeve teknike bazuar në standartet e AKSHI-t për vitin 2017.

**P1.F1.O2.A18** Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Janë siguruar pajisje TIK të reja në shërbim të administratës vendore në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative.

**P1.F1.O2.A19** Mirëmbajtje 3-vjeçare e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj

Është ofruar shërbimi për hostimin dhe mirëmbajtjen teknike të faqes zyrtare të internetit dhe moduleve të integruara të saj. Mirëmbajtje përmbajtësore e vazhdueshme e faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër dhe moduleve elektronike të integruara të saj. Azhornimi i informacioneve bëhet çdo ditë sipas nevojave dhe detyrimeve të publikimeve të bashkisë. Janë integruar platformat inovative për Transparencën e Buxhetit dhe Taksat e Mia në kuadër të bashkëpunimit me Programin për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal dldp. Janë integruar platformat elektronike komunikuese me qytetarët Raporto dhe Forumi Online në kuadër të Programit të Transparencës dhe Ambasadës Amerikane realizuar përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci.

**P1.F1.O2.A20** Detyrime dhe kompensime legale**.** Janë përmbushur detyrimet për kompensimet legale që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë.Realizuar detyrimet për vendime gjyqësore si dhe tarifat për njoftime dhe depozitime padie, ankimime dhe rekurse.

**P1.F1.O2.A21** Rikonstruksion çatia e godinës së bashkisë Është transferuar fondi me VKB nr.65 dt.30.10.2017 për Rehabilitim dhe risistemim i Merkatos Rus , Projektim Rikonstruksion rrugë Shkodër Qendër, Projektim Rikualifikim Urban blloqe Shkodër Qendër dhe Projektim Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugëve në Njësi Administrative .

**P1.F1.O2.A22** Blerje automjete në funksion të administratës. Kemi realizuar blerjen e një automjeti tip Fuoristradë në shërbim të administratës vendore.

**P1.F1.O2.A23** Blerje vegla pune Ështe realizuar blerja e veglave të punes si trapano elektrike, elektrosharrë dore, elektrogur, komplete çelësa etj në funksion të punonjësve të mirëmbajtjes.

**P1.F1.O2.A24** Ndërtimi i rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik (intranet) në 3 Njësi Administrative dhe 5 Lagje

Investimi është realizuar, infrastruktura fizike elektronike është implementuar në mbështetje të planimetrive të Njësive Administrative dhe Lagjeve dhe të projektit teknik të komunikimi elektronik Intranet të parashikuar.

**P1.F1.O2.A25** Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendërzuar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud .
Është instaluar dhe konfiguruar në server-at e bashkisë Shkodër Microsoft Windows Server 2016 i liçensuar. Është konfiguruar menaxhimi i qendërzuar i dokumentacionit i administrates vendore në përputhje me strukturën organizative të institucionit përfshirë dhe njësitë administrative I bazuar në Microsoft Active Directory .

**P1.F1.O2.A32** Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative). Janë realizuar kryerja e pagesave dhe shpenzimeve për paga, sigurime,shpenzime operative sipas parashikimeve të funksioneve të deleguara për punonjësit e QKB dhe Gjendjes Civile

**P1.F1.O2.A33** Mirëmbajtje e jashtëzakonshme e banjove të Bashkisë Shkodër
Është realizuar mirembajtja për 7 banjo, dhe janë kryer punime si : suvatime, hidroizolime, veshje me pllaka dhe vendosje paisje hidrosanitare bashkëkohore.

**P1.F1.O3.A1** Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepleqtë). U sigurua mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore. Ështe realizuar shpërblimi mujor ne menyre sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryepleqtë e njësive administrative.

**Sektori Juridik**

Gjate kësaj periudhe ka siguruar dhënien e konsulencës së nevojshme ligjore për të gjitha drejtorite dhe institucionet e varësisë së Bashkisë Shkodër, ka qenë pjesëmarrëse në proceset gjyqesore , duke përfaqësuar institucionin ku ajo ka qënë pale në proces, ka qene pjesmarrese në disa komisione, ka hartuar urdhera të brendshem, urdheresave, projekt vendimeve, akt-marreveshjeve, kontrata të sipermarrjes, kontrata mbikqyerje punimi, kontrata kolaudime. Ka ofruar asistencen juridike ne bashkëpunim me drejtorite e tjera për hartimin e rregulloreve te brendshme për funksionimin e tyre

- Ka hartuar projekt-vendime , referuar dispozitave ligjore ne fuqi , mbeshtetur ne relacionet perkatese te drejrtorive , për kaluar per miratim ne Keshilli Bashkiak.
- Ka qënë pjesëmarrese në komisionin e vlerësimit të ofertave, nxjerrjes jashtë përdorimit te automjeteve , ne 4 (kater) komisione te shpronësimeve per interesin publik, ne 2 ( dy) komisione te ankandeve publike, ne 15 komisione e vlersimit të procedurave “per prokurimin publik, ne 45 raste ne komisionet e privatizimit të banesave shteterore, ne 199 raste te komisionit për kalimin e pronesise mbi pasurite qe nuk kane akt fitimi te pronesise. konkretisht:

- Ka hartuar 87 (tetëdhjetë e shtatë) vertetime të ardhurash ekonomike sipas kërkesave të bëra nga studentet që studjojne jashte shtetit

- ka hartuar 80 (tetëdhjetë) kontrata pune civile/mall/sherbime, mbikeqyrje punimesh, amendamente.

- ka bashkërenduar punën me drejtoritë përkatese (drejtorinë e te ardhurave, drejtorinë e finances etj..)për hartimin e kerkese padive, në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH, Mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të Kontrollit të lartë të Shtetit, në Njësinë Administrative Velipojë, me nr. 550/11, datë 20.10.2015".
- ka hartuar urdherin e brendshem nr.982 dt.12.12.2017 "Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit te KLSH-së nr.491/5 dt.30.11.2017 , dhe plan veprimin ne lidhje me rekomandimet e KLSH-së.
- jane hartuar dhe depozituar ne gjykaten e Rrethit Gjyqsor Shkoder rreth 66 kerkese padi sipas rekomandimeve te KLSH- se ish komuna Velipoje me autorizim te titullares ndiqen nga z. Raboshta dhe z. Laloshi.

Për këtë periudhe referuar nenit 96 të Kr.P.Civile ka përfaqësuar në procese gjyqsore për **198** raste civile/administrative me objekte gjykimi të ndryshem, konkretisht :

| *Proçese në gjykim në Gjykatën e shk.I, sh.II –të.* | *Proçese në vijim në Gjykatën e Lartë* | *Proçese të pushuara* | *Proçese të formës së prerë* |
|---|---|---|---|
| **138** | **11** | **28** | **22** |

**II - Sektori Aseteve** Gjate kësaj periudhe ka ushtruar aktivitetin konkretisht:
1-Proçesin e regjistrimit të pronave të transferuara me VKM-në nr. 421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës" prane ZVRPP Shkodër, gjatë vitit 2017 nuk na regjistruar asnjë pronë me gjithë dërgimin e shkresave pranë kësaj Zyre, Zyrës Qëndrore në Tiranë , duke kërkuar arsyet e mosregjistrimit të këtyre pronave.
Gjatë vitit janë ridërguar për regjistrim 39 prona me fushë përdorimi zhvillimi ekonomik industria, nga keto janë aplikuar 35 cope, 2 cope aplikime me fushe perdorimi per realizimin e programeve (bustet).
2-Sistemimi i pronave "Shkolla 28 Nëntori" dhe "Qëndër shendetësore Kiras" si dhe ridërguar për regjistrim.
3-Është ndjekë pranë ZVRPP Shkodër zbatimi i VKM-së nr. Nr. 623, datë 24.9.2014 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve" Ali Spahija", "Nexhip Luli", "Bujar Bishanaku", "Stacioni I Trenit" "Rruga e Kalasë", si dhe Sistemimi i bllokut të pallateve, "Qafë _Hardhi", të Bashkisë së Shkodrës, duke dërguar në ZVRPP Shkodër dokumentacioni për rregjistrimin e këtyre pronave në favor të Bashkisë Shkodër, për të bërë të mundur vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.
Janë në proces procedura :
të pasurive pronë private që preken nga rikonstruksioni i rrugës "Nexhip Luli" për familjen e Z. Hilmi Bashi, i papërfunduar nga ana e ZVRPP Shkodër dërguar me shkresen nr. 6614 prot, datë 27.11.2014 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër për vazhdimin e rregjistrimit.
- jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe për dijeni Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

- Me shkresen nr. 44 prot, datë 06.01.2015 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe per dijeni ZQRPP Tiranë.
- Me shkresen 1098 prot, datë 04.03.2015 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe per dijeni ZQRPP Tiranë.
- Me shkresen nr. 14813 Prot, datë 11.4.2016 "Ridërgim dokumente për regjistrim" kemi përcjell në ZVRPP Shkodër Çertifikaten për vertetim pronësie me pronar Ilmi Bashi për pasurinë që preket nga shpronësimi për efekt investimi të "Rikonstruksionit të rrugës "Nexhip Luli"

Me shkresen nr. 1196 prot, datë 27.01.2017 "Ridërgim dokumente për regjistrim" kemi dërguar në ZVRPP Shkodër. Çertifikaten për vertetim pronesie origjinale për pronen me nr. 3/642 regjistruar në vol 25, faqe 94 me siperfaqe totale 680 $m^2$ nga kjo truall 680 $m^2$ me pronar Ilmi Bashi , data e lëshimit të çertifikatës 13.05.2015, faturen për arketim nr. 9130, datë 19.11.2014.
Nga ana e ZVRPP Shkodër është kërkuar të bëhet një pagesë shtesë për ndarje pasurie, që është realizuar nga qytetari me kërkesen nr. 3705, datë 27.02.2017.
Me shkresen nr. 17083 prot, datë 14.11.2017 "kërkesë për zbatimin e VKM-së nr. 623, datë 24.09.2014 I jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe për dijeni ZQRPP Tiranë e cila ka kthyer përgjigje me shkresen nr. 7800/1 prot, datë 21.11.2017", jemi drejtuar ZRPV Shkoder, por prona nuk eshte rregjistruar.
Shpronësimi për interes publik të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga rikonstruksioni i rrugës "Bujar Bishanaku" për familjen Sejhan Baja dhe familjen Nexhmedin Baja.
Me shkresen nr. 5682 prot, datë 14.10.2014,dërguar për rregjistrim duke kryer detyrimet ndaj ZVRPP Shkodër me faturen për arkëtim nr. 9130, datë 31.10.2014.
Ridërguar për regjistrim me shkresen nr. 8132 prot, datë 31.5.2017 dhe nr. 8133 prot, datë 31.5.2017 dhe shkresen nr. 17082 prot, datë 14.11.2017 duke kryer të gjitha detyrimet ndaj ZVRPP Shkodër.
Procedura e likuidimit të vlerës 3 449 982 lekë, për familjen Prendushi si shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga Rikostruksioni I Rrugës "Ali Spahija" e cila ka përfunduar.
Në kuadër të menaxhimit të Aseteve vendore, brenda kompetencave të caktuara kemi monitoruar kontratat e qerase të cilat bashkia ka me të trete.
Ndjekja me Ministrine e Financave dhe Ekonomisë për të administruar dokumentacionin e kontratave Emfitioze të kontratës nr. 650 rep, nr.133 Kol, datë 24 Mars 2000 me objekt dhënien me qira të objektit "Kinema Millenium", Shkodër pronë e Bashkisë lidhur ndërmjet ish- Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë "IDA" sh.a dhe Kontratës së qirasë Rep 2950 Nr., Kol 475 Nr., datë 19.Qershor 2000, për objektin "Shkolla M. Bujqësore" pronë e Bashkisë Shkodër.
Përditësimi i regjistrit të aseteve bazuar ne udhezimin 30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" për të gjitha Njësitë e Bashkisë Shkodër, dhe konkretisht:

**1-Njësia Administrative Shkodër.**

- Prona që përdoren në fushen administrative- 8 prona
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 33 prona + 9 arsim parashkollore
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 16 prona
- Prona që përdoren per realizimin e programeve kulturore e sportive 9 prona
- Prona që përdoren në fushen e sherbimit social 6 prona

- Infrastrukture vendore lulishte 5 prona

**2-Njësia Administrative Velipoje .**

- Prona që përdoren në fushen administrative 2 prona
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 6 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 6 prona
- Prona që përdoren në fushen e sherbimit social 2 prona

**3-Njësia Administrative Dajç**

- Prona që përdoren në fushen administrative- 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 8 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 2 prona
- Sherbim funeral 6 prona

**4-Njësia Administrative Bërdicë**

- Prona që përdoren në fushen administrative- 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 6 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 6 prona

**5-Njësia Administrative Ana e Malit**

- Prona që përdoren në fushen administrative- 1 prona
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 11 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 4 prona
- Prona që përdoren per realizimin e programeve kulturore 1 prona
- Sherbim funeral 2 prona
- Bujqesi 8 prona

**6-Njësia Administrative Rrethina**

- Prona që përdoren në fushen administrative 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 12 prona+kopesht femijesh 1 prone.
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 10 prona
- Prona që përdoren per realizimin e programeve kulturore dhe sportive 1 prone
- Prona që përdoren në fushen e sherbimit social
- Zhvillim ekonomik 5 prona
- Prona që përdoren në fushen e mbrojtjes civile 7 prona
- Infrastrukture vendore 4 prona
- Sherbim funeral 6 prona

**7-Njësia Administrative Postribë**

- Prona që përdoren në fushen administrative 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 9 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 8 prona
- Sherbim funeral 11 prona

**8-Njësia Administrative Gur i Zi**

- Prona që përdoren në fushen administrative 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 9 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 10 prona
- Sherbim funeral 11 prona

**9-Njësia Administrative Shale**

- Prona që përdoren në fushen administrative 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 13 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 3 prona
- Sherbim funeral 11 prona

**10-Njësia Administrative Shosh**

- Prona që përdoren në fushen administrative 1 prone
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 4 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 1 prone
- Prona që përdoren per realizimin e programeve kulturore dhe sport 1 prone
- Sherbim funeral 1 prone

**11-Njësa Administrative Pult**

- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore 6 prona
- Prona që përdoren në fushen e shëndetit publik(Sherbim parësor) 4 prona.

Janë përgatitur formularët e Inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore me fushë përdorimi Infrastrukturë sherbime publike, Rrugë me të dhëna, Zona kadastrale, nr. pasurie, Indeksi i hartës dhe gjatësi totale të tyre. Përgatitja e formularëve të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore me fushë përdorimi infrastrukturë sherbime publike – rrugë, është bërë me qëllim zevëndësimin e formularëve të vjetër të cilët shoqërojnë Vendimin Nr.366,datë27.3.2008 "Përmiratiminelistësparapraketëpronavetëpaluajtshmepublike, shtetërore,qëtransferohen,nëpronësiosenëpërdorim,tëbashkisë ShkodërtëQarkuttëShkodrës.

Janë hedhur në formatin DWG pronat e regjistruara pyje dhe kullota.

Janë hedhur në formatin DWG pronat e regjistruara në zbatim të VKM-së Nr. 421, datë

Në zbatim të VKM-së nr. 366, datë 13.5.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të sherbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në vendimin Nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së brendshme, për prefektët në qarqe dhë nënprefektet, administraten e tyre, për drejtorinë e përgjithshme civile,(drejtorinë e PMNZSH-së), të ndryshuar kemi dërguar për rregjistrim dhe kemi aplikuar dhe kemi kryer detyrimet ndaj ZVRPP Shkoder.

Në zbatim të VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarëve dhe aktualisht në administrim të ministrisë së Mjedisit e të ish komunave /bashkive, kemi dërguar dokumentet për regjistrimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit që transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas shtojcës 46, Ekonomia pyjore / kullore Rosek drisht në total 318 pasuri.

Nga ana e ZVRPP Shkodër nuk është vepruar me pretendimin se mungojnë hartat kadastrale.

Në zbatim të "Udhëzues për regjistrimin fillestar të pyjeve dhe kullotave" është detyrim i ZVRPP të realizohet ky proçes.

Me shkresen nr. 15682 prot, datë 25.11.2016 "Për konfirmim" jemi drejtuar Z. Shpetim Lame regjistrues i ZVRPP për arsyet e mosregjistrimit të këtyre pasurive.

Për zbatimin e VKM-së nr. 421, datë 02.06.2010 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe për dijeni ZQRPP Tiranë me anë të një sërë shkresash ne vite 2014, 2015, 2016 dhe ne vazhdim gjate gjithe vitit 2017. Te gjitha shkresat pa pergjigje.

Në zbatim të VKM-së nr. 510, datë 10.6.2015 "për miratimin e proçedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuarar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo – territorial", kreu VI, pika 4 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër dhe për dijeni ZQRPP Tiranë, për dijeni Ministrisë Drejtësisë, për dijeni Agjensisë së Zbatimit të reformës territoriale, Prefektit të Qarkut Shkodër, ne vitet 2015, 2016 dhe ne vazhdim gjate vitit 2017 edhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH –
Te gjitha shkresat ne vite jane pa përgjigje.
Ndjekja e procedures së shpronësimit në zbatim të VKM-së nr.595, datë 18.10.2017 "Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preket nga realizimi i projektit "Sistemim blloqe banimi, Zogu i, krahu i djathtë zyra e Punës, drejtoria e bujqësisë) dhe marrja e dokumentave të pronësisë, duke bërë të mundur përfundimin e procedurës.

**Njësia e prokurimit publik**

**Eshte hartuar dhe dërguar rregjistri i parashikimit** pranë Agjencisë së prokurimit publik me shkresën nr. 2633 dt. 24.02.2017 me shkresë përcjellëse dhe në formatin CD.
**Eshte hartuar dhe dërguar rregjistri I realizimit për 12 mujorin e 2017** pranë Agjencise së prokurimit publik.
**Janë realizuar per 12 mujorin e 2017,** 89 proçedura me vlerë të lartë nga të cilat janë realizuar të përkthyera në shifra 140.377.463 leke me tvsh si organ me vete procedura kerkese per propozim. Në 8 raste ka përdorur procedurën e prokurimit Sherbim Konsulence si organ më vete. Vlera e kontratave te realizuara ka qene 10.236.435,2 leke me tvsh. Në 6 raste procedurat e prokurimit janë realizuar të ndara me lote me vlere te kontratave 26.438.254,42 leke me tvsh. Vlera totale e prokuruar për të gjitha keto procedura prokurimi është **472.623.833,53** leke me tvsh i detajuar si më poshtë:
352,084,153.97 leke me tvsh për procedura prokurimi (kërkese për propozim, procedure të hapur,sherbim konsulence dhe negocim pa botim paraprak)
**Janë realizuar 109** prokurime me vlere të vogel nga të cilat të përkthyera në shifra **22,341,612.96** lek me tvsh.
**Jane realizuar,** 2 proçedure blerje e përqëndruar nga autotiteti kontraktor, kontretisht: Blerje karburant per nevojat e Bashkisë dhe të institucioneve të varësisë dhe Blerje Kancelari per nevojat e Bashkisë dhe të institucioneve të varësisë me vlerë **29,017,015.20**leke me tvsh.
**Janë përgatitur,** të gjithe dokumentacionet që kanë të bëjnë me proçeduren e prokurimit. Duke filluar që nga miratimi I kërkesës për prokurim, përgatitja e urdhërit të prokurimit, urdhërave të KVO-së dhe shpërndarja tek anëtarët e këtij komisioni, hedhja në system e të gjithë dokumentacionit teknik, ndjekja hapa pas hapit e proçedurës së porkurimit, hedhja e njoftimit të fituesit në system duke respaektuar afatin e parashikuar, dërgimi për kontratë i proçedurës së prokurimit pranë Drejtorise Juridike dhe dërgimi për likujdim pranë Drejtorisë së Financës.
**Janë dërguar**, urdhërat e prokurimit për miratim pranë degës së Thesarit Shkoder.
Janë hartuar dokumentat standarte duke siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues pë rtë gjithë operatorët ekonomikë, pjësëmarrës në proçedurat e prokurimit publik. Janë përditësuar kriteret teknike në dokumentat standarte, duke vendosur kritere më të forta të parashikuara në ligj, për arsyen e marrjes së një shërbimi më cilësor nga operatoret ekonomik pjesëmarrës. Në çdo proçedurë prokurimika pasur një pjesëmarrje masive të operatorëve ekonomik.

**Në bashkëpunim me drejtoritë,** janë kontrolluar preventivat për gabime të ndryshme matematikore, vlerat e preventivit që të mos e kalojë vleren e parashikuar në rregjistrin e parashikimeve. Gjithashtu çmimet e zërave të punimeve janë kontrolluar me manualin e miratuar me VKM nr. 629 dt. 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike…". Për zërat që nuk janë të parashikuar në manual janë kërkuar analizat teknike të çmimeve. Gjithashtu I është dërguar shkresë drejtorive, për proçedurat e mallrave,përpara se të sillen në njësinë e prokurimit duhet të verifikohet edhe gjendja e magazinës, ndërsa për përcaktimin e fondit limit duhet të merren për bazë çmimet e kontratave të ngjashme, të instatit dhe testimit të tregut bazuar ne nenin 59 pika 2 te VKM nr 914 dt. 19.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit"

**Janë realizuar**, asistenca të ndryshme nga njësia e prokurimit ndaj komisioneve të vlerësimit të ofertave, sidomos në lidhje me kriteret e veçanta që ka kërkuar njësia e prokurimit. Këtu përfshihet shpjegimi për vendosjen e kriterit për çertifikatat ISO, inxhinierët e ndryshëm të kërkuar në bazë të zërave në preventiva etj.

**Janë realizuar shtesat e rregjistrit,** për drejtorite e Bashkise së bashku me institucionet e varësisë, për rastet kur objekti I prokurimit ka qënë I miratuar në fishen e programit përkatës por nuk kanë qënë të parashikuara në rregjistrin përfundimtar të vitit 2017.

**Gjatë kësaj periudhe janë realizuar**, kthim përgjigje për të gjithë operatoret që kanë paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor si për kriteret ashtu edhe për vlerësimin nga komisioni I vlerësimit të ofertave.

Përgatitja e informacionit për komisionin e prokurimit publik, në lidhje me ankesat që kanë paraqitur operatorët ekonomikë pranë këij komisioni, në lidhje me vendimet që ka marrë autoriteti kontraktor për ankesat e këtyre operatorëve.

**Njësia e Auditimit te Brendshem**

Njësia e Auditimim te Brendshem, prane Bashkise Shkoder, ka ne perberjen e saj 3 punonjes, nga te cilet dy audit dhe nje drejtues. Auditet kane nje eksperience në punë mesatarisht 15 vite, janë të diplomuar në nivel master janë të certifikuar dhe plotesojne kerkesat e percaktuara ne ligjin e auditit te brendshem ne sektorin publik.Njesia e Auditimit , Bashkia Shkoder , per vitin 2017 e ka ushtruar veprimtarine e saj, bazuar ne planin strategjik dhe vjetor, miratuar nga Kryetare e Bashkise.

Gjate vitit 2017, auditimet janë përqendruar ne njësitë administrative , qe jane bashkuar me Bashkinë Shkodër ,Drejtorite e Reja që i jane shtuar Bashkisë Shkodër nga shtimi i kompetencave pushtetit vendor .

Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkoder per vitin 2017, ka patur si mision kryesor te saj dhenien e garancise të arsyeshme për eficencën, efektivitetin dhe ekonomicitetin e menaxhimit të burimeve, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rriskut. Ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit, me qëllim dhenien e kontributit në përmirësimin e drejtimit, forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe shtimin e vlerës se Bashkise Shkoder e institucioneve te tjera publike në vartesi të saj. Përmirësimin e qeverisjes, dhe mbrojtjen e interesave të taksapaguesve.

Në auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në planifikimin e punes, në pershkrimin e punes sipas vendeve te punes, ne krijimin e hartes proceseve te punes ne ndjekjen e performances, ne ndjekjen dhe funksionimit kontrollit brendshëm, ne plotesimin e regjistrit riskut, ne raportimin ne organet eprore te veprimtarise administrimin e personelit, ne administrimin e aseteve, ne administrimin e vlerave materiale, ne percaktimin e rregullave te mirmbajtjes se aseteve , në

administrimin e investimeve, nuk jane nxjerrë përgjegjësitë për vendimet gjygjësore, nuk është dorëzuar detyra etj.

Në sistemin e pagesave ka patur mangesi në llogaritjen e vështërsisë për punën e kryer, angazhimi i përsonelit per punë jashtë kohës normalë, lidhjen e kontratave me te trete etj.

Gjate vitit 2017 jane lënë rekomandime kryesisht per permiresimin organizativ, për pershtatje e rregullores, percaktimin dhe ndjekjen e objektivave , përshkrimet e vendeve të punës. Janë dhene rekomandime ne përmirësimin e menaxhimit financiare dhe kontrollit, në përmirësimin e monitorimit dhe raportimit ne kohe,në përmirësimin e procedurave te prokurimeve publike, në përmirësimin e pagesave dhe zhdëmtimin e përfitimeve të padrejta, administrimin e aseteve, mbajtjen e kontabilitetit.

Ne vitin 2017, janë planifikuar për auditim dymbëdhjete subjekte, nga të cilat nente subjekte per auditim te kombinuar, tre subjekte per auditime performance.

Gjate vitit 2017, janë kryer 10 misione auditimi, nga te cilat tete misione auditimi te kombinuar dhe dy misione angazhim këshillimi dhe siguire, sipas kerkesave te drejtimit. Gjatë vitit 2017 nuk është realizuar plani i auditit, pasi ka patur kerkesa te vazhdueshme ne dhenien e ndihmes per drejtorite e bashkise, kryesisht në hartimin e proceseve të punës, ne hartimin e rregullores se bashkisë, në dhenien e ndihmes per plotësimin e rekomandimeve të lena nga audituesit e kontrollit larte shtetit.

Per vitin 2017 , jane konstatuar shkelje me dem efektik per vlere 4.089 mije lek. Bazuar ne gjetjet e konstatuara gjatë misioneve të auditimit për përmirësimin e punës, janë dhene 131 rekomandime, nga te cilat, me prioritet te larte 57 rekomandime, me prioritet te mesem 63 rekomandime dhe me prioritet te ulte 11 rekomandime. Per vitin 2017, per angazhim – keshillimet, janë dhene 16 rekomandime.

Njësia e Auditimit të brendeshm, prane Bashkise Shkoder per vitin ne 2018 do te kete si prioritet kryesor permirsimin e procedurave audituese. Rritjen e nivelit profesional rritjen e bashkepunimit brenda dhe jashte Bashkisë, nje vemendje te vecante do tu kushtohet fushave me rrisk te larte per te bere te mundur uljen ne maksimum te kostove te teperta,ne perdorimin eficent te shpenzimeve ne menyre qe te shtojme vleren e institucionit te Bashkise Shkoder .Një prioritet i rëndësishem do të jetë konsulenca e vazhdueshme për të bërë të mundur parandalimin e veprimeve në kundërshtim me ligjin apo akte te tjera administrative.

## III Fondet e financimit te programeve

Është miratuar rialokimi i fondeve brenda programit si më poshtë:

- Me Vendim të Kryetares së Bashkisë Nr. 121 dt 20.04.2017 është bërë:

Pakësim prej 1 400 mijë lekë nga shpenzim operative tek P1.F1.O2.A15 Zgjerimi i plotë dhe mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise", dhe Shtesë në vlerën1 400 mijë lekë tek investimet programi P1.F1.O2.A18 "Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)k",

- Me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr.362, datë 06.10.2017 është bërë

*Pakësim prej3 937 mijë lekësh* tek:

P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës tek A 3.1"Blerje kancelari, letër bojë fotokopje" në vlerën 533 mijë lekë

P1 .F1.O2.A1/ Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës Aktiviteti A2.9 Rimbushje fikëse zjarri" ne vlerën 196 mijë lekë.

P1F1O2A5/ Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës Aktiviteti A4.2 Blerje pjesë kembimi për automjetet e transportit A4.3" Shërbim i mirëmbajtjes së mjeteve të transportit në vlerën 311 mijë lekë
P1F1O2A13 " Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër në vlerën 2,297 mijë lekë.
P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës "A 2.9 Furnizim me gaz të lëngshëm në vlerën 600 mijë lekë.
Shtesë prej 3 937 mijë lekësh tek :
P1.F1.O2.A33 Mirëmbajtje e jashtëzakonshme e banjove të Bashkisë Shkodër në vlerën 3,537 mijë lekë.
P1.F1.O2.A1/ Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës A 2.11 Shërbime të tjera (shërbim karrotrec, deratizim brejtes etj ) në vlerën 280 mijë lekë
P1.F1.O2.A4/ Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj) A.5 Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve të zyrave në vlerën 120 mijë lekë

- Me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr.461 dt 16.11.2017 është bërë :

Pakësim prej 1176 mijë lekësh tek :
P1.F1.O2.A1/A2.1 Furnizim me ujë i Bashkisë qendër dhe Njësive Administrative prej 517 mijë lekë
P1. P1.F1.O2.A1 /A2.4 Shërbime postare në vlerën 352 mijë lekë
P1.F1.O2.A2/A3.2 Blerje dokumentacione (shtypshkrime) në vlerën 307 mijë lekë
Shtesë prej 1 176 mijëlekësh tek:
P1.F1.O2.A1/A2.2 Furnizim me energji elektrike i Bashkisë qendër dhe Njësive Administrative

**Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2017 per programin e administratës vendore janë:**

- Fondi për « Paga dhe Sigurime shoqërore » u realizua në total ne vlerën prej 222,265 mijë lekë, nga te cilat 25,000 mije leke nga fondet e trasheguara, dhe 197,265 mije leke nga fondet e planifikuara te vitit 2017 prej 233,986 mije leke .Realizimi ne total 95 %.
- Shpenzime Operative janë realizuar në masën 48,472 mijë lekë, nga 53,099 lekë plani i korigjuar 2017. Realizimi është 91,3 %.
- Transferta janë realizuar në masën 7,001 mijë lekë, nga 12,684 mijë lekë plani i korigjuar 2017. Realizimi është 55,2 %.
- Investime janë realizuar në vlerën 18 432 mijë lekë, nga 19 240 mijë lekë plani i korigjuar 2017.. Realizimi 95,8 %.

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| P1.F1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. | 209,381 | 209,422 | 173,288 |
- Rele krepuskolare modulare 16/30 gjithsej 100 copë
- Rele krepuskolare për shtyllë 12/25 gjithsej 100 copë
- Portollampa për llampa SAP 150 ë gjithsej 50 copë
- Portollampa porcelani për llampa elektronike 22 ë gjithsej 100 copë

F8.O1.A1.2. Pagesa e konsumit të ndriçimit

Janë realizuar pagesat për konsumin e energjisë elektrike për ndriçimin publik qytet dhe njësitë administrative.

F8.O1.A1.3. Blerje komplet veglash dhe komplete të sigurimit teknik

Janë realizuar blerja e vegla të punës si më poshtë: set pincash, set kaçavidash, trakide, dandic, etj, si dhe kompletet e sigurimit teknik që përmbajnë (galoshe dieletrike, doreza elektrike për tension të ulët, tregues tensioni deri 1000 V, tokëzues portativ, vegla pune me doreza të izoluara, rrip sigurimi për montatorët, kambaleca për ngjitje në shtyllë. etj)

F8.O1.A1.4. Blerje Uniforma për punonjësit e shërbimit (30 komplete)

Janë realizuar blerja e 30 uniforma që përmbajnë këpucë, kostum pune, doreza të cilët do të kenë identifikimin si punonjës së shërbimit të Bashkisë.

F8.O1.A1.5. Pjesë këmbimi

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

1.1 IVECO
1.2 NISSAN ,

për të cilët në bazë të preventiva përkatës janë realizuar këto shpenzime. Në zërat kryesor mund të përmendim: pjesë këmbimi si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, ndërrim vaj hidraulik.

F8.O1.A1.6. Mirëmbajtje

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

1.1 IVECO
1.2 NISSAN ,

për të cilët në bazë të preventiva përkatës janë realizuar këto shpenzime. Në zërat kryesor mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe nafte, saldimi i koshit.

F8.O1.A1.7. Shpenzime për karburant

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për secilin mjet.

F8.O1.A1.8 Pagesa për dokumentacionin

Për secilin mjet është realizuar pagesa e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

F8.O1.A1.9. Investime

Në zbatim të buxhetit të 2017,është realizuar ndriçimi i dy rrugëve kryesore: rruga”Dr.Ali Spahija” dhe rruga ”Malo Hoxha”, Trush në Nj.A Bërdicë.

Në zbatim të buxhetit të 2017, lekë është realizuar ndriçimi i 35 rrugëve dytësore:

- Rruga ”Hysen Lohja”,
- Rruga ”Oroshve”,
- Rruga Velej segmenti II,
- Rruga ”Zogaj degëzim,
- Rruga e Muminit,
- Rruga Zabelaj,
- Rruga Ferrukaj,
- Rruga ”Anton Ballaci”,
- rruga Vladimir Jani,
- Rruga Ali Demi (Tepe),
- Rruga Banja e Vogël (kryqëzim),

- Rruga ”Vllaznimi”,
- Rruga ”Arra e Madhe” degëzim,
- Kryqëzimi i Dajçit(NJ.A Dajç),
- rruga Pentar (Nj.A Dajç),
- Rruga Beltojë (Nj.A Bërdicë),
- Rruga fshati Drisht (Nj.A Postribë),
- Rruga fshati Myselim (Nj.A Postribë),
- Rruga fshati Grudë, (Nj.A Rrethina),
- Rruga fshati Bardhaj degëzim, (Nj.A Rrethina),
- Rruga Nr 2 (Nj.A Velipojë)
- Rruga fshati Ganjollë, (Nj.A Gur i Zi).
- Rruga ”Baja e vogël”, dëgëzim
- Rruga ”Mehmet Gjyli”, Draçin
- Rruga ”Populli”
- Rruga ”Sheuqet Muka”
- Rruga ”Qemal Draçini”, Degëzim;
- Rruga ”Shtëpia e Bujqëve”;
- Rruga ”Smakaj”
- Bulevardi ”Skënderbeg”, degëzim;
- Rruga ”Ali Pash Gucia”
- Rruga ”Sarda”
- Rruga ”Treni i Mallnave”
- Rruga ”Fshati Bërdicë”
- Rruga nr.3 Velipojë;

**III. Fondet e financimit të programeve**

Si rezultat i diferencave të krijuara ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës fituese gjatë proçeseve të prokurimit publik për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara gjatë 2017, është miratuar rialokimi i fondeve sipas vendimive të mëposhtme:

- Nr 268 datë 14.07.2017
- Nr 346 datë 25.09.2017
- Nr 363 datë 07.10.2017
- VKB 64 datë 30.10.2017

Fondet e miratuara për këtë program janë 350,892 mije lekë.
Realizimi për periudhën 12 mujore është 343,429mije lek në masën 95**%** ndaj planit vjetor.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017, paraqitet si më poshtë:**

a) Shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore janë realizuar në masën 17,436 mijë lekë nga 20,599 mijë lekë që ka qenë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 85%.
b) Shpenzime Operative janë realizuar në masën 271,415 mijë lekë nga 276,721 mijë lekë që ka qenë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 98 %.
c) Transferta jane realizuar ne mase 5,036 mije lek nga 5,216 mije leke qe ka qene e parashikuar. Realizimi ne mase 97%
d) Investime janë realizuar në masën 40,542 mijë lekë nga 48,355 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 84 %.

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| P4.F1.O1.A1. Sherbimi I pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA qytet Shkoder. | 99,246 | 99,246 | 98,496 |
| P4.F1.O1.A1.1. Shërbimi i pastrimit Nj. Ad. Velipoje -Dajç | 10,656 | 10,075 | 10,075 |
| P4.F1.O1.A1.2 Shërbimi i pastrimit Nj. Ad. Rrethina, Postribe Shalë | 13,322 | 11,322 | 11,322 |
| P4.F1.O1.A1.3 Shërbimi i pastrimit Nj. Ad. Guri Zi, Berdice, Ana Malit | 5,871 | 4,583 | 2,205 |
| P4.F1.O1.A1.4. Depozitim mbetjeve në Landfill për gjithë Bashkinë | 18,903 | 40,042 | 39,183 |
| P4.F1.O1.A1.5. Transport mbeturina ndërtimore | 600 | | |
| P4.F1.O1.A1.7 Shpenzime për mjete transporti | 2,288 | 2,288 | 1,933 |
| P4.F1.O1.A6.1 Ndërtim xhepa kazanësh për mbeturina. | 879 | 879 | 673 |
| P4.F1.O1.A6.2 Blerje kazanësh | 8,950 | 8,950 | 8,950 |
| P4.F1.O1.A6.3 Blerje pajisje elektronike për monitorim | 250 | 250 | 241 |
| P4.F2.O1.A1 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta Shkodër | 30,770 | 30,770 | 30,770 |
| P4.F2.O1.A1.1 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta Shkodër | 2,400 | 2,400 | 1,438 |
| P4.F2.O1.A1.2 Karburant për prerëse bari. | 960 | 960 | 960 |
| P4.F2.O1.A1.3/1F.V Kosha mbeturinash për lulishte . | 432 | 432 | 396 |
| P4.F2.O1.A1.3/2 Krijimi e sipërfaqeve të e gjelberta në Nj.Ad | 2,000 | 2,000 | 1,997 |
| P4.F2.O1.A1.3/3 Krijim sipërfaqe e gjelbërt në qytet, Lulishte Pazar. | 3,200 | 3,200 | - |
| P4.F2.O1.A1.3/4 Pajisje prerëse bari për NJ.Ad. | 740 | 740 | 548 |
| P4.F3.O1.A1 Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Aadministrative | | | |
| P4. F4. O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza | - | - | - |
| P4.F5.O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut | 5,000 | 5,000 | 5,000 |
| P4.F6.O1.A1: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve. | 21,371 | 21,371 | 17,602 |
| P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike | 1,121 | 1,002 | 1,002 |
| P4.F8.O1.A1: Mirëmbajtja e Sistemit të Ndriçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative | 82,312 | 84,567 | 84,166 |
| P4.F9.O1.A1:Shpenzime per pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Shërbimeve Publike | 19,284 | 20,815 | 17,472 |
| **TOTALI** | **330,555** | **350,892** | **334,429** |

## IV. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2017

P4.F1.O1.A1.**5.** Transporti i mbeturinave Ndërtimore. Proçedure prokurimi është realizuar por nuk është zbatuar për mungesë të një vendepozitim për mbetjet inerte. Kontrata e shtyrë deri në miratimin e venddepozitimit nga dikasteret përgjegjëse.

P4.F2.O1.A1.3/3 Krijim sipërfaqe e gjelbërt në qytet, Lulishte Pazar. Është realizuar projekti i plotë i rikonceptuar për të gjithë lulishten.

## P5 Transporti publik dhe lëvizshmëria

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik,etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithë fushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës.Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore,malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

### I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave.

Bashkia mbështet shërbimet e saja në funksione:

F1**.** Përmirësimi i lëvizshmërise urbane për një cilësi jetese më të mirë dhe ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor për qytetarët e Bashkisë Shkodër.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1.Zgjerimi i mbulimit të zonës urbane me shërbimin publik urban, rritjen e sigurisë në rrugë dhe hartimi i një plani të qëndrueshëm mobiliteti.

### II. Produktet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 është punuar për përmbushjen e objektiva nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A.1.1/1 Projekt-studim trafiku( lëvizshmëria dhe semaforët).

Ky objekt është në proçedurë prokurimi pasi është anulluar një herë për mos plotësim të kushteve.

F1.O1.A.1.1/2 F.V Kufizues shpejtësie (bumpe gome).

Janë vendosur 90 ml bumpe për rritjen e sigurisë rrugore, kryesisht në akset kryesore në afërsi të shkollave

F1.O1.A.1.1/4. Blerje materiale për sinjalitikë horizontale + vertikale

Për vitin 2017 janë realizuar blerja e materiale për sinjalitikë horizontale + vertikale

- ✓ Bojë rrugore bikoponente sprajt gjithsej 2200 kg
- ✓ Tabela rrugore të ndryshme gjithsej 60 copë
- ✓ Kone ndarëse trafiku gjithsej 15 copë
- ✓ Pulsante gjithsej 6 copë

F1.O1.A.1.1/5. Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit

Në funksion të mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale është një makinë vijëzimi, për të cilën janë realizuar këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesor mund të përmendim: zëvendësimi gomash, kompresor, pistole boje.

F1.O1.A.1.1/6. Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit

Janë realizuar këto shpenzime për mirëmbatje: shërbim motori, pastrim injektorësh

F1.O1.A.1.1/7. Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për makinën e vijëzimit

F1.O1.A.1.1/8 F.V kufizues trafiku me tampon bllokues, territori i Bashkisë.

Ky objekt është realizuar duke arritur sigurinë e kalimtarëve dhe normalizimin e trafikut
F1.O1.A.1.1/9Blerje paisje pune, xhenerator 6 kë, saldatrice.
Ky objekt është realizuar

### III. Fondet e financimit të programeve

Si rezultat i diferencave të krijuara ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës fituese gjatë proçeseve të prokurimit publik për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara gjatë 2017, është miratuar rialokimi i fondeve sipas vendimit të mëposhtëm:

- VKB 64 datë 30.10.2017

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017, paraqitet si më poshtë:**

Fondet e miratuara për këtë program janë 10,943 lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 10,738 në masën 98 % ndaj planit vjetor.

a) Shpenzime Operative janë realizuar në masën 2,532 mijë lekë nga 2,660 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 95 %.
b) Investime janë realizuar në masën 8,204 mijë lekë nga 8,283 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 99 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare.

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| P5.F1.O1.A1: Mobiliteti dhe shërbimi i transportit urban | 15,312 | 10,943 | 10,738 |
| **TOTALI** | **15,312** | **10,943** | **10,738** |

## P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.
Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lire dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

### I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2017 ka fokusuar përpjekjet e saj në 6 funksione zhvillimi:

F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
F6. Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për secilin funksion janë:
F1.O1. Mbështetja për përmiresimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.
F2.O1. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.
F3.O1. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
F4.O1. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.
F5.O1. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.
F6.O1.Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve. promocionale-informative.
F6.O2. Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.
F6.O3. Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.
F6.O4. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.
F6.O5. Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe me universitetin.
F6.O6. Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.
F6.O7. Përmirësim i infrastrukturës turistike dhe i aksesit.

## II Produktet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

### P6.F1.O1.A4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.

### P6.F1.O1.A5. Studim fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër

Menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Bashkia Shkodër ka një shtrirje gjeografike e cila fillon nga Veriu i Alpeve Shqiptare deri ne Bregdetin Adriatik duke përfshirë një sërë resursesh. Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore. Menaxhimi i duhur i aseteve ka shumë rëndësi për menaxhimin e mirë financiar vendor. Menaxhimi më i mirë i aseteve mund të përmirësojë drejtpërdrejtë zhvillimin ekonomik, duke ulur humbjet dhe kostot e panevojshme operative dhe duke identifikuar mundësitë e reja të zhvillimit. Ky Studim do të shërbejë në identifikimin e mënyrave efikase e krijuese për shfrytëzimin e pasurive të tyre të reja për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve që sigurojnë për qytetarët e tyre. Gjithashtu ky studim fizibiliteti do të krijojë mbështetje edhe për punën teknike në aplikimin e metodave që mbështesin zhvillimin e investimeve kapitale dhe planifikimin e përdorimit të tokës brenda kapaciteteve të përgjithshme të huamarrjes vendore apo të krijimit të partneriteteve të reja Publik – Privat.

**P6.F2.O1.A3. Rehabilitim mirëmbajtje e merkatos në Rus**

Merkato Rus nuk funksionon me kapacitetin e saj te plote si rrezultat i gjendjes se saj jo te mire. Një vëzhgim i bërë në tregjet publike, vihet re se hapësirat e posaçme që Bashkia e ka vënë në dispozicion nuk shfrytëzohen të gjitha sepse kane nevoje për përmirësime te vazhdueshme. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e merakos do sillte jo vetëm tregtimin në kushte të përshtatshme që do të rriste edhe vetë cilësinë e produkteve por mbi te gjitha do të nxisë formalizimin e këtij sektori. Aktualisht në tregjet ekzistuese, që janë tregje publike, duhet bërë një plan rehabilitimi për këta. Është bërë analiza e infrastrukturës ekzistuese të merkatos Rus dhe evidentim i nevojës për rehabilitim. Janë realizuar dëgjesa publike për shtesë fondi të projektit. Me VKB nr. 65 datë 30.10.2017 "Për rishpërndarje të fondeve të buxhetit të vitit 2017", është miratuar rritja e vlerës së planifikuar pë aktivitetit në fjalë në 11,672,485 leke për ndërtim, mbikqyrje dhe kolaudim të objektit. Gjithashtu është realizuar hartimi i projektit për rehabilitimin e saj dhe është kryer procedura e tenderimit.

**P6.F2.O1.A4. Përcaktimi i hapësirave dhe ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores për funksionimin e tregjeve të lëvizshme**

Prodhuesit e Bashkisë Shkoder ankohen sepse një sasi e konsiderueshme e prodhimit të tyre nuk po arrin në treg për arsye të largësisë me tregun. Nga ana tjetër edhe blerësit e lagjeve të mëdha kane nevojë për tregje të përkohshme afër zonave të tyre të banimit. Situate aktuale është se në lagje të veçanta kemi grumbullime fermerësh të cilët shesin produktet e tyre ne kushte joformale dhe johigjenike. Gjatë vitit 2016 janë identifikuar rreth 450 shitës fermerë ambulantë me pakicë që paraqesin nevojën për përcaktimin e një hapësire për tregtim.
Për fermerët është i nevojshëm përcaktimi i një hapsire publike tregtimi të përkohshme. Krijimi i zonave te veçanta për tregje ditore mund te behet në lagje që e kanë të nevojshëm një treg, por kjo shërben edhe si ide për fillimin e tregjeve ne NJ.A tona. Ne ketë mënyre do të krijojmë një pamje me te rregullt tregtimi dhe një imazh me pozitiv për qytetin. Gjatë viti 2017 është bërë rregullorja e funksionimit të tregjeve të lëvizshme, është bërë analiza e situatës dhe evidentim i nevojës për tregje ditore dhe të levizshme. Gjithashtu është realizuar hartimi i projektit të tregjeve të lëvizshme, është kryer procedura e tenderimit dhe është lidhur kontrata.

**P6.F3.O1.A3. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër**

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë

pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër, ashtu si vitin e kaluar, ka realizuar panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë. Në këtë panair, bizneset patën mundësinë të promovonin produktet e tyre, si një mundësi për tu njohur në tregun rajonal e më gjerë si dhe u njohën me potencialin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

**P6.F3.O1.A4. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative**

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Kjo pasuri mund të hulumtohet nga aspekte të ndryshme, sepse paraqet një fushë të gjerë, ku pa dyshim një vend të rëndësishëm zënë produktet agropërpunuese. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qellim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse u organizua panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair u prezantuan të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional, secila do të ndërtojë në panair stendën e saj. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vëndase.

**P6.F3.O1.A5. Panairi promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njesitë Administrative)**

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndismat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimit të shpirtit njerëzorë përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj.

Në këtë kuadër janë realizuar dy panaire në njësitë administrative të Gurit të Zi dhe të Anës së Malit. Aty u prezantuan pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Ky panair vlerësohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyre që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktiviteteve kulturore e më shumë prodhime vendase. Ky aktivitet konsistoi në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit.

**P6.F4.O1.A1. Hartimi dhe botimi i profilit të Bashkisë**

Bashkia Shkodër e përbërë tashmë nga 11 njësi administrative ka realizuar procesin e hartimit të profilit të ri të Bashkisë, një dokument informativ në të cilin në mënyrë të përmbledhur jepen të dhëna statistikore dhe informacion përshkrimor në lidhje me zonën dhe komunitetin e saj, duke përfshirë të dhëna gjeografike, historike, demografike dhe social ekonomike. Ky material prezanton në mënyrë të përmbledhur të gjithë territorin dhe tendencat e zhvillimit të saj.

**P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes ëeb te Bashkisë për sektorin e zhvillimit ekonomik**

Bashkia Shkoder nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës se informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes në Shkodër.

**P6.F4.O1.A4. Profili i bizneseve të Bashkisë Shkodër**

Hartimi i profileve të bizneseve të Bashkisë Shkodër synon të ofrojë një përmbledhje të historive të suksesit të këtyre bizneseve, duke bërë një historik të shkurtër që nga krijimi i tyre e deri në ditët tona, e gjitha kjo e pasuruar edhe me llojet e produkteve që këto ndërmarrje prodhojnë. Nga hartimi i këtyre profileve u botua një katalog, i cili ofron një panoramike të sipërmarrjeve lokale dhe produkteve të tyre, duke i dhënë mundësinë çdokujt të njohë më mire prodhimet apo shërbimet që ato ofrojnë, kapacitetin e prodhimit etj.

**P6. F5.O1.A1. Bashkepunimi me Zonën e përmirësimit të bisnesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori**

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfituan rreth 120 biznese.

**P6.F5.O1.A2. Krijimi i zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër**

Në vazhdim të bashkëpunimit që Bashkia Shkodër ka me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) me projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe Kolë Idromeno, si dhe duke u nisur nga interesimi që bizneset e rrugës Hamz Kazazi (zona Zdrale), kanë shfaqur për të krijuar zonën e tyre BID (Zona e Përmirëesimit të Biznesit), Bashkia Shkodër do të mbështesë iniciativen e tyre për të krijuar një zonë të re të Përmirësimit të Bisnesit. Qëllimi kryesor i Zones së Përmirësimit të Bisnesit është krijimi i mundësive ekonomike të përmirësuara, siguri dhe një klimë të mirë bisnesi mes anëtarëve të saj.

**P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit**

Njëndër instrumentët mëtëfuqishëm të marketingut territorial, ështëpromovimionline. Promocioni onlineofronavantazhe tëshumta dheështë lehtësisht iarritshëmngaçdopikëeglobit, mundtëpërditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka web-i për të bashkuar shumë element në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Aktualisht

BashkiaShkodërkanjë website zyrtar që i dedikohet turizmit. Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Turizmit ka hartuar termat e referencës për ndërtimin e webit të dedikuar, është bërë hostimi, blerë domani bashkë me 8 modulet shtesë. Webi i dedikuar për turizmin është: www.visitshkodra.gov.al. Ky portalpërmbanmaterialepromocionaledhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vinë në Shkodër. Duke pasur parasysh ritmet e zhvillimit të turizimit, tendencat e vazhdueshme për produkte të reja, do të jetë i nevojshëm azhornimii vazhdueshëm i informacioneve tëfaqes webpër turizmine Bashkisë Shkodër.

**P6.F6.O1.A2.Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smartphonë që shërben për informimin dhe orientimin e vizitoreve**

Numri i lartë i përdoruesve të internetit në ditët e sotme, bën që marketingu online të jetë i një rëndësie shumë të lartë. Mendimi i parë i çdo individi, kur kërkon të ketë një shërbim apo informacion, është ta kërkojë në internet. Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhepërmirësuarcilësinë eshërbimitpërturistët, krijimii njëaplikacionipër smartphone, icilideritanimungonte, meinformacionetdheorientimetenevojshmedrejtnevojave tëvizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, web-it, aksesi për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Gjatë vitit 2017 janë hartuar termat e referencës për krijimin e këtij aplikacioni. Duke qenë se kostoja ishte më e lartë sesa planifikimi, është menduar të realizohet në 2018 me një shtesë fondi për këtë zë.

**P6.F6.O1.A3. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër**

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. I gjithë territorri karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore te ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Si rezultat i zgjerimit të territorit të Bashkisë Shkodër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pritjes së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e tre zyrave të informacionit në Shkodër, Velipojë dhe Theth, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promocionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të ribotohet herë pas here. Gjatë vitit 2017 është realizuar publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër në gjuhën angleze (2000 kopje)- aktivitet i planifikuar në 2016 dhe i përfunduar në 2017 me trashëgim fondi dhe ribotimi i saj me përditësim informacioni (1200 kopje).

**P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turisitike së territorit të Bashkisë. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër**

Zonae Shkodrës gjithnjëemëtepër po tërheqvizitorëngashtetetëndryshmetëbotës. Këtovizitorëshpesh kanënevojëpër tëmarrëinformacion për vendetmeinteres dhemënyrënsesimundtëarrihetatje. Gjatë vitit 2017 është realizuar botimi i disa materialeve

promocionale të tilla si broshura e Thethit (1000 copë) dhe broshura e Velipojës (500 copë) të cilat përmbajnë hartën përkatëse dhe informacionet e nevojshme për një vizitor në këto zona. Nevoja për të pasur një hartë turistike të gjithë tërritorit të Bashkisë Shkodër, për të plotësuar nevojate vizitorëvepotencialtëBashkisë, ka qënë i domosdoshëm. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit ka bërë përzgjedhjen e modelit dhe përmbajtjes së informacionit që do të ketë harta turistike e Bashkisë Shkodër dhe ka përcaktuar termat e referencës për shërbimin e konsulencës. Harta e botuar do të vihet nëdispozicionttëvizitorëvengaZyraeInformacionitTuristik tëBashkisë

**P6.F6.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.**

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktivitetesh social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre organizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Stafi i Drejtorisë së Turizmit, ka konceptuar modelin, përmbajtjen, hartuar termat e referencës dhe mbledhur informacionin e nevojshëm si dhe ka bërë përkthimin në anglisht të tekstit të kalendarit. Është realizuar publikimi i këtij kalendari në gjuhën shqipe dhe angleze (800 kopje)

**P6.F6.O1.A6.Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmake etj.**

Materiale tëndryshmepromocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakëetj,janëmaterialeqëkanëkostotëlirëporndikimtë madhnëpromoviminenjëdestinacionitëcaktuar.Përtëpromovuar turizminnëdestinacion, janëmjaftmevlerëedhematerialetpromocionale, tëcilatnëshpërndarjen etyrelënënjëimazh të destinacionit.Ështëerëndësishmeqëprezantimet apotakimet qëdobëhenngastafii drejtorisësë turizmit, tëkenëmjetete nevojshmeidentifikuese. Në këtë kuadër, gjatë 2017, Drejtoria e Turizmit ka realizuar prodhimin e këtyre materialeve promocionale: çanta kartoni me logo të Bashkisë Shkodër (185 copë); Stilolapsa me ngjyra me logo të gdhendur (650 copë); Magnete (800 copë) dhe kartolina të dizenjuara (1600 copë);

**P6.F6.O1.A7. Blerje fotografish profesionale per publikimin e materialeve promocionale.**

Zona nën administrimin e Bashkisë Shkodër është një zonë që ofron varietet të konsiderueshëm atraksionesh turistike me një ofertë të pasur dhe me mundësi për zhvillimin e shumë aktiviteteve rekreative dhe argëtuese për vizitorët. Mundësitë për kombinimin e shumë lloje aktivitetesh janë të shumta, që nga turizmi kulturor, i diellit dhe rërës, mjedisor, familjar, rural, i aventurës etj. Me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit dhe marketingut të territorit, Drejtoria e Turizmit ka realizuar përgatitjen e shumë materialeve cilësore promocionale. Me vendim nr. 274 dt. 20.07.2017. "Miratimin e rishperndarjes se fondit brenda programit 4760, Zhvillimi i Turizmit te Buxhetit te Bashkise per vitin 2017", në kuadër të realizimit të këtyre materialeve janë blerë fotografi profesionale me rezolucion të lartë të atraksioneve kryesore turistike (30 fotografi)

**P6.F6.O2.A1.Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.**

Njëpikëefortëe ofertës turistike të Bashkisë Shkodërmetëcilënmundtëkonkurojmë denjësishtedhenënivelendërkombëtare,ështëartizanati. Nënjësituatënëtëcilënzhvillimi

ekonomikdherritjaemirëqënies po çojnë dalëngadalë drejthumbjes sëinteresitpër punimet artizanaledhezbehjen erëndësisësëtyresiaktivitet ekonomik, përshkak tërritjessëinteresit tëvizitorëvedhe tëturistëve tëshumtëqëvizitojnë qytetinpër punimet artizanaledhe suveniret, lindnevojaqëkëtozeje dhezanate tëpromovohendhetëmbështetensinjëelement tërheqësdheburimturistik. Punimet eqytetit tëShkodrës dhetëzonavepërrethmbetennjësuvenirimrekullueshëmsapovizitonkëtëqytet. Panairi është njëinstrument ifuqishëmqëndikondrejtpërdrejtënepromovimineketyrevleraveqe ka territori. Bashkia Shkodër, si çdo vit, organizoi me datë 17 qershor 2017 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Artizanatit: “Panairi i Artizanatit” me qëllim rritjeneinteresit për prodhimineprodukteveartizanale vendase dherritjeneatraktivitetit të territorit.

**P6.F6.O2.A3. Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës**

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, gjatë 2017, Bashkia Shkodër mori pjesë në 2 panaire ndërkombëtare: “Panairi Ndërkombëtar i Turizmit dhe Sportit”- Prishtinë ( 20-21 prill 2017) dhe “Panairi i Turizmit Mesdhetar”- Tiranë (08-09 prill 2017). Në kuadër të pjesmarrjes në panaire, jane prodhuar këto materiale promocionale: Wallbanner (1 copë); Roll up ( 2 copë); Fletëpalosje (1000 copë).

**P6.F6.O2.A4. Konceptimi, dizenjimi dhe prodhimi i nje stende të lëvizshme për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, me qëllim promovimin e destinacionit.**

Bashkia Shkodër në kuadër të zhvillimit të turizmit dhe me qëllim promovimin e Shkodrës si destinacion turistik në panaire dhe evente të ndryshme turistike, në kuadër të prodhimit të materialeve promocionale, gjatë 2017 ka realizuar dhe krijimin e një stende të lëvizshme katërkëndore me logon e Bashkisë Shkodër (1 copë); Baner “Jetoje Shkodrën” (1 copë); Tavolinë promocionale me logon e Bashkisë Shkodër për Shkodër dhe Theth (2 copë); Flamunj me bazament promocionalë (2 copë)

**P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit**

Bashkia Shkodër tashmë për të disatin vit rradhazi, ka zhvilluar edhe këtë vit Festën e Liqenit me datë 03 qershor 2017. Ky është një aktivitet promovues social kulturor dhe sportiv që organizohet me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë dhe shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit. Meanë tëorganizimit tëkëtijaktivitetiBashkiasynon tëruajëdhetëforcojë këtë traditëme qëllimtërheqjen evizitorëvedhendërgjegjësiminqytetar për vlerat ekoturistike, ekonomikedhemjedisore të Liqenit të Shkodrës

**P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit.**

Zhvillimi i turizmit ka ecur me hapa të shpejtë në vitet e fundit. Numri i vizitorëve ka ardhur vazhdimisht në rritje nga viti në vit dhe po ashtu edhe shtrirja gjeografike e prejardhjes së tyre. Gradualisht sektori i turizmit po shndërrohet në një ndër sektorët lider të zhvillimit ekonomiktë

Shkodrës. Bashkia Shkodër, duke kuptuar rëndësinë e zhvillimit të turizmit, i ka dhënë përparësi të veçantë zhvillimit të tij, duke forcuar kuadrin institucional që punon në këtë drejtim. Gjithashtu për të ndërgjegjësuar edhe më shumë komunitetin dhe biznesin, për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, Bashkia Shkodër organizon çdo vitnjë festë kushtuar turizmitnë ditën botërore të turizmit me datë 27 Shtator, duke zhvilluar aktivitete të ndryshme me qëllim evidentimin dhe promovimin më tej të vleravedhe potencialeve turistike që ka territori i Bashkisë Shkodër. Këtë vit, me datë 27.09 2017, u organizua konferenca me temë "Turizmi i qëndrueshëm, instrument zhvillimi" në bashkëpunim me Universitetin " Luigj Gurakuqi", Fakultetin Ekonomik- dega Turizëm; Të pranishëm në konferencë ishin përfaqësues të institucioneve vendore, bizneseve turistike dhe OJF që operojnë në fushën e turizmit.

**P6.F6.O3.A4. Hapja e sezonit turistik Velipojë.**

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit shqiptar me vlera dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla, që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë ne kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Këtë vit, ky aktivitet u realizua me datë 1 maj dhe konsistoi në organizimin e një koncerti të madh festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga atistë të qytetit të shkodrës si edhe nje grup valltarësh, lojra sportive ( volejboll, futboll dhe hemboll dhe gara me varka me vela dhe kanoe.

**P6.F6.O3.A5 Festa e Thethit.**

E kthyer tashmë në traditë, edhe këtë vit u organizua hapja e sezonit turistik në Theth. Me datat 26- 27 Maj 2017 u zhvillua një koncert me muzikë, këngë e valle tradicionale nga zona e Thethit, ngjitje në mal, vizitë në ujëvarën e Grunasit dhe Syrin e Kalter, vizita në Kullën e Ngujimit si dhe në shtëpitë pritëse të zonës. Në koncertin me këngë nga grupi "Treva" dhe me valle tradicionale të zonës nga trupa e valltarëve, u përfshinë të rinj, fëmijë, familje nga zona e Dukagjinit, të cilët imituan pjesë nga ritet tradicionale dhe zakonet e dasmave të zonës, të veshur me kostume popullore. Një ekspozitë fotografike digjitale me përfshirjen e 10 të rinjve të apasionuar pas natyrës dhe fotografisë u realizua gjatë këtij eventi. Fotografët e rinj perveç fotografimit të peisazhit, fotografuan të ndarë në grupe sipas lëvizjes të gjithë veprimtaritë e zhvilluar gjatë aktivitetit. Këto foto iu vunë në dispozicion operatoreve turistik në zonën e Thethit, Bashkisë Shkodër dhe agjencive turistike dhe u publikuan në median lokale, median sociale, FB, Instagram dhe Youtube.

**P6.F6.O3.A6. Dita e biçikletave.**

Bashkia Shkodër me qëllim promovimin e vlerave të përdorimit të biçikletës si një mjet për transport më ekonomik, më i shëndetshëm dhe tradicional në qytetin tonë, organizoi me datë 16 shtator 2017 "Dita e biçikletave". Kjo festë synon që të promovojë shërbimet e bicikletave nga bizneset vendase, identifikimin e njerëzve simbol në përdorimin e saj si dhe të angazhojë qytetaret në aktivitetet që do të realizohen me këtë rast. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me organizatën "The Door". Pjesë e këtij aktiviteti ishte ekspozita fotografike, e cila kishte si qëllim identifikimin e personazheve simbol të qytetit, të cilët e perdorin biçikleten në jetën e përditshme. Kjo ekspozitë u realizua me disa foto artistike të fotografit Shkelzen Rexha nga Gjakova, fotografë shkodrane, foto nga Muzeu Kombëtar

Marubi dhe qëndroi e hapur për një javë në rrugen Kole Idromeno. Elementë të tjerë ishin performanca e Cirkut të Tiranës, xhiroja demonstrative, Konkursi i biçikletës dhe laboratori kreativ për fëmijë dhe të rinj me temë bicikleta.

**P6.F6.O3.A7. Triathlon**

Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive si një mënyre e shëndetshmë e të jetuarit, Bashkia Shkodër organizoi me datë 2 shtator 2017: "Triathlon Labeat"- 2017. I kthyer tashmë në traditë, ky aktivitet shënoi dhe 5 vjetorin e festimit të tij. Triathlone është një aktivitet tre-garësh në tre disiplina sportive të ndryshme, si gara e notit, ciklizmi dhe vrapimi, për të cilat ne jemi shumë krenarë për traditën dhe rezultatet e shkëlqyera që sportistët tanë profesionistë dhe amatorë kanë dhene ndër vite. Aktiviteti u zhvillua në një nga zonat më të bukura të Bashkisë Shkodër, që shtrihet në të gjithë gjatësinë e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës: Shirokë - Zogaj. Në këtë garë të Triathlonit, pati një interes të shumtë për pjesmarrje jo vetëm nga Shkodra, por dhe nga qytete të tjera të Shipërisë. Inteses të madh kishte këtë vit dhe nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Europës. Duke qenë se është një garë në 3 disiplina, u mendua që këtë vit të pranohen në garë jo më shumë se 55 persona, për arsye mirë organizimi dhe sigurie. Fituesit e garave u ndanë në katër kategori: Meshkuj të rritur; femra të rritura, junior dhe fëmijë. Qëllimi i zhvillimit të aktivitetit ishte: Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive ujore; Të ndërgjegjësojë komunitetin për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive ujore si Liqeni i Shkodrës.

**P6.F6.O4.A2. Lidhja e rrjetit elektrik ne Zyrat e Informacionit Turistik ne Shkoder dhe Velipojë**

Gjatë vënies në funksionim të Zyrës së Informacionit Turistik në qytetin e Shkodrës, u konstatua që pika më e afërt nga mund të realizohej lidhja me rrjetin elektrik ndodhej në një distancë prej 150 m nga kjo zyrë, distancë kjo për të cilën Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) nuk e parashikon në kontratën lidhur me të. Me qëllim vënien në funksion të plotë të Zyrës së Informacionit Turistik ishte e domosdoshme që të blihet një kabëll elektrik për të bërë të mundur realizimin e kësaj lidhje. Me Vendim Kryetari nr. 274 dt. 20.07.2017. "Miratimin e rishperndarjes se fondit brenda programit 4760, Zhvillimi i turizmit te Buxhetit te Bashkise per vitin 2017", u realizua blerje kablli elektrik për realizimin e lidhjes së energjisë për ZIT- Velipojë dhe lidhja e 2 kontratave me OSHEE përkatësisht për të dyja zyrat e informacionit Shkodër dhe Velipojë.

**P6.F6.O4.A2. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në teritorin administrativ të qytetit Shkodër**

Projekti për spostimin dhe konstruksionin e zyrës ekzistuese turistike të qytetit të Shkodrës ka përfunduar gjatë vitit 2016. Është realizuar procesi i tenderimit; është përcaktuar vendodhja e re e objektit. Punimet kanë përfunduar në 2017 për shkak të rishikimit të preventivit të kontratës ( bazuar në procesverbalin nr. 1625/b, datë 18.05.2017

**P6.F6.O4.A3. Paisja e zyres se informacionit turistik ne Theth me materiale funksionale dhe promocionale**

Ngritja e zyrës së informacionit turistik në Theth është realizuar. Kjo zyrë do të menaxhohet në bashkëpunim me AdzM. Është bërë rekrutimi i stafit dhe është vënë në funksion kjo zyrë. Për mirëfunksionimin e saj ishte e domosdoshme pajisja e zyrës me materiale zyre funksionale. Me Vendim Kryetari nr. 274 dt. 20.07.2017. "Miratimin e rishperndarjes se fondit brenda programit 4760, Zhvillimi i turizmit te Buxhetit te Bashkise per vitin 2017", u realizua blerja e këtyre

materialeve: printer, ekran TV promocional, shporet për ngrohje, materiale promocionale si harta ( 90 copë).

**P6.F6.O5:A2.Hartimi i planit të sinjalistikës turistike të Bashkisë Shkodër.**

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Meqënëse numri i vizitorëve në rajonin e Shkodrës po rritet nga viti në vit, është e nevojshme vendosja e sinjalistikës turistike me qëllim orientimin e rezidentëve dhe turistëve në këtë rajon. Mungesa e saj mbetet një handikap për Bashkinë dhe në kuadër të reformës së re territoriale me zgjerimin e territorit të saj, hartimi i planit të sinjalistikës turistike mbetet një ndër nevojat kryesore për tërheqjen e vizitorëve në rajonin e Shkodrës. Gjatë 2017, Drejtoria e Turizmit nuk arriti ta finalizonte Planin e Sinjalistikës si produkt. Janë bërë studime dhe janë përcaktuar termat e references në lidhje me përmbajtjen e këtij plani dhe buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2018 në fondet e trashëguara.

**P6.F6.O5:A3.Ngritja e bordit këshillimor të përhershëm me perfaqësues të të gjithë aktorëve të interesuar në zhvilimin e turizmit**

Situata e zhvillimit të turizmit në Shkodër ka ndjekur prirjet e zhvilimit të turizmit në Shqipëri me rritje të vazhdueshme të interesit të vizitorëve për të vizituar territorin e Bashkisë Shkodër. Gjithashtu përpjekjet kanë qenë të mëdha dhe të shumëanshme për orientimin e këtij zhvillimi. Megjithatë vihet re mungesa e koordinimit të këtyre përpjekjeve si edhe bashkërendimi i tyre mes bizneseve, institucioneve lokale publike, universitetit dhe institucioneve qendrore merr një rëndësi parësore në kushtet aktuale të zhvillimit të turizmit. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër ka ngritur bordin këshillimor të përhershëm, një strukturë konsultative, aktiviteti i së cilës ndihmon në planifikimin strategjik të zhvillimit të turizmit si edhe në vendimmarrjen për sa i përket drejtimeve kryesore në të cilat do të duhet të fokusohen përpjekjet për zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër.

**P6.F6.O6:A1 Trajnime me gratë sipërmarrëse që operojnë në clustera të ndryshme të bizneseve turistike.**

Për turizmin, 2017-a ishte një vit me rritje pozitive, përsa i përket shifrave të numrit të vizitorëve. Sipas statistikave të grumbulluara nga bashkia Shkodër për 9-mujorin e parë të vitit, numri i turistëve u rrit me rreth 10% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Megjithatë, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe rritja e kapacitetit që ka të bëjë me industrinë e mikpritjes, vazhdojn të mbeten sfidat kryesore. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër me datë 07/11/2017 zhvilloi aktivitetin "Trajnime me gratë sipërmarrëse, që operojnë në clustera të ndryshme të bizneseve turistike". Ky aktivitet kishte si qëllimpërmirësiminecilësisësëshërbimevedherritjen enumrit tëturistëve në territorineBashkisëShkodër. Trajnimi u realizua nga pedagogë të fakultetit ekonomik, dega turizëm në universitetin " Luigj Gurakuqi", sipas temave: Shërbimet e duhura për një mikpritje të mirë; Strategjitë e çmimit dhe kanalet e shpërndarjes, si instrumentë për sukses; Pse perceptimi që kemi mbi eksperiencën konsumatore është gabim; U trajnuan 25 gra dhe të reja, përfaqësuese të bujtinave në Theth dhe hosteleve në Shkodër.

**P6.F6.O7:A4. Përmiresimi i vizitueshmerisë së ballkonit jugperendimor të kalasë nëpërmjet pastrimit të vegjetacionit dhe ngritjes së një strukture të lëvizshme (që mund të çmontohet në çdo moment) prej druri ose metalike**

Sapo përmendim Shkodren, gjëja e pare që mund të na vijë ndër mend në lidhje me këtë qytet është kalaja Rozafa. Prandaj, lind nevoja e përmirësimit të aksesit në zona të ndryshme të saj me qëllim bërjen te vizitueshme të kësaj kalaje. Duke qenë një nga zonat më atraktive të qytetit tonë dhe një shenjë identifikimi për veriun në përgjithësi, është e domosdoshme ndërhyrja në të. Ballkoni jugperëndimor i kalasë është ndër pikat më të bukura të qytetit, me një panoramë të jashtëzakonshme të bashkimit të 3 lumenjve dhe ku fillon e hapet fusha e nënshkodrës. Aktualisht arritja e këtij është e pamundur pasi nuk ka shkallë që zbresin tek ai dhe përveç kësaj vegjetacioni i papastruar prej vitesh e bën të pamundur që të vizitohet. Ngritja e një strukture të përshtatshme dhe në përputhje me normat në fuqi për ndërhyrjet në objektet monument kulture do të përmirësonte aksesin dhe do të rriste atraktivitetin e Kalasë Rozafa. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit, gjatë 2017 ka realizuar analizën e gjendjes faktike, studimin e vendit dhe të pozicionit të vendosjes së strukturës së lëvizshme. Është hartuar projekti teknik dhe është aplikuar pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimit pranë Ministrisë së Kulturës për marrjen e lejes për ndërhyrje dhe është në pritje të miratimit të lejes. Fondi në dispozicion për këtë zë buxheti, ka kaluar si fond i trashëguar në 2018 dhe ky aktivitet do të realizohet në momentin e miratimit të lejes.

## III Fondet e financimit te programeve

Me VKB nr. 65, dt 30.10.2017 për rishpërndarje të fondeve të Buxhetit të vitit 2017 të Bashkisë Shkodër, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 7,672.485 lekë me tvsh për aktivitetin: Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus (shtesë e vlerës së planifikuar).
Me vendim të Kryetares së Bashkisë, nr 274, dt 20.07.2017, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 366,600 lekë për aktivitetet e mëposhtme:
Lidhja e rrjetit elektrik ne Zyrat e Informacionit Turistik ne Shkoder dhe Velipoje
Paisja e Zyres se Informacionit Turistik ne Theth me materiale funksionale dhe promocionale
Blerje fotografish profesionale per publikimin e materialeve promocionale.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017**

Fondet e miratuara sipas planit tw korrigjuar, për këtë program janë 23,752.2 mijw lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 20,705.2 mije në masën 87.17 % ndaj planit vjetor tw korrigjuar.

1. Shpenzimet Operative janë realizuar në masën 3,361.99 mije lekë nga 4,630.12 mije lekë sipas planit vjetor të korrigjuar Realizimi 72.61%.
2. Transferta janë realizuar në masën 3,299.34 mije lekë nga 3,350 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 98.48 %.
3. Investimet janë realizuar në masën 14,044.18 mije lekë nga 15,772.09 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 89%.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

| Aktiviteti | Buxheti | Plani Korrigjuar | Realizimi 12-mujori |
|---|---|---|---|

| | në mijë lekë | | 2017 në mijë lekë |
|---|---|---|---|
| P6.F1.O1.A4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Shkodër | - | | - |
| P6.F1.O1.A5. Studim fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër | - | | - |
| P6.F2.O1.A3. Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus | 4,000 | 11,672.49 | 11,406.48 |
| P6.F2.O1.A4. Përcaktimi i hapsirave dhe ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores për funksionimin e tregjeve të levizshme | 2,500 | 2,500 | 2,208.1 |
| P6.F3.O1.A3. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër | 200 | 200 | 184.8 |
| P6.F3.O1.A4. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative | 200 | 200 | 100.8 |
| P6.F3.O1.A5. Panairi promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njesitë Administrative) | 250 | 250 | 117 |
| P6.F4.O1.A1. Hartimi dhe botimi i profilit të Bashkisë | | - | - |
| P6.F4.O1.A4. Profili i bizneseve të Bashkisë Shkodër | 300 | 300 | 220 |
| P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes ëeb te Bashkise per sektorin e zhvillimit ekonomik | - | - | - |
| P6.F5.O1.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori | 1,600 | 1,600 | 1,600 |
| P6.F5.O1.A2. Krijimi i zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër | - | | - |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes ëeb për turizmin e rajonit të Shkodrës | 260 | 260 | 161.40 |
| P6.F6.O1.A2.Konceptim dhe krijim i nje aplikacioni per smartphone qe sherben per informimin dhe orientimin e vizitoreve. | 120 | 120 | - |
| P6.F6.O1.A3. Pergatitja dhe publikimi I guidës turistike të Bashkisë Shkodër. | 360 | 360 | 281.76<br>- |
| P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turisitike së territorit të Bashkisë | 310 | 310 | - |
| P6.F6.O1.A5. Publikimi I kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë | 100 | 68 | 68 |
| P6.F6.O1.A6.Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmake etj. | 200 | 186 | 186 |
| P6.F6.O1.A7. Blerje fotografish profesionale per publikimin e materialeve promocionale. | | 26.60 | 20.83 |
| P6.F6.O2.A1.Panairi i artizanatit ne diten nderkombetare te artizanatit. | 400 | 284 | 284 |
| P6.F6.O2.A3. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | 450 | 255.8 | 255.8 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P6.F6.O2.A4. Konceptimi, dizenjimi dhe prodhimi i nje stende te levizshme per pjsemarrje ne aktivitete te ndryshme me qellim promovimin e destinacionit. | 350 | 339.6 | 339.6 |
| P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit | 300 | 300 | 299.3 |
| P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit | 250 | 250 | 169.6 |
| P6.F6.O3.A4. Hapja e sezonit turistik Velipoje | 400 | 400 | 400 |
| P6.F6.O3.A5. Feste e Thethit | 400 | 400 | 400 |
| P6.F6.O3.A6. Dita e biçikletave | 300 | 300 | 300 |
| P6:F6:O3:A7. Triathlon | 250 | 250 | 250 |
| P6.F6.O4.A2. Lidhja e rrjetit elektrik ne Zyrat e Informacionit Turistik ne Shkoder dhe Velipoje | | 90 | 89.13 |
| P6.F6.O4.A3. Paisja e zyres se informacionit turistik ne Theth me materiale funksionale dhe promocionale | | 250 | 180 |
| P6.F6.O5:A2.Hartimi i planit te sinjalistikes turistike te Bashkise Shkoder. | 400 | 400 | - |
| P6.F6.O5:A3.Ngritja e bordit keshillimor te perhershem me perfaqesues te te gjithe aktoreve te interesuar ne zhvilimin e turizmit | - | - | - |
| P6.F6.O6:A1Trajnime me gratë sipërmarrëse që operojnë në clustera të ndryshme të bizneseve turistike. | 300 | 300 | 240 |
| P6.F6.O7:A4.Permiresimi i vizitueshmerise se ballkonit jugperendimor te kalase nepermjet pastrimit te vegjetacionit dhe ngritjes se nje strukture te levizshme (qe mund te cmontohet ne cdo moment) prej druri ose metalike | 700 | 700 | 0 |
| **TOTAL** | **14,900** | **22,572** | **19.763** |

## IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Publikimi i hartës turistike të territorit të Bashkisë: Nuk u arrit të kryhej prokurimi publik për shkak të pamundësisë për të respektuar afatet ligjore për realizimin e procedurës. Fondi në dispozicion do të kalojë si fond i trashëguar dhe aktiviteti do të realizohet në 2018.
- Aplikacioni Smart Phone nuk u arrit të realizohej sepse realizimi i produktit kishte vlerë më të lartë se vlera e parashikuar në buxhet.

- Plani i Sinjalistës së territorit të Bashkisë: Nuk u arrit të kryhej prokurimi publik për shkak të pamundësisë për të respektuar afatet ligjore për realizimin e procedurës. Fondi në dispozicion do të kalojë si fond i trashëguar dhe aktiviteti do të realizohet në 2018.
- Përmirësimi i vizitueshmërise së ballkonit jugperendimor të kalasë nëpërmjet pastrimit të vegjetacionit dhe ngritjes së nje strukture të lëvizshme, nuk u realizua për shkak se pritet ende miratimi i lejes nga Këshillit Kombëtar i Restaurimit pranë Ministrisë së Kulturës. Duke qënë se është hartuar projekti teknik, fondi në dispozicion do të kalojë si fond i trashëguar dhe aktiviteti do të realizohet në 2018 në momentin e miratimit të lejes për ndërhyrje.

## P7 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë. Synimi afatgjatë kryesor është racionalizimi i modelit të fshatrave përsa i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

Rreth 43% e popullsisë së Bashkisë Shkodër jeton në zonat rurale. Numri i fermave bujqësore është rreth 11,200 me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 ha/fermë e ndarë në 2-3 parcela. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokë subargjilore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV. Me delegimin e funksioneve të reja Bashkia Shkodër ka trashëguar 213 km kanale ujitëse, nga këta 37 km janë funksionale dhe 176 km janë jo funksionale, ndërsa kanale kulluese janë gjithsej 622.7 km prej të cilave 142.7 km janë kanale të dyta dhe 480 km janë kanale të treta kulluese.

Sot problemi kryesor mbetet fragmentarizimi i tokës, gjë e cila krijon probleme në adoptimin e skemave të subvencioneve dhe futjes së teknikave të reja (modernizimit për të qenë me konkurent në tregjet e brëndshme), prandaj është domosdoshmëri përfundimi i proçesit të rregjistrimit të tokës dhe krijimin e tregut të saj.

### I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2017 ka fokusuar përpjekjet e saj në 3 funksione zhvillimi:

F1. Administrimi i infrastruktures vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F2. Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.

F3. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit.

Objektivat për secilin funksion janë:

P7.F1.O1 Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit

P7.F2.O1 Krijimi i sistemit te informacionit per administrimin, perdorimin e tokes mbeshtetur ne teknologji bashkekohore. Plotesimi i dokumentacioneve perkatese te pronesive private

P7.F3.O1 Krijimi i databazës së informacionit bujqesor. Krijimi i struktures keshillimit bujqesore

P7.F4.O1 Perthithja e granteve nga programet per zhvillimin e bujqesise dhe te zhvillimit rural

Produktet për vitin 2017

F1.O1.A5. Pastrim kanalesh ujitese dhe kulluese për NjA

Gjatë vitit 2017 Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ( si institucion varësie) ka ushtruar veprimtarine në realizimin e objektivit të parë :Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit:

Bazuar ne planin e punës per vitin 2017 ishte si objektiv mirëmbajtja dhe rehabilitimi i 15 km kanale ujitës me një sipërfaqe të përmirësuar ujitjeje prej 500 Ha.

Gjatë vitit 2017 është arritur të mirëmbahen dhe rehabilitohen gjithsejt 17.03 km KU. ( KUII , KUIII) me një sipërfaqe të përmirësuar ujitjeje prej 817 Ha tokë bujqësore.

Për realizimin e ketyre ndërhyrjeve janë evidentuar në terren dhe hartuar projektet për pastrimin e 4 kanaleve ujitëse ( KU-22 , KU-22/1 Nj.A. Bërdicë dhe KU- Grudë e Re , KU-Guci e Re , Nj.A Rrethinat.) me një vlere totale prej 140 038 lekë dhe volum pastrimi 911 m3. Sipërfaqja e përmirësua e ujitjes 115 Ha.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave, ka qënë prioritet i Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë. Kështu për vitin 2017 Drejtoria e Bujqësisë kishte programuar ndërhyrje pastrimi dhe kthimi në gjëndje funksionale me mjetet e veta të 55.9 km kanale kulluese të dyta dhe të treta të cilat do përmirësonin kullimin në 2251 Ha tokë bujqësore.

Inventari i mjeteve të bashkise Shkodër i përbëre nga vetëm dy eskavatore, një mesatar dhe nje mjet tjeter më i vogël, ka kushtëzuar deri diku synimin dhe deshirën për planifikim më të madh dhe realizimin e nderhyrjeve të pastrimit. Kjo edhe për arsye se në inventarin e Bashkisë këto mjete kanë ardhur në muajin Mars. Gjithsesi, me mjetet në dispozicion , me një planifikim për sa ishte i mundur efikas , mbas evidentimit të kanaleve kulluese për çdo Njësi Administrative dhe hartimit të 54 projekteve teknike të ndërhyrjeve është arritur të pastrohen 56.43 km kanale të dyta dhe të treta kulluese në territorin e Bashkisë me një volum pastrimi prej 73,160 m3. Punimet e kryera bëjnë të mundur që të përmirësohet kullimi në një sipërfaqe totale prej 2400 Ha.

Më saktësisht ndërhyrjet gjatë vitit 2017 për çdo Njësi Administrative janë si vijon:

Nj.A. Ana e Malit
Gjithsejt KK pastruar - 12.86 km nga këto KK II -3.83 km, KKIII-9.03 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 647 Ha
Volume gërmimi : 13,083 m3
Nj.A. Bërdicë
Gjithsejt KK pastruar - 12.77 km nga këto KK II -1.77 km, KKIII-11 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 413Ha.
Volume gërmimi : 13,733 m3
Gjithsejt KU rehabilitim/pastrim - 7.8 km.
Sipërfaqe përmirësuar ujitje - 335 Ha.

Nj.A. Dajç
Gjithsejt KK pastruar - 17.7 km nga këto KK II - 9.9 km, KKIII- 7.8 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 697 Ha
Volume gërmimi : 21,320 m3
Nj.A. Guri i Zi
Gjithsejt KK pastruar - 9.27 km nga këto KK II -4.27 km, KKIII-5 km

Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi -473 Ha.
Volume gërmimi: 18,461 m3
Gjithsejt KU rehabilitim - 1 km.
Sipërfaqe përmirësuar ujitje - 100 Ha.
Nj.A. Rrethina.
Gjithsejt KKII pastruar - 3.83 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 170 Ha
Volume gërmimi : 6563 m3
Gjithsejt KU rehabilitim/pastrim - 8.23 km
Sipërfaqe përmirësuar ujitje - 150 Ha.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me I.S.D.C. ( Qëndrës për Zhvillim të Qëndrueshem dhe të Integruar) me mbështetjen e projektit Lëviz Albania ka hartuar "Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit" i cili përfshin 5 Njësi Administrative

( Nj.A. Guri i Zi, Nj.A. Ana e Malit , Nj.A Bërdicë, Nj.A Dajç, Nj.A. Velipojë).

Për realizimin e këtij Plan-Veprimi janë ngritur grupe pune për vëzhgim dhe analizë të gjëndjes si dhe problematikave të sistemit kullues.

Duke qënë se Bashkia Shkodër kishte trashëguar material hartogrtafik të mangët dhe në shumë raste të pasaktë të skemave kulluese është përfunduar inventarizimi i plotë i kanaleve të dyta dhe të treta kulluese . Për herë të parë është realizuar hedhja në format digjital të hartave të skemave kulluese për çdo kanal të inventarit fizik të Bashkinë Shkodër.

Në analizimin e gjendjes dhe punëve te realizuara është bërë planifikimi i ndërhyrjeve të detajuara të parashikuara për vitin e ardhshem, llogaritja e kostos dhe e volumeve për çdo kanal ku do ndërhyhet.

Me përfundimin e një dokumenti të tillë Bashkia Shkodër është tashmë në gjëndje jo vetëm të pasqyrojë dhe dokumentojë saktësisht inventarin dhe gjëndjen e tij për çdo segment kullues por edhe të planifikojë ndërhyrje më efikase me kosto të përllogaritura saktë.

Ky Plan-Veprim është miratuar nga Këshilli Bashkiak Shkodër me datë 30.11.2017.

F1.O1.A6- Mirembajtje e skemes ujitese

Bashkangjitur projekteve teknike ekzistuese dhe të hartuara, janë përgatitur dokumentacionet e plota për prokurim për dy segmentet e skemave ujitëse të Gurit të Zi dhe Bërdicës ( KU -20 , KU-33 , KU33-3 ) me një vlerë totale prej 27 593 969 Lekë , me gjatësi ndërhyrjeje për rikonstruksion të plotë prej 7.1 km. Rehabilitimi i këtyre rrjeteve ujitëse ka përmirësuar sistemin e ujitjes në një sipërfaqe prej totale 450 Ha, respektivisht 350 Ha në Nj.A. Bërdicë dhe 100 Ha në Nj.A. Guri i Zi.

Është bërë evidentimi i kanaleve të skemës ujitëse Bardhaj-Bleran dhe rikonstruksion vepër arti një një segment të KU Guri i Zi për të cilat janë hartuar projektet teknike të detajuara dhe përgatitur dokumentacioni për procedurën e prokurimit. Punimet për rehabilitim në Nj.A Rrethinat janë kryer në KU-3 , KU-3/2 , KU-3/3 , KU-3/4 , KU-3/21 , KU-3/22 Nj.A. me një gjatësi të përgjithshme prej 7.18 km , me një volum punimesh prej 1389 m3 dhe sipërfaqe të përmirësuar ujitjeje prej 252 Ha. Vlera e punimeve 4 974 000 lekë.

Punimet për rikonstruksion vepër arti në segmentin KU Guri i Zi përfshijnë vendosje portash, vendosje tubash, struktura monolite betoni.

F1.O1.A7- Zbatimi i projekteve teknike prioritare per sistemin e ujitjes ,kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni

Bazuar ne kontraten e financimit ndermjet GIZ dhe Bashkise Shkoder me qellim mbeshtetjen dhe lehtesimin e zbatimit te masave te pershtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit te

rrezikut nga permbytjet ne zonat e nen Shkodres si pjese e marreveshjes qeveritare ndermjet Qeverise se Republikes Federale te Gjermanise dhe Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe te Marreveshjes se zbatimit ndemjet Gesellschaft Fur Internationale Zusammenarbeit ( GIZ) GmbH me Ministrine e Mjedisit per projektin " Pershtatja ndaj ndryshimeve klimatike ne menaxhimin e rrezikut nga permbytjet, Ballkani Perendimor, Bashkia Shkoder, ne respekt te kesaj marreveshje financimi, ka filluar zbatimin e masave ne permbushje te detyrimeve te projektit duke u adresuar, ne perputhje dhe me objektivat specifike te projektit,ne nderhyrje ne sistemet e kullimit ne zonat e prekura me shume nga permbytjet.

Janë hartuar projektet dhe përgatitur dokumentacioni për ndërhyrjet në 6 (gjashtë) kanale kulluese sipas marrëveshjes së Bashkisë Shkodër me GIZ. Ndër këto 3 kanale kulluese me procedurë prokurimi me një gjatësi prej 3.5 km dhe vlerë 2,625,304 Lekë dhe (3) tre kanale të tjera kullimi me mjetet e bashkisë me karburant të financuar nga GIZ me një gjatësi prej 2.15 km.

F2.O1.A1-Krijimi i kadastres bujqesore dhe arshives se saj dhe futja ne sistem e zonave te parilevuara

Të dhënat në regjistrin e pronave bujqësore rezultojnë të jenë me mangësi dhe informacione të pjeshme në lidhje me të dhënat kadestrale.

Në këtë kuadër është krijuar sektori i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës. Është siguruar rreth 80% e listës së familjeve përfituese të tokës në pronësi (Formulari 06) të Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, gjithashtu është siguruar lista e pronarëve të trojeve dhe shtëpive ( Formulari 01), Harta kadastrale 1: 5000 të Njësive Administrative malore etj.

Është krijuar dhe vazhdon proëesi i përditësimit të regjistrit elektronik të listave të familjeve përfituese të tokës në pronësi sipas ligjit nr. 7501 dhe VKM nr. 452, datë 17.10.1992, si dhe ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 për Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër. Listë kjo e realizuar nëpërmjet krahasimit dhe verifikimit të Formularit nr. 06 me listen e banorëve kryefamiljar të vitit 1991.

F2.O1.A3. Mbeshtetja e regjistrimit te pronave me shpenzimet e Bashkise

Në zbatim të ligjit Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” , VKM nr 994 datë 09/12/2015 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore , Drejtoria e Bujqesise që në krijimin saj ka nisur dhe vazhduar punën për proceduarat e kalimit në pronësi të tokës bujqësore për ish kooperativat bujqësore dhe ish ndërmarrjet bujqësore.

Puna për zbatimit dhe përmbushjen e detyrimeve funksionale ka konsistuar në:

Verifikim i kërkesave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore dhe dërgim pranë Z.V.R.P.P. për regjistrim të pasurisë , arkivimi i kopjes së praktikes , regjistrimi në sistem i praktikës A.M.T.P. së përpunuar për cdo subjekt kërkues që ka kryer aplikimin nëpërmjet Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).

Krijimi, regjistrimi dhe azhornimi i përditshëm i një database të të gjitha aplikimeve për verifikimin dhe përcjelljen e praktikave për regjistrimin në pronësi të tokës bujqësore pranë Z.V.R.P.P. Shkodër.

Për vitin 2017 numri i praktikave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore të përpunuara nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP është:

-aplikime të perpunuara 945 praktika

nga të cilat:

-përcjellë pranë Z.V.R.P.P. Shkodër për regjistrim - 632 praktika

-Kthyer përgjigje për plotësim të mëtejshëm dokumentacioni - 313 praktika

Për sa i përket zbatimit të ligjit Nr 171/2014 “Për përfundimin e Procedurave Ligjore të Kalimit të Tokës Bujqësore të Ish-Ndërrmarrjeve Bujqësore në Pronësi të Përfituesve” janë mbledhur 203 kërkesa të përfituesve të cilët nuk janë paisur me A.M.T.P. pranë Njësive Administrative .

Për vazhdimin e mëtejshem të kësaj procedure është e domosdoshme paisja me materiale dhe dokumentacione kadastrale nga ana e institucioneve përkatëse Me gjithë angazhimin tonë , kërkesat e vazhdueshme dhe të përsëritura pranë Z.V.R.P.P. Shkodër këto materiale, në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe administrative, nuk na janë vënë akoma në dispozicion duke bërë të pamundur deri tani vazhdimin e procedurave për regjistrim të përfituesve që nuk janë paisur me A.M.T.P.

F3.O1.A4-Promovim produktesh bujqesore dhe blegtorale nepermjet panaireve

Në përmbushje mbeshtetjes së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale te prodhuesve lokalë Bashkia Shkodër ka organizuar Panairin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë aktivitet pjesëmarrësit, prodhues të produkteve lokale dhe autoktone bujqësore dhe blegtorale promovuan aktivitetet e tyre prodhuese.

F4.O1.A1-Promovim dhe asistence teknike ne hartim projekte, plan biznese per perthithje te granteve.

Në bashkëpunim me projektin " Agro-Tourism Albania" janë organizuar dy takime informuese për transformimin e fermave me potencial të lartë në ferma agro-turistike. Është arritur të eviodentohen dhe ka filluar mbështetja në Bashkinë Shkodër për dy ferma, sipas planit të përbashkët me " Agro-Tourism Albania". Bëhet fjalë për dy ferma model të ndodhura njëra në Nj.A. Ana e Malit, fshati Muriqan dhe tjetra në Nj. A. Guri i Zi, fshati Ganjoll.

Është punuar, në bashkëpunim me GIZ, për evidentimin , promovimin dhe rritjen e tufave të deleve autoktone " deles shkodrane" Për këtë janë realizuar katër takime me fermerë të cilët mbarështrojnë këtë racë autoktone.

## II Fondet e financimit të programeve

Fondet e miratuara për këtë program janë 33,388 mije lekë, 33 % paga dhe sigurime, 55 % shpenzime operative dhe 12 % investime, pergjate vitit buxhetor plani eshte rishikuar ne masen 101 597 mije lek. Realizimi për përiudhën 12 mujore është 47 816 mije lekë në masën 47 **%** ndaj planit vjetor.

**Realizimi i fondeve për përiudhën 12-mujore 2017**

Fondet totale te programit jane realizuar 23,750 mije leke ose ne masen 73 %, tre ndara si me poshte:

1. Paga e sigurime janë realizuar në masën 5,832 mije lekë nga 18,089 mije lekë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 32%.
2. Shpenzime Operative janë realizuar në masën 14,981 mijelekë nga 18,370mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 82 %.
3. Investimet jane realizuar ne masen 3,146 mije lek nga 4,040 mije leke qe ka qene e parashikuar ne planin e korigjuar, realizimi ne masen 78% .

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare

| **Aktivitete/Projekte** | **Plani Fillestar** | **Plani Korrigjuar** | **Realizimi** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| P7.F1.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P | 18,089 | 12,743 | 6,056 |
| P7.F1.O1.A3-Nxitja e krijimit te Shoqatave te perdoruesve te ujit ne çdo Nj.A dhe trainimi i tyre | 300 | 300 | - |
| P7.F1.O1.A5-Pastrim kanalesh kulluese dhe ujitese ne Nj.A. | - | 6,229 | 6,229 |
| P7.F1.O1.A6- Mirembajtje e skemes ujitese | 7,016 | 7,016 | 6,959 |
| P7.F1.O1.A7- Zbatimi i projekteve teknike prioritare per sistemin e ujitjes ,kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni | 5,400 | 5,400 | 4,506 |
| P7.F2.O1.A1-Krijimi i kadastres bujqesore dhe arshives se saj dhe futja ne sistem e zonave te parilevuara | 900 | 900 | - |
| P7.F2.O1.A3-Mbeshtetja e regjistrimit te pronave me shpenzimet e Bashkise | 500 | 500 | - |
| P7.F3.O1.A1-Krijimi i informacionit bujqesor | | | |
| P7.F3.O1.A2-Sigurimi i mbeshtetjes se fermereve per agroindustrine, treg dhe marketing | 300 | 300 | 258 |
| P7.F3.O1.A3-Promovimi dhe krijimi i SHBB ose grupeve prodhuese e tregtuese | | | |
| P7.F3.O1.A4-Promovim produktesh bujqesore dhe blegtorale nepermjet panaireve | | | |
| P7.F4.O1.A1-Promovim dhe asistence teknike ne hartim projekte, plan biznese per perthithje te granteve. | | | |
| **TOTALI** | **32,505** | **33,388** | **24,008** |

## III Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Ka pasur vështirësi në paisjen me materiale dhe dokumentacione kadastrale nga ana e institucioneve përkatëse. Me gjithë angazhimin tonë dhe kërkesave të vazhdueshme pranë Z.V.R.P.P. Shkodër, materialet nuk janë vënë në dispozicion, në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe administrative.

- Kemi hasur vështirësi në krijimin dhe mbështetjen e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit ( O.P.U) për shkak të mungesave në akteve ligjore që mbulojnë këtë sektor.

## P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

Programi i mbrojtjes së mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet permiresimit te cilësisë dhe reduktimin e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes akustike. Ky program ka për qellim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve, ruajtjen e siperfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe afësisë ripertritëse të tyre, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Për hartimin dhe zbatimin e planeve nëpërmjet forcimit të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore që synon parandalimin e krijimit të hotspoteve të reja, ndërmarrjes së veprimeve për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithperfshires. Në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për të bashkëpunuar për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta.

Politikat e këtij programi kanë për qellim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe aftesisë ripërtritëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës. Një politikë shumë e rëndësishme e programit është shfrytëzimi racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

**I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Duke analizuar në formë analitike programin buxhetor për ‘’Mjedisin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave’’, realizimi i këtij programi referuar objektivave specifike dhe aktiviteteve/projekteve për përiudhën Janar - Dhjetor 2017, të paraqitura edhe në Matricën e Buxhetit të Vitit 2017 miratuar me VKB, paraqitet si vijon:
F1. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme të mjedisit dhe të përbërësve të tij.
F2. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.
F3. Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëntokësore etj, nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qellimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.
F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Zbatimi i masave të propozuara të VSM-ve,PPV Bashkia Shkodër, si dhe VNM-ve për projektet e propozuara.
F1.O2. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet hartimit të planit të veprimit të zhurmave
F1.O3. Promovimi i i energjisë zero në objektet publike.
F2.O1. Forcimi i pjesëmarrjes publike në takimet për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje te tij.

F2.O2.Bashkëpunimi me institucionet e arsimit parauniversitar mbi promovimin e zhvillimit e qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Shkodër.
F3.O1. Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e tjera për të pasur pranë Bashkisë kadastrën eletronike të burimeve ujore.
F3.O2. Pjesëmarrje në hartimin e planit të menaxhimit të burimeve ujore për basenin Drin-Bunë.
F3.O3. Shfrytëzimi racional dhe i kontrolluar i burimeve nëntokësore .
F4.O1. Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.
F4.O2. Realizimi i planeve dhe shërbimeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor (hartimi/rishikimi) azhornimi i Regjistrit te Pyjeve dhe Kullotave, përgatitja programit të zhvillimit të sektorit pyjor
F4.O3. Rehabilitimi, pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave nëpërmjet praktikave silvo-pastorale.Parandalimit të gërryerjes së mëtejshem të tokës pyjore dhe kullosore

**II Produktet për vitin 2017**

Gjatë përiudhës që raportohet nga ana e Drejtorisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave është punuar me përkushtim për realizimin e objektivave specifikë në funksion të realizimit të Funksioneve kryesore.

F1.O1.A1 Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij.

Bashkia Shkodër në kuadër të realizimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për të gjithë territorin, realizoi edhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor një dokument shumë i rëndësishëm që përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedist dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij. Deklarata mjedisore si dokumenti i cili miraton Vlerësimin Strategjik Mjedisor e miratuar nga Mininstri i Mjedisit përcakton edhe detajimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e dispozitave ligjore në funksion të tij.

Gjatë vitit 2017 Janë shqyrtuar 10 raporte të VNM për të cilat është dhënë opinon. 9 Raporte Vlerësimi kanë qënë për investime private dhe vetëm 1 raport për investim publik.

F1.O2.A1. Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS .

Hartëzimi i hotspoteve te zhurmave në qytetin e Shkodrës kjo bazuar në Ligjin nr 9774 datë 12.07.2007 " Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij''.

Gjatë vitit 2017 Është realizuar Harta me hotspotet e zhurmave (leje tip c) në qytetin e Shkodrës dhe NJA Velipoje Plazh. Kjo hartë përdoret në cdo rast të verifikimit mbi hotspotet e zhurmave si edhe lejet e dhëna për aktivitetet e subjekteve të cilët gjenerojnë zhurma në qytet. Harta është në formatin GIS dhe përmban të dhëna mbi koordinatat si edhe aktivitetet e subjekteve. Kjo hartë gjendet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në format pdf dhe është e aksesueshme nëpërmjet

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Mjedisi_Pyjet_dhe_Ujerat_267_1.php.

F1.O3.A1. Auditim Energjetik dhe simulim i sistemteve eficente të energjisë në objektet publike , pronë e Bashkisë Shkodër.

Në kuadër të Ligjit nr 124/2015 " Për eficensën e energjisë" si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij nisur edhe nga objektivat e Qeverisë Shqiptare për ulje të konsumit të enregjisë deri në 9% në vitin 2018, Realizuam Studimine Fizibilitetit të masave për kontrollin e konsumit të energjisë dhe përshtatja e sistemit të ndricimit publik me implementimin e eficences energjetike. Ky raport është realizuar për rrugën " Gjovalin Gjadri" . Ky material studimor është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.
http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/eficensa_e_ndricimit_publik_1332.pdf

F2.O1.A1. Realizimi i 4 takimeve për sensibilizimin e banorëve të Bashkisë Shkodër mbi cështjet mjedisore dhe mbrojtjen e tij.

Gjatë vitit 2017 janë organizuar 5 takime , 2 takime me publikun në qytetin e Shkodrës për vlerësimin e zhurmave si edhe për prodhimin e peletit ne një ambient në Zonën Industriale , si edhe 2 takime në NJA Guri i ZI. Në këto takime konkretisht për VNM përkatëse dhe prodhim nxjerrje guri në NJA Guri i Zi, si edhe për ndërtim HEC. U prezantuan aktivitetet e subjekteve ndikimet që këto veprimtari kanë në mjedis si dhe u kërkua që banorët të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit në vazhdimësi.
Në kuadër të dëgjesave publike në NJA Guri i Zi është realizuar dëgjesë publike për " Dhënie me qera sipërfaqe pyjore pronë e bashkisë" kjo në kuadër të zhvillimit ekonomik të zonës.

F2.O2.A1. Takim sensibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës" 05 Qershor - Dita botërore e mjedisi, 22 Shtator - Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër, 11 Dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve – Pyllëzimi.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar disa takime sensibilizuese me arsimin parauniversitar sipas datave të përcaktuara :
Është realizuar takim sensibilizues në Shkollën jopublike " Pjetër Mëshkalla" me nxënës të kësaj shkolle mbi cështjet mjedisore në kuadër të ditës së tokës dt 22 prill. Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit me shkollat e qytetit është realizuar ditë ndërgjegjësimi për ruajtjen e vlerave të liqenit të Shkodrës, ditë e organizuar në Shirokë.Në kuadër të ditës së pyjeve ka pasur takim në shkollat Shirokë, NJA Bërdicë, NJA Guri i ZI si edhe NJA Postrribë.

F3.O1.A1.Mbledhja e databases/ informacionit për hartimin e kadastrës ujore**.**

Gjatë vitit 2017 në kuadër edhe të PPV është realizuar baza e të dhënave në hardcopy por edhe në format dëg/ gis per të gjithe pellgun ujembledhës , pjesë e territorit të bashkisë Shkodër . Të dhënat e grumbulluara do të pasurohen me të dhënat që do të vinë nga hartimi i Planit të Menaxhimit Drin-Bunë.Qëllimi i hartimit të kësaj kadastre do të jetë që të arrihet një shfrytëzim sa racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

F3.O2.A1. Mbledhja e informacionit për përdorimin e ujrave në Bashkinë e Shkodrës në kuadër të planit të menaxhimit të Basenit Drin-Bunë.

Gjatë vitit 2017 është realizuar harta me burimet ujore, liqen lumenj etj). Kjo hartë jep kufijtë e plotë të basenit ujor të Bashkisë Shkodër kryesisht Drin-Bunë dhe shoqërohet me të dhënat mbi sipërfaqet e tyre. Ky informacion është dërguar edhe pranë MM si pjësë e informacionit për hartimin e Planit Kombëtar të menaxhimit të Baseit Drin-Bunë.
Shkodra është e rrethuar me liqen, lumenj dhe det dhe ndikimi i tyre në jetën urbane është shumë i madh, si me ndikim pozitiv ashtu edhe me ndikim negativ, përmendim këtu rastet e përmbytjeve.
U bashkëpunua me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujrave, Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Tërritorit dhe u realizua grumbullimi i informacionit elektronik dhe hard copy, e cila u përkthye në formatin GIS. Sot kemi një informacion fillestar i cili na

jep të dhëna të rëndësishme siç është pellgu ujëmbledhës Drin–Bunë, vija bregdetare që administron Bashkia Shkodër, vija lumore apo edhe sipërfaqja liqenore.

F3.O3.A1.Indentifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit te burimeve ujore nëntokësore (pus-shpimet).

Gjatë vitit 2017 është realizuar në duke shfrytëzuar edhe të dhënat e marra nga ABU, materiali në fomat exel i subjekteve të cilët janë përdorues të pus-shpimeve, i cili përmban llojin e aktivitetit. Ky material fillestar do të vazhdojë të azhornohet duke ju referuar edhe akteve të tjera ligjore në vazhdimësi.

F3.O3.A2. Indentifikimi dhe evidentimi i ndotësve ujor (familje, industri, etj.)

Gjatë vitit 2017 ka filluar krijimi i databasa në format tabele exel mbi ndotësit industrialë dhe të dhënave për sejcin subjekt se ku derdhen këto ujra , a janë të kanalizuar ose jo. Ky material është publikuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër .

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/ndotesit_individual_potencial_b_shkoder_2017dmpau_1333.pdf

F4.O1.A1.Mbrojtja e siperfaqeve pyjore/kullosore/shërbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.

Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor për këtë gjatë vitit 2017 janë realizuar Kontratat e Punës për 10 Vrojtues të cilët mbulojnë Ekonomitë Pyjore si më poshtë : 1 vrojtues NJA Shosh për EP Shosh 1,2, 2 vrojtues NJA Pult për EP Brucaj, Ugina e Kirit, 3 vrojtues për NJA Postrribë ,EP Ura Shtrenjt, Prekal, DrishtNdermolla, Lodërtunë ,Vilzë , 2 vrojtues NJA Shalë , EP Shalë1dhe Shalë2 , " Vrojtues për NJA Guri i Zi për EP Pruemos-Sheldi , Rosek-rrjoll Shllak1.

Janë ngritur njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve pranë NJA Guri i Zi, Postrribë, Pult, Shosh , Shalë.

Gjatë muajve korrik dhe gusht situata e zjarreve në zonat pyjore ka qënë problematike kështu ka patur vatra zjarri në NJA Postribë dhe Guri i Zi , ku vrojtuesit kanë qënë të parët që kanë konstatuar rastet e zjarreve dhe së bashku me stafin inxhinjero teknik kanë qënë pjesë e grupeve per fikjen e tyre.

Është realizuar objekti për Pastrimin e sipërfaqeve pyjore të gështenjës në NJA Pult , kjo në funksion të mbrojtjes së sipërfaqeve pyjore .

F4.O1.A2 Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Shkodër, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Shkodër gjatë vitit 2017 ka punoar për konsolidimin i shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave nëpërmjet formimit të struktërës për administrim dhe menaxhim të këtij fondi pyjor.

Specialistët e këtij sektori për cdo konstatim të paligjshëm në zonat pyjore/kullosore kanë njoftuar ISHMP Shkodër, kanë ndjekur Kontratat e Ankandit të Drurve për furnizimin e popullsië sipas detyrave të përcaktuara, kanë ndjekur punimet që janë kryer në sipërfaqet pyjore nga subjektet e autorizuara, Punimet ne investimet per ndertimin e Lerës së ujit , punimet në pastrimin e sipërfaqeve pyjore apo edhe ankandet e frutave te pyllit .

Shërbimi ia dministrimit të fondit pyjor kullosor nëpërmjet miradministrimit të tij dhe menaxhimit të pronave bëri që Drejtoria të realizojë të ardhurat në vlerën 8 694 732 leke kundrejt 3 340 000 lek të planifikuara.

F4.O2.A1. Rishikimi/hartimi i Planit të Menaxhimit për Shalë, Postribë, (Shosh, Pult, Gur i Zi, Rrethina, Bërdice).

Referuar orjentimit të MM lidhur me rishikimin e kufijve të EP kjo bazuar në shkresën e MM nr 8057 prot dt 19.12.2016 e në vazhdim nr 4080 dt 19.05.2017 Janë rishikuar kufijtë e ekonomive pyjore sipas udhëzimit të MM. Gjatë vitit 2017 në bashkëpunim me kadastrën e sektorit të pyjeve pranë DSHBP janë realizuar hartat e rishikuara të kufijve të ekonomivepyjore/kullosore është realizuar databaza në format exel po me të dhënat e plota për sejcilën ngastër dhe nëngastër si edheështën

plotësohet materiali hartografik në format dëg. Ky material i është dërguar edhe institucioneve përkatëse për miratim.
F4.O2.A2. Realizimi i regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave bashkiake.
Gjatë vitit 2017janërealizuar hartat për EP Rosek Drisht dhe në bashkëpunim me Sektorin e Aseteve janë derguar 318 prona për regjistrim pranë ZVRPP Shkodër ,gjithesej 6868 ha. Janë realizuar hartat e NJA Shale në bashkëpunim me SNVP , gjithesej 462 prona me nje siperfaqe 1056 ha. ( 38% e totalit). Po kështu janë duke u përgatitur edhe të gjitha hartat e tjera sipas EP të kaluara në pronësi të Bashkisë Shkodër por referuar orjentimit të MM për rishikimin e kufijve të EP kjo bazuar në shkresën e MM nr 8057 prot dt 19.12.2016 e në vazhdim nr 4080 dt 19.05.2017, jemi në pritje të konfirmimit të azhornimeve të kryera.
Sipas azhornimit të kryer rezulton që fondi pyjor/kullosr sipas VKM nr 433/2016 për bashkinë Shkodër të jetë 43806.8 ha, pas rishikimit të kryer nga ana jonë rezulton që ky fond në total të jetë 44873 ha pra rreth 1066 ha më tepër ndërkohë që numri i pasurive nga 2160 zvogëlohet në 2117 pasuri.
Këto ndryshime kanë erdhur si rezultat i saktësimit të kufijve ndërmjet bashkive , saktësimi i parcelave brenda EP të kaluara në pronësi.
F4.O3.A1. Hartim i projektit "Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve në malin e Taraboshit”.
Gjatë vitit 2017 ne bashkepunim me pronarët e gurores pasuria nr 19/213 dhe pasuria nr 19/13 është realizuar projekti i Rehabilitimit Mjedisor të Gurores e cila ndodhet përballë Urës së Re të Bunës. Rehabilitimi mjedisor i gurores ul rrezikshmërinë e rrëshqitjeve masive të dheut, shton sipërfaqet e gjelbërta duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe duke krijuar edhe një fasadë të gjelbër për zonën.
Është hartuar Projekti i Zbatimit për “ Rehabilitimin mjedisor të Gurores Tarabosh” i cili përmban punime të tilla si , hapje gropa me matrapik për mbjellje pemë kacavjerrëse ndërtim mure dekorative , vendosje rrjete peshku për instalimin e bimëve kacavjerrëse si nga poshtë edhe nga lart etj.
Ky projekt i realizuar, me shkresën nr 2694 prot datë 28.02.2017 të Bashkisë Shodër është dërguar për Aplikim pranë FZHR në kuadër të Vendimit nr 3 datë 09.02.2017 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.
Ky projekt nuk u financua nga FZHR.
F4.O3.A2. Ndërtim prita malore në Postribë, Guri i zi, (Shalë, Shosh, Pult).
Gjatë vitit 2017 për luftimin e erozionit uë ndërtohuan prita me mur guri të thatë, të cilat u ndërtuan kryesisht në përrenj. Realizimi i projektit do të bëjë ruajtjen e tokës nga erozioni dhe ka ndikim në përmirësimin e situatës mjedisore e sociale.
Realizuar Projektim /Ndertim Prita Malore në Perroi i Grykave me një volum 550m3 e cila mbron një siperfaqe pyjore mbi 250 ha.
Janë kryer projektet/ është realizuar procedura e tenderit është lidhur Kontrata e Zbatimit të Punimeve.
F4.O3.A3. Pyllëzim në sipërfaqet pyjore në Rrethina dhe Guri i Zi, (Postrribë, Bërdice, Pult Shalë, Shosh).
Gjatë vitit 2017 Janë hartuar projektet për Pyllëzim/ripyllëzim të sipërfaqeve pyjore i cili përmban punime për pyllëzimin/ripyllëzimin e zonës së përcaktuar , pyllëzim me pishë mesdhetare .Projekti parashikonte mbjelljen e rreth 500 mije fidanë.
Ky projekt i realizuar, me shkresën nr 2694 prot datë 28.02.2017 të Bashkisë Shodër është dërguar për Aplikim pranë FZHR në kuadër të Vendimit nr 3 datë 09.02.2017 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.Ky projekt nuk u financua nga FZHR. .
F4.O3.A4. Pastrimi/përmiresimi i parcelave pyjore në Rrethina, Postribë, ( Pult, Shalë, Shosh, Guri i zi, Bërdicë).
Gjatë vitit 2017 është Realizuar Projektim/Investim pastrim i parcelave pyjore ne NjA Postribe, Pult gjithesej 10 ha . Me ane të permiresimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, pasi në pyjet halore zjarri është me evident në çdo kohe,si dhe stimulohet instalimi dhe ruajtja e filizerisë së re.

F4.O3.A5. Sinjalistike pyjore në Rrethina, Pult, Shosh, (Shalë,Postribë, Guri i zi, Bërdicë).
Gjatë vitit 2017 janë realizuar materiale në funksion të shërbimit të sinjalistikës pyjore , realizuar 2 tabela informuese mbi sipërfaqet qe ka në administrim Bashkia , llojin e pyjeve/kullotave etj.
F4.O3.A6. Luftimi i semundjeve dhe dëmtuesve në pyje/kullota në Rrethina, Pult, (Shosh, Shalë,Postribë, Guri i zi, Bërdicë).

Gjatë vitit 2017 u realizua Projektim/Investim pastrim i parcelave pyjore ne , Pult /Brucaj në një sipërfaqe gjithesej 25 ha . Ndërhyrja në kohë për luftimin e sëmundjes së kancerit të gështenjës , do të sjellë përmirësimin e situatës duke rritur fuqinë vegjetative të drurit si edhe prodhimin e gështenjës.
F4.O3.A7. Zbatimi i projektit për ndërtimin e lerës së ujit kullota (Guri i Zi, Postribë, Shosh , Shalë).

Gjatë vitit 2017 u realizua projektim/ndërtim i lerës së re për grumbullim dhe mbajtje uji të pijshem për blegtorine me kapacitet 205m3 , për të cilat sigurohet uji për një numër prej rreth 163 krerë të imta dhe 15 krerë të trasha.Kjo lerë u realizua në zonën e Postribës në zonën pyjore në afërsi të fshatit Domen.

**III Fondet e financimit të programeve**

Për përmbushjen e plotë të detyrimit ligjor për Administrimin e fondit pyjor kullosor, referuar edhe pamjaftueshmërisë financiare të dhënë me transfertën specifike, Bashkia Shkodër akordoi në Buxhetin e vitit 2017 një fond shtesë në funksion të këtij shërbimi, me shumë totale 9,421 mije lekë. Fondet e miratuara për këtë program në total për vitin janë 13,002mije lekë.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017.**

Realizimi për periudhën 12 mujore është 9 421 mije lekë në masën 72 % ndaj planit vjetor 13 002 mije lekë.

1. Shpenzime për paga janë realizuar 3 376 mije lekë nga 5 300 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është 64 %.
2. Shpenzime Operative janë realizuar në masën 3 292 mije lekë nga 3 702 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është 89 %. Diferencat në fond janë si rezultat i tenderimit.
3. Shpenzime për investimet janë realizuar në masën 2 754 mije leke nga 4 000 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi i investimit është 69%. Diferencat në fond janë si rezultat i tenderimeve .

<u>**Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**</u>

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| **P8.F4.O1.A1.** Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullosore/shërbimi pyjor | 3,055 | 3,055 | 1,443.40 |
| **P8.F4.O1.A2.** Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër | 3,679 | 4,246.64 | 3,734.50 |
| **P8.F4.O3.A2**. Ndërtim prita malore në Postribe, Guri i zi,(Shale,Shosh,Pult). | 3,000 | 3,000 | 2,003 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **P8.F4.O3.A4** Pastrimi/përmirësimi i parcelave pyjore në Rrethina,Postribe,(Pult,Shale, Shosh, Guri i zi, Bërdicë). | 1,000 | 1,000 | 932.05 |
| **P8.F4.O3.A5**. Sinjalistike pyjore ne Rrethina, Pult,Shosh,(Shalë,Postribë,Guri i zi, Bërdicë,). | 200 | 200 | 178.8 |
| **P8.F4.O3.A6**. Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje/kullota në Rrethina, Pult, (Shosh, Shalë,Postribë,Guri i zi, Bërdicë). | 500 | 500 | 378.79 |
| **P8.F4.O3.A7.** Zbatimi i projektit për ndërtimin e lerës së ujit Kullota Guri i Zi, Postribë ,(Shosh, Shalë). | 1,000 | 1,000 | 750.04 |
| **Totali** | **12,434** | **13,002** | **9,421** |

**IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

- Në zbatim të pikës 66 të VKM nr 433/2016 Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe dërguar dokumentacionin për Regjistrim pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, të pasurive Pyjore/Kullosore të 318 prona,gjithsej 6868 ha në ekonominë Rosek-Drisht janë realizuar hartat e NJA Shalë në bashkëpunim me SNVP , gjithsej 462 prona me një sipërfaqe 1056 ha. (38% e totalit), por nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Shkodër nuk është bërë asnjë regjistrim.
- Drejtoria e mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave së bashku me Sektorin e Pyjeve pranë DSHBP realizuan projekte për rehabilitime mjedisore dhe pyllëzime me të cilat me shkresën nr 2694 prot datë 28.02.2017 të Bashkisë Shodër u aplikua pranë FZHR në kuadër të Vendimit nr 3 datë 09.02.2017 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve , por nuk përfituam asnjë fond për realizimin e këtyre projeteve.

## P9 Arsimi Parauniversitar dhe Parashkollor

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë.

Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësime, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore për 11 njësitë administrative. (107 shkolla, 60 kopshte, 2 konvikte, 1 shkollë Specilae), që kërkojnë një vëmendje të veçantë.

Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies dhe duke siguruar kushte për pjesëmarrje në arsimin bazë dhe të mesëm për të gjithë fëmijët në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

Arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane, tërheqia e fëmijëve romë/egjiptian.

## I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2017 ka fokusuar përpjekjet e saj në 2 funksione zhvillimi:
F1.Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.
F2.Sistemin arsimor parashkollor në kopshte.
Objektivat për secilin funksion janë:
F1.F2.O1 Ofrimi i shërbimeve cilesore për zhvillimin e procesit mesimor edukativ në kushtë të përshtatshme në gjithë tërritorin administrativ të Bashkisë Shkodër.
F1.F2.O2 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor ne sistemin parauniversitar dhe parashkollor.
F1.F2.O3 Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor, të sigurtë konform standarteve ligjore.
F1.F2.O4 Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese për fëmijë.

## II Produktet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 është punuar për përmbushjen e objektiva nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.F2.O1.A1 Pagat dhe sigurime shoqerore për punonjesit e arsimit

Me Ligjin e Buxhetin e Shtetit të vitit 2017, jane akorduar fondet për mbulimin e shpenzimeve për përsonelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit e Sportit të Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2017, te parashikuara me transfertë specifike. Numri i përsonelit gjithsej prane Drejtorise ekonomike te arsimit eshte 222 (dyqind e njezet e dy) punonjes. Me transfertë specifike, numri i punonjësve të transferuar eshtë 160 (njëqindgjashtëdhjetë), nga këto:

- Punonjës mbështëtës të arsimit para shkollore dhe 9 – vjecare 76 (shtatëdhjetëgjashtë);
- Punonjës mbështëtës të arsimit të mesëm 43 (ketërdhjetëtre);
- Punonjësve në organikë për punonjësit e Konviktëve 41 (katërdhjetenjë).

Numri i punonjësve të administratës është 37 (njezetënjë) punonjës.
Numri i punonjësve me kontrate 25 (njezetepesë) punonjës, prej të cilave:
F1.F2.O1 .A2 Arsimi Parashkollor (Paga të personelit tëarsimit parashkollor )-Dr.Kopshte
Me Ligjin e Buxhetin e Shtetit të vitit 2017, jane akorduar fondet për mbulimin e shpenzimeve për përsonelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit e Sportit të Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2017, te parashikuara me transfertë specifike. Numri i përsonelit gjithsej prane Drejtorise kopshte cerdhe eshte 172 (njeqind e shtatedhje e dy) punonjes. Me transfertë specifike, numri i punonjësve të transferuar eshtë 163 (njëqindgjashtëdhjetëe tre), me te ardhuart e bashkise 9 punonjes.

F1.F2.O1.A3 Blerje materialesh (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve.

Blerje materialesh(batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të arsimit të mesëm profesional dhe arsimit parashkollor. Dy konviktë shkolla Speciale 3 Dhjetori, 5 kopshtë me drekë në qytet. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultatë në mësime, të

jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhë aktivë në jetën komunitare. Në 3 konviktë (ai i shkollës Artistike, dhe i shkollës Industriale) janë 210 nxënës të akomoduar.

Në shkollën speciale "3 Dhjetori" jane 87 fëmijë.

Në 5 kopështët me drekë ("Bëp Tusha", "Tom Alimhilli", "I.S.Bruçaj", "Guerilie", "1 Qershori") frekuentohen nga mesatarisht 310 fëmijë.

F1.F2.O1.A4 Blerje materiale kuzhine

Dy konvikte, shkolla Speciale "3 Dhjetori". Për krijimin e kushtëve optimale për rritjen e cilësisë së shërbimeve. Në n konviktë (konvikti i shkollës Artistike, dhe konvikti i shkollës Industriale) janë 143 nxënës të akomoduar.

F1.F2.O1.A5 Blerje ushqime për konviktet e shkollave të mesme dhe kopshteve me drekë

Me fonde të akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Ministria e Mireqënies Sociale është bërë e mundur sigurimi i produktëve bazë për disa institucione sipas ligjit. Këto mallra janë pjesë e furnizimit për 2 konviktë dhe në institucione të tjera në shkolla.

Konvikti Shkollës Artistike,50 nxënës.
Konvikti i shkollës Industriale 93 nxënës.
Shkolla Speciale 3 Dhjetori 87 nxënës

Në 5 kopështët me drekë ("Bëp Tusha", "Tom Alimhilli", "I.S.Bruçaj", "Guerilie", "1 Qershori") frekuentohen nga mesatarisht 310 fëmijë.

F1.F2.O1.A6**.** Blerje materiale kancelarie për sistemin arsimorparauniversitar

Në vitin 2017 furnizmi me këto matëriale është realizuar në të gjitha shkollat e qytetit edhe të atyre në njësitë adminstrative duke ruajtur si kriter kapacitetet e shkollave me qëllim krijimin e kushteve optimale për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

F1.F2.O1.A7 Blerje materiale të ndryshme për shërbimetmbështetëse për sistemin arsimor parauniversitardhe parashkollor

Për të krijuar kushte sa me komode për vitin 2017, bazuar në kërkesat e paraqitura nga institucionet arsimore si në qytet dhe në njësitë administrative janë realizuar blerjet, brava dyer druri, reflektor gazi, dryj, tuba dhe kthesa shporeti me dru, mjete pune të ndryshme (dalta, trapone, punta, vidaplasmas, gomina xhami, doreza për dyer, rregullator gazi, tub gome gazi etj).

F1.F2.O1 .A8 Blerje pjesë këmbimi për mirëmbajtjen esistemeve hidraulike të sistemit arsimor parauniversitar dhe edukimit parashkollor.

Për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore për vitin 2017 janë vleresuar kërkesat e paraqitura nga shkollat në njësitë adminstrative dhe atyre në qytete. Një vemëndje e veçantë është për konviktët dhe për kopështët me drekë.

Nisur nga problemet e paraqitura për këtë lloj shpenzimi janë realizuar blerje për këto matëriale:

Pompa uji 2, rubinetë, tuba të ndryshëm fleksibël, sifon lavamani, kaseta shkarkimi, matëriale të ndryshme (koka dushi, valvula etj).

F1.F2.O1.A9 Blerje materiale pastrimi ambientesh

Për vitin 2017 është bërë blerja dhe shpërndarja në bazë të një grafiku të matërialeve të pastrimin për shkollat në qytetit dhe në të gjitha shkollat në Njësitë Administrative. Janë plotësuar kërkesat e domosdoshme për të krijuar një situatë sa më normale të kushtëve higjenike. Në përpilimin e shpenzimeve për këtë zë është marrë parasysh numri i fëmijëve dhe i klasave për çdo shkollë në mënyrë proporcionale.

F1.F2.O1.A10 Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit parauniversitar dhe parashkollor

Ngrohja me dru zjarri është realizuar sipas kërkesave të institucioneve të njësive administrative Pult, Shalë, Shosh, Ana e Mali, Dajç, Bërdicë, Gur i Zi, Rrethina, Postribë dhe institucioneve të qytetit Shkodër. Është e nevojshme të mundësohet ngrohje me dru zjarri, për një përiudhë 4 mujore, sipas parashikimit më poshtë:

- Në qytet 40 ambjente;
- Në njësitë administrative 257 ambjente (Ana e Malit 15 ambjente, Bërdica 31 ambjente, Dajç 30 ambjente, Guri i Zi 14 ambjente, Postriba 72 ambjente, Pulti 10 ambjente, Rrethina 66, Shalë 13, Shosh 6 ambjente.
- Kopshte 57.

Sasia e parashikuar është bërë mbi bazën e një kuote mujore që shkon mesatarisht 1 m3 në muaj për një ambjent mësimor duke diferencuar, sipas standartëve zonat me nivele të ndryshme të tempëraturave dhe është llogaritur për katër muaj në vit furnizimi.

F1.F2.O1.A11 Blerje gaz të lengshëm për ngrohje për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Me ngrohje me gaz të lëngshëm, janë furnizuar sipas kërkesave të institucioneve shkollat e njësive administrative Ana e Malit, Guri i Zi, Rrethina, Velipoje, Bërdicë dhe shumica e institucioneve të qytetit Shkodër.

Për të siguruar kushte optimale në ambjentët shkollore për vitin 2017 janë marrë kërkesat e shkollave dhe të njësive administrative për burimin e ngrohjes në institucionet e tyre.

Sasia e llogaritur është bazuar në një konsum mujor për çdo ambjent mesimor, me 15 kg (një bombul gazi) për 4 muaj në vit.

Sasia e gazit e planifikuar është për 736 ambjente mësimore të ndara:

- Shkollat në qytet 480 ambjentë mësimore (klasa, zyrat e drejtuesve, kabinetë);
- Në njësitë administrative Ana e Malit 29 ambjentë, Bërdica 28 ambjentë, Guri i Zi 68 ambjente, Rrethina 55 ambjentë, Velipoja 40 ambjentë;
- Shkolla Speciale "3 Dhejtori", 30 ambjente

Gjthashtu në përllogaritje është përfshirë edhe gazi për gatim për 5 kopështet me drekë dhe 2 konviktë për një përiudhë 9 mujore.

F1.F2.O1.A12 Blerje lendë djegëse karburante për ngrohje dhe për mjetë transporti (naftë dhe benzinë)

Ngrohje me naftë është kryer në këto institucione: Shkolla Ali Lacaj, shkolla Artistike, Konvikti i shkollës Artistike, shkolla Xheladin Fishta , kopështi Bëp Tusha

Nafta eshte konsumuar edhe nga dy automjetët, qe siguron transportin e nxënësve të shkollës Speciale 3 Dhjetori dhe automjeti që bën shpërndarjen e ushqimeve në kopshtët me drekë.

Për dy automjetët eshtë bërë grafiku i udhëtimit ditorë dhe mbi bazën e gjatësisë së rrugës së përshkruar është bërë një përllogaritje e konsumit për km.

Për institucionet e cituara me sipër është marrë në konsideratë konsumi orar mesatar i kaldajave dhe gjithashtu kohën e domosdoshme për ngrohje të institucioneve, për përiudhën 4 mujore.

Parashikimi është si më poshtë:

- Për shkollat 9 vjeçare është parashikuar një shumë vjetore 1600-2000 litra për secilën;
- Për shkollën Artistike e cila punon në orare me të zgjatura 1600 litra;
- Për konviktin e shkollës Artistike 1680 litra meqënëse ka në përdorim shumë ambjente akomodimi dhe me orar të zgjatur;
- Per shkollen Xheladin Fishta e cila ka orar te zgajtur dy turne 2000 litra
- Për kopështin B.Tusha 1680 litra duke qënë kopesht me drekë ka një aktivitët të gjatë.

F1.F2.O1.A13 Riparim paisje orendi

Për vitin 2017 është realizuar shërbim (riparim paisje orendi, karrige e tryeza nxënësish) nisur nga gjëndja e amortizuar e tyre. Kjo ndërhyrje është e nvojshme edhe për të ulur shpenzimet për blerje të paisjeve (orendi) për insitucionet ku janë paraqitur kërkesa të konsiderueshme. Konkretisht riparime: karrige nxënësish (copë 400) dhe tryeza nxënësish (copë 210).

F1.F2.O1.A14 Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për shërbimet mbështetëse të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Dy mjetët e transportit që kemi në përdorim realizojnë dy shërbime, një për lëvizjen e nxënësve të shkollës Speciale "3 Dhjetori" në mëngjez dhe në drekë dhe një mjet për shpërndarjen e ushqimeve për kopështe dhe çerdhe. Gjatë vitit 2017 është realizuar shpenzimi për mirëmbjatje dhe blerje pjesë këmbimi goma dhe batëri.

F1.F2.O1.A15 Furnizim me energji elektrike, ujë, postë

Gjatë vitit 2017 janë furnizuar me energji elektrike 45 objekte shkollore në qytet dhe 47 objekte shkollore në njësitë Administrative Shalë, Shosh, Pult. Gjatë vitit 2017 janë furnizuar me ujë 38 ambjentë shkollore në qytet por problem mbëten shkollat në njësitë administrative, si pasojë e proçesit të transferimit të Ujesjellsit Fshat. Kemi konstatuar mos faturim të ujit në disa objekte shkollore në njësitë adminstrative.

Për vitin 2017 situata e shpenzimeve për energjinë elektrike ka qënë:

- Shkodër qytet për 45 objekte shkollore;
- Njësia Administratrive Shalë për 6 objekte;
- Njësia Administrative Shosh për 3 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Pult për 8 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Postribë për 6 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Ana Malit për 4 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Dajç për 4 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Velipojë për 5 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Bërdicë 8 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Guri i Zi për 9 objekte shkollore;
- Njësia Administrative Rrethina për 10 objekte shkollore.

- Po kështu edhe për furnizimin me ujë, për Njësitë Administrative në disa objekte shkollore gjëndja është:
- Shkodër janë 38 objekte shkollore;
- Postribë në 6 objekte shkollore;
- Ana e Malit në 4 objekte shkollore;
- Dajc për 4 objekte shkollore;
- Velipoje për 5 objekte shkollore;
- Bërdicë për 5 objekte.
- 57 kopshte.

F1.F2.O1.A16 Transporti i nxënësve dhe mësuesve

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaximin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të ligjit nr. 147/2015 " Për buxhetin e vitit 2016 si dhe të Vendimit nr.682, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit" i ndryshuar, me Vendimin nr. 1102, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtësa në Vendimin nr.682, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", është përcaktuar fondi për Bashkinë Shkodër. Ne baze te Vendimit nr.398 date 03.05.2017 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.682/2015 të Këshillit të Ministratve "Për perdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", njesive te qeverisjes vendore nuk kane te drejte te vazhdojne te mbulojne shpenzimet e transporit mbas dates 01.07.2017, per ato linja qe nuk kane lidhur konrata, ndersa per linjat me kontrata do te m,bulojne shpenzimet deri me 31.12.2017. me 1 janar keto shpenzime do te mbulohen nga Drejtorite Arsimire Rajonale.

Mbas shkëmbimit të informacionit me DAR Shkodër mbi numrin e mesuesve dhe nxënësve është bërë edhe përcaktimit i nevojave sipas linjave (që paracakton ligji) dhe numrit të mësuesve dhe nxënësve përfitues. Numri përfitues nga ky shërbim është 947 nxënës dhe 476 mësues.

Fondet për shpenzime" Transport i nxënësve dhe mësuesve" jane planifikuar gjithsej 19,267mijë lekë në vitin 2017. Për përiudhën 12-mujore realizimi është në masën 14 533 mijëlekë ose në masën 76%, realizim qe ka lidhje me rikthimin e ketij funksioni prane Drejtorive Rajonale arsimore.

F1.F2.O2.A1 "Blerje xhami për mirëmbajtjen e dritareve për të gjitha objektet e arsimit parauniversitar dhe parashkollor"

Për vitin 2017 nuk është bërë furnizimi me xham të zakonshëm kryesisht për shkollat e qytetit dhe për njësitë administrative sipas kërkesave të konsiderueshme të paraqitura prej tyre. Sasia e parashikuar ka të përfshirë jo vetëm kërkesat e paraqitura por edhe një sasi rezerve me qellim përmbushjen e nevojave të lindura gjatë vitit. Sasia totale e xhamit të blere është 500 m².

F1.F2.O2.A2 Blerje bojrash të ndryshme për lyerjen e mjediseve të godinave të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Për vitin 2017 kërkesat e paraqitura për krijimin e ambjenteve sa më komode nga shkollat e njësive adminstrative dhe ato të qytetit janë në rritje.

F1.F2.O2.A3 Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjeteve elektrike për godinat e sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Për vitin 2017 bërë furnizimi me materiale elektrike për shkollat e qytetit kryesisht me llampa ekonomike, llampa të zakonshme, priza, çelësa, portollamapa e të tjera të kësaj natyre. Për të krijuar kushtë sa më optimale për vitin 2016 nisur nga kërkesat e paraqitura nga shkollat si në qytet dhe nga ato të njësive adminstrative si dhe krijimi i një sasisë të vogël rezervë është parashikuar të blihen materiale elektrike si më poshtë:

F1.F2.O2.A4 "Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore"

Gjatë viti 2017 u kryen punime mirëmbatje në objekte shkollore si:

- 28 nentori 669 nxënës;
- At Gjon Karma 404 nxënës;
- Boks-Rrjoll 39 nxënës;
- Dragoc me 203 nxënës;
- Gjergj Laca me 27 nxënës.
- Gjergj Vat Martini 170 nxënës;

- Hasan Dardhanjori 55 nxënës;
- Kol Idromeno 428 nxënës;
- Mehmet Shpendi 56 nxënës;
- Qazim Mehja 111 nxënës;
- Koinvikti i Shkolles Industriale 92 nxënës;
- Salo Halili 367 nxënës
- Sait Tagani 323 nxënës
- Ernes Koliqi 69 nxënës
- Shtoj i Vjeter 137 nxënës
- Skenderbeg 586 nxënës
- Veli Tela 82 nxënës
- Zogaj 83 nxënës
- Azem Hajdari 428 nxënës

**Në Njësinë Administrative POSTRIBË**

- Ne shkollen Dragoc, ku u riparuan tualetët, shtresat e suvatimeve në ambjentët e brëndshme.

**Në njësinë Administrative DAJÇ**

- Në shkollën Gjergj Laca, u rikonstrukua tualetet të brëndshme të godinës

**Në Njësinë Administrative GURI Zi**

- ShkollaAt Gjon Karma është kryer lyerja e pjesshme, dhe jane shtuar 3 bokse tualete duke vleresuar numerin e nexenesve qe kjo shkolle ka ne reaport me standardeve te MAS.

**Në Njësinë Administraive ANA MALIT**

- Shkolla Hasan Dardhanjori ku u riparuan tualetët
- Shkolla Qazim mehja ku u riparuan tualetët
-

**Në njësinë Administrative BËRDICE**

- Shkolla Sait Tagani, riparim te terraces

**Në njësinë Administrative RRETHINA**

- Shkolla Shtoj i Vjeter, u riparu catia, tualetet

F1.F2.O2.A5 “Blerje paisje orendi për mobilimin e klasave për sistemin arsimor parauniversitar”.

Në vitin 2017 është realizuar blerje për paisje orendi për shkollat. Për vitin 2017 kërkesat për paisje shkollore si karrige nxënësi dhe tryeza nxënësi, janë shumë të mëdha veçanërsiht nga shkollat e njësive administrative.

Me perfundimin e procesit te inventarizimit eshte duke u ripare mundesia e rishperndarjes se pajisjeve mes shkollave.

F1.F2.O2.A6 “Blerje paisje ngrohese, kompiuterike për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor”

Për vitin 2017 janë paraqitur nevojat e njësive administrative Rrethina, Guri i Zi, Dajc, Shosh, Bërdicë, Ana e Malit për blerje të paisjeve ngrohëse. Gjithashtu kërkesa si nga nga konviktet dhe kopështet për blerje paisje frogoriferike dhe larëse.

Në përmbushje të kërkesave të domosdoshme që janë paraqitur blerjet për paisje janë parashikuar:

Stufa për grohje me dru zjarri për të plotësuar kërkesat me të domosdoshme të institucioneve arsimore në qytet dhe Njsite Administrative.

F1.F2.O3.A2 "Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonëshme si zjarr dhe termete"

Gjatë vitit 2017 është bërë sigurimi i 20 objktëve, ku janë përfshirë konviktët, kopështët me drekë dhe shkollat që janë me numër më të madh nxënësish. Sigurimi i objekteve është bërë për raste të ngjarjeve të jashtëzakonëshme si zjarr dhe tërmete,.

Konviktë, Industriale, Artistike, Pedagogjike.

Shkolla, "3 Dhjetori", "Ndërtimi", "Teknollogjike", "28 Nëntori". "Jordan Misja", "Oso Kuka", "Ismail Qemali", "Ndre Mjeda", "Shkolla Branko Kadia", "Shkolla Azem Hajdari", "Shkolla Skenderbëj", "Shkolla Ali Lacej", "Shkolla Xheladin Fishta", "Qëndra Kulturore e fëmijëve"

Kopështë, " I.S.Brucaj","Bëp Tusha", "Ton Alimhilli"

F1.F2.O3.A3 "Dizinfektimi i mjediseve të objekteve të shërbimeve mbështetëse"

Gjatë vitit 2017 është kryer shërbimi i dizinfektimit, për ambjentë kuzhina. mensa dhe magazina për kopështët me drekë dhe konviktët, nisur kjo nga kërkesa e vazhdueshme të bëra si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga institucionet e kontrollit shëndetësor.

Kanë përfituar nga ky proçes:

- Kopështe me drekë (ambjentet e kuzhinave, magazinat ushqimore, dhomat e ndenjës dhe fjetjes së fëmijëve si dhe anekset sanitare). Kjo për 5 kopështët me drekë. (Bep Tusha, Ton Alimhilli. I.S.Bruçaj. Guerilie, 1 Qershori);
- Konviktet (Artistike, dhe i shkollës ''Industriale'') kuzhina, mensa, magazine ushqimore, dhomat e fjetjes në përdorim, sallat që përdoren për aktivite të nxënësve konviktor dhe anekset sanitare;
- Shkolla special " 3 Dhjetori " kuzhina, mensa,magazine ushqimore dhe anekset sanitare.

F1.F2.O4.A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë

Identifikimi i talentëve të reja në fushën e intërpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktivitëtëve kulturore artistike. Rritja e cilësisë së jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështëtjes së brezit të ri. Bilbilave të vegjël i shtohën çdo vit dhjetëra zëra të rinj, prandaj nevojë të veçantë ka për përkushtimin, pasjonin dhe investimin e përditshëm deri në detajet e vogla. Edicioni i 22-të këtë vit u zhvillua në katër faza ku marrën pjesë rreth 2500 fëmijë nga të gjitha shkollat që Bashkia Shkodër administron. Shkollat paraqitë fëmijët me talent pa kufizim në numër, të cilët ju nënshtruan punës pregatitore dhe fazave seleksionuese nën udhëheqjen e specialistëve. Matëriali muzikor për të gjithë konkurentët u përcaktua nga organizatorët, në përshtatje me moshën dhe karaktëristikat vokale.

Në fazën finale konkurojnë më të talentuarit e përzgjedhur nga fazat seleksionuese dhe, nga këta, shpallen këngëtarët fitues. E kënduara direkt (Live) përmirësohet vazhdimisht përmes një punë të kualifikuar dhe sigurimit të një zërimi sa më cilësor.

F1.F2.O4.A2 Festivali i 55-t mbarëkombëtar për fëmijë

Skena e këtij festivali shërbeu për promovimin e mëtejshëm të fëmijëve në fushën e veprimtarive për kompozitorë, skenaristë, autorë tekstësh, regjisorë, koreografë, skenografë, dirigjentë, instrumentues, orkestrues, mjeshtra vokali, etj.

Festivali Mbarëkombëtar i këngës për fëmijë i 55-ti, u realizua në fillim të muajit qershor 2016, në ambient të hapur, në sheshin para Bashkisë së qytetit. Festivali mbahet si festë e këngës shqiptare dhe mundëson ndjekjen nga një shumicë artdashësish të qytetit të Shkodrës, trevave të tjera shqiptare dhe të shqipfolësve nëpërmjet transmetimit satelitor dhe faqeve të Web-sitit. Edicioni i 55-te, promovoi 26 këngë të reja, intërpretimet më të mira të krijimeve më të zgjedhura të kompozitorëve, poetëve, aranzhuesve dhe këngëtarëve të këtij viti në realitetin shqiptar të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Diasporës.

Realizimi i këtij Festivali, i vetmi i këtij lloji në realitetin shqipfolës, synon të ruajë dhe të çojë përpara traditën e gjatë dhe të suksesshme të këtij zhanri; Stimulimin e talenteve të fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së zerimit në të kënduarën direkt (Live).

F1.F2.O4.A3 “Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) të Qendres Kulturore të Fëmijëve”

Qëndra Kulturore e Fëmijëve organizon sipas kalendarit të përcaktuar veprimtari masive sportive, artistike e shkencore, mbi bazën e platformave që ndërton dhe ua shpërndan shkollave 9 vjeçare. Këto veprimtari gjallërojnë dukshëm sheshet, fushat sportive, palestrat dhe sallat që qyteti ynë disponon. Përmendim këtu:

Në gjashtë mujorin e parë Janar - Qershor:

- Kampionati i shahut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)
- Morën pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem (CU)
    - 2 vajza dhe 2 djem nga kl 5-6
    - 2 vajza dhe 2 djem nga klasa 7-8-9
- Kampionati i pimpongut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)
- Garë me biçikleta ndërmjet kopshtëve të qytetit.
  Morën pjesë nga çdo kopësht 2 vajza dhe 2 djem.
- Gara zhvillohet e ndarë, në pedonalen tek ura e Bunës. Ky aktivitët hyn tek aktivitetet e traditës (rreth 30 vjet që zhvillohet) dhe rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët por edhe nga prindërit. Kjo ditë kthehet në një festë për këtë brez fëmijësh.

Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar në fushat respektive, angazhohen edhe mësuesit edukimit fizik, të letërsisë, trainere, gjygjtarë, regjizorë, aktorë, moderatorë dhe shkrimtarë nga më të njohurit që qyteti ynë ka.

Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyrë të cilët stimulohen.

Morën pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga 5-6 si dhe 2 vajza dhe 2 nga klasa 7-8-9.

Kampionatet pranverore në Basketboll, Volejboll dhe Minifutboll të femrave dhe meshkujve nërmjet shkollave 9 vjeçare (rreth 20 shkolla). Kjo veprimtari u realizua në tri faza, mbi bazën e shortit të hedhur në fillim duke vazhduar më pas me sistemin e eliminimit.

Ky aktivitet u zhvillua në disa terrene dhe palestra të qytetit tonë dhe zgjati rreth një muaj e gjysëm. Në fund u shpall ekipi fitues për secilin sport.

**Zbavitemi me gjuhet e huaja**

Marrin pjesë anëtarë të rretheve të gjuhëve të huaja të QKF (150 fëmijë) si dhe nxënës të dalluar në këtë fushë nga shkollat 9 vjeçare. Kjo veprimtari u organizua në sallën e QKF-së ku nxënësit shpalosën arritjet e tyre përmes këngës, recitimit, inskenimit dhe humorit në gjuhë të huaja.

Në gjashtë mujorin e dytë Shtator-Dhjetor:

- Kampionati i vrapimit në natyrë në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 30 shkolla)
  Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga CU-3 vajza dhe 3 djem nga CU.
- Konkursi i fjalës artistike në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 27 shkolla)
- Konkursi zhvillohet në tre faza sipas kalendarit të përcaktuar.
  Faza e parë, në shkolla, pa kufizim numrin i konkurentëve, ndiqet nga specialistët e QKF-së.
  Faza e dytë në sallën e QKF në 10 ditë dhe në të marrin pjesë nga çdo shkollë: 3 recitues nga CU- 2
  recitues nga CL dhe Një nxënës ose një grup në fushën e humorit.

Nga kjo fazë Juria përzgjedh finalistët të cilët konkurojnë në Finale për të shpallur 8 fituesit: Vendi i parë, dytë, tretë dhe inkurajues për CU dhe për CL.

- Garë me biçikleta në mes kopshtëve të qytetit
  Marrin pjesë nga çdo kopësht 2 vajza dhe 2 djem.
- Gara zhvillohet e ndarë, në pedonalen tek ura e Bunës. Ky aktivitët hyn tek aktivitetet e traditës (rreth 30 vjet që zhvillohet) dhe rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët por edhe nga prindërit. Kjo ditë kthehet në një festë për këtë brez fëmijësh.

Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar në fushat respektive, angazhohen edhe mësuesit edukimit fizik, të letërsisë, trainere, gjygjtarë, regjizorë, aktorë, moderatorë dhe shkrimtarë nga më të njohurit që qyteti ynë ka.

Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyrë të cilët stimulohen.

Këto veprimtari ndiqen me shumë interes nga drejtuesit dhe tekniket e klubit shumësportësh “Vllaznia” si mënyrë për të afruar në ekipet e këtij klubi më të talentuarit.

F1.F2.O4.A4 Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore për vitin 2017

Qëndra Kulturore e Fëmijëve, gjatë vitit mësimor ushtron veprimtari me rrethet artistike, sportive e tekniko-shkencore mbi bazën e programeve të miratuara nga MASH. Për çdo vit marrin pjesë rreth 500 fëmijë si dhe një grup specialistësh nga fusha e artit, sportit dhe shkencës nga më të mirët e qytetit tonë.

Nga kjo veprimtari e suksesshme ndër vitë kanë dalë figura të spikatura të artit dhe sportit, duke shkëlqyer në skenat dhe fushat sportive kombëtare e më gjërë. Gjithashtu nga kjo veprimtari argëtohen, aftësohen dhe stërvitën çdo vit një grup i madh fëmijësh të talentuar në fushat respektive. Pranë QKF-së për këtë vit kalendarik funksionuan disa kurse për pregatitjen e talentëve të reja në art, sport dhe shkencë, traditë kjo 70 vjeçare.

F1.F2.O4.A5 “Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare”

Mbrëmja tradicionale e vitit të ri ka një traditë më shumë se 60 vjeçare, realizuar pa ndërprerje çdo vit nga QKF (ish Shtëpia e Pionierit) në fund të muajit dhjetor, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër. Ky aktivitet stimulon nxënësit e talentuar pa dallime, që zgjidhen nga shkollat, DAR-i dhe stafi i QKF. Kjo mbrëmje shërbën si premierë e talentëve të humorit, këngës, baletit dhe aerobisë së QKF dhe si stimulim i nxënësve më të mirë të qytetit, (stimulohen rreth 70 nxënës të dalluar të ciklit të ulët të shkollave 9 vjeçare dhe 130 artistë dhe sportistë të vegjël). Materiali artistik i kësaj

veprimtarie është rreth 75% krejt i ri. Gjithashtu kjo mbrëmje stimulon bashkëpunimin me artistë të afirmuar, të cilët ftohen si mysafirë nderi. Kjo gjë rrit interesin dhe pëlqyeshërinë duke e bërë këtë aktivitët shumë argëtues. Nëpërmjet këtij aktiviteti gjallërohet jeta kulturore dhe artistike e brezit të fëmijëve.

**Nga Drejtoria gjithashtu është realizuar:**

- **Shpërndarja e bursave për nxënës dhe student.** Me Vendim të Këshillit të Ministrave, numër 783.datë 14.12.2016, Vendimit 903 date 21.12.2016 ''Për bursat për nxënës dhe student'' me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale. Për vitin 2016 përfituan bursë me vendim të Këshillit Bashkiak nr.4 dhe 40 datë 30.01.2017.

- **Projekti "Shkollat si qëndra komunitare"**. Bashkia Shkodër, në bazë të standardeve dhe udhëzimit të miratuar nga MAS për realizimin e projekteve në shkolla, me mbështetjen e donatorëve dhe financimin nga vetë Bashkia ka hartuar politikat për shkollat të cilat janë dhe do të jenë qendra komunitare. Nëpërmjet këtij projekti promovohet dhe nxitet hapja e strukturave të edukimit jashtë orarit të mesimit, për gjithë fëmijët e komunitetit.

- **Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara**. Bashkia Shkodër, mbështët këtë kategori nxënësish duke ju ofruar shërbimet mbështetëse në shkollën Speciale ''3 Dhjetori''. Gjithashtu Bashkia mbështet dhe aktivitet kulturore dhe sociale të nxënësve të kësaj shkolle.

- Detajimi, ndjekja e zbatimi i buxhetit, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8 datë 30.1.2017";
- Detajimi i Buxhetit për të gjitha zerat e shpenzimeve;
- Detajimi i shpenzimeve mujore për të gjitha zërat;
- Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2017;
- Përgatitja e raportit vjetor të monitorimi të Drejtorise Ejkonomike të Arsimit për vitin 2016;
- Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2016;
- Hartimi i projektbuxhetit për vitin 2017, si dhe përiudhën afatmesme 2018-2020;
- Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për pagesat e e shpezimeve sipas programeve për çdo muaj;
- Raportimi për evidecen e shpenzimirve dhe tabëlat për realizimini e ketyre shpenzimeve pranë Drejtorisë Analizes dhe Programimit Buxhetor për çdo muaj;
- Analiza të pagave të punonjësve si dhe shpenzimet për përsonelin mbështëtës në Arsim, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, investimet kapitale etj;
- Pjesëmarrje në grupe pune për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për proçedura prokurimi të parashikuara për vitin 2017;
- Hartimi i projekt vendimeve.

## III Fondet e financimit të programeve

Me VKB nr 8, datë 30.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër"Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 11166, datë 24.12.2015, plani fillestar i programit P9 ka qene 357,231 mije leke.

Me shkresen e Ministrise se Financave nr. 5862 date 24.4.2017 " Dergohet fondi i rritjes se pagave per funksionet e transferuara" për Arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve dhe për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në

arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve)per arsimin parashkollor dhe 9 vjecar u akordua fondi shtese prej 13,371 mije leke. VKB nr 35, date 30.05.2017.
Gjate vitit jane bere rishoperndarje fondesh si me poshte:
Me vendimin e kryetarit nr 365, date 09.10.2017.
Me vendimin e kryetarit nr 411, date 30.10.2017.
Me VKB nr 64, date 30.10.2017.

**Realizimi i fondeve për përiudhën 12-mujore 2017**

Fondet e miratuara për këtë program (P9), janë 357 231 mijë**.** Plani i korigjuar është 377 764 mijë. Realizimi për përiudhën 12-mujore është 333 184 mijë lekë në këtë program në masën 88% ndaj planit vjetor.
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente 90 %. Plan i korigjuar 343,539 mije leke dhe realizim 311,891 mije leke.
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale 62 %. Plan i korigjuar 34,225 mije leke dhe realizim 21,293 mije leke.

**Tabëla e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| P9.F1.F2.O1.A1 Pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e arsimit. | 105,060 | 111,691 | 101,859 |
| P9.F1.F2.O1.A2 Arsimi Parashkollor (Paga të personelit të kopështeve dhe blerje ushqime për kopshtet me drekë). | 117,194 | 119,933 | 113,008 |
| P9.F1.F2.O1.A3 Blerje materialesh (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve. | 100 | 100 | - |
| P9.F1.F2.O1.A4 Blerje materiale shërbime mbështetëse kuzhine. | 80 | 80 | 77 |
| P9.F1.F2.O1.A5 Blerje ushqime për arsimin parashkollor | 12,096 | 12,096 | 12,061 |
| P9.F1.F2.O1.A6 Blerje ushqime për konviktet e shkollave të mesme. | 14,973 | 15,144 | 9,052 |
| P9.F1.F2.O1.A7 Blerje materiale kancelarie për sistemin arsimor parauniversitar. | 1,100 | 1,100 | 859 |
| P9.F1.F2.O1.A8 Blerje kancelarie dhe materiale pastrimi për sistemin arsimor parashkollor | 950 | 950 | 941 |
| P9.F1.F2.O1.A9 Blerje materiale te ndryshme per sherbimet mbeshtetese per sistemin parauniversitar | 610 | 610 | 444 |
| P9.F1.F2.O1.A10 Blerje pjesë kembimi për mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike të sistemit arsimor parauniversitar dhe edukimit parashkollor. | 270 | 270 | 226 |
| P9.F1.F2.O1.A11 Blerje materiale pastrimi ambientesh. | 1,880 | 1,880 | 1,829 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P9.F1.F2.O1.A12 Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit parauniversitar. | 13,400 | 13,400 | 13,368 |
| P9.F1.F2.O1.A13 Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit parashkollor | 1,850 | 1,850 | 1,834 |
| P9.F1.F2.O1.A14 Blerje gaz të lengshem për ngrohje për sistemin arsimor parashkollor dhe sistemin arsimor parauniversitar. | 5,900 | 5,900 | 5,899 |
| P9.F1.F2.O1.A15 Blerje lënde djegëse karburantë për ngrohje dhe për mjete transporti (naftë dhe bënzinë). | 2,090 | 2,090 | 2,090 |
| P9.F1.F2.O1.A16 Riparim paisje orendi. | 390 | 390 | 73 |
| P9.F1.F2.O1.A17 Blerje paisje orendi per arsimin parashkollor | 150 | 150 | 131 |
| P9.F1.F2.O1.A18 Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për shërbimet mbështetëse të sistemit arsimor parauniversitar dhe sistemit arsimor parashkollor. | 350 | 350 | 24 |
| P9.F1.F2.O1.A19 Furnizim me energji elektrike, ujë dhe telefon për të gjitha shkollat në territorin e Bashkisë. | 15,046 | 19,046 | 19,036 |
| P9.F1.F2.O1.A120 Furnizim me energji elektrike, ujë per arsimin parashkollor | 1,900 | 1,900 | 1,684 |
| P9.F1.F2.O1.A21 Transport i arsimtarëve dhe nxënësve i sistemit arsimor parashkollor dhe i mesëm. | 22,342 | 19,267 | 14,533 |
| P9.F1.F2.O2.A1 Blerje xhami për mirëmbajtjen e dritareve për të gjitha objektet e arsimit parauniversitar dhe parashkollor. | 290 | 0 | 0 |
| P9.F1.F2.O2.A2 Blerje bojërash të ndryshme për lyerjen e mjediseve të godinave të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor. | 290 | 580 | 189 |
| P9.F1.F2.O2.A3 Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjeteve elektrike për godinat e sistemit arsimor parauniversitar. | 450 | 450 | 311 |
| P9.F1.F2.O2.A4 Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore. | 7,150 | 5,654 | 4,086 |
| P9.F1.F2.O2.A5 Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve te arsimit parashkollor. | 950 | 950 | 934 |
| P9.F1.F2.O2.A6 Blerje paisje orendi për mobilimin e klasave për sistemin arsimor parauniversitar. | 1,000 | 1,000 | 869 |
| P9.F1.F2.O2.A7 Blerje paisje ngrohëse, kompiuterike për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor. | 770 | 1,070 | 1,063 |
| P9.F1.F2.O2.A8 Ndertim Fushe Sportive e mbuluar dhe rrjeti KUB shkolla e mesme 28 Nentori , Shkoder | 11,908 | 11,908 | 9,336 |
| P9.F1.F2.O2.A8 Rikonstruksion i plote i objektit arsimor ''Oso Kuka''. | | 6,562 | 177 |
| P9.F1.F2.O2.A9 Rikonstruksion i terraces tualeteve dhe dyerve shkolla DED Gjo Luli, Njesia Administrative Rrethina | 1,882 | 1,882 | 954 |
| P9.F1.F2.O2.A10 Rikonstruksion i tualeteve shkolla e mesme e bashkuar Adem Haxhija, Njesia Administrative Postribe | 2,090 | 2,090 | 1,100 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P9.F1.F2.O2.A11 Rikonstruksion i tualeteve dhe Rrjeti KUB shkolla e mesme Nikolla Zagoriani, Njesia Administrative Velipoje | 1,567 | 1,567 | 1,100 |
| P9.F1.F2.O2.A12 Rikonstruksion i terraces shkolla e fshatit Juban, Njesia Administrative Gur i Zi | 1,566 | 1,566 | 1,184 |
| P9.F1.F2.O2.A13 Rikonstruksion i terraces shkolla Deshmoreet e Rrencit, Njesia Administrative Gur i Zi | 1,880 | 1,580 | 1,073 |
| P9.F1.F2.O2.A17 Rikonstruksion i pjesshem i shkolles 9-vjecare Ura e Shtrenjte | - | 5,000 | 4,436 |
| P9.F1.F2.O3.A1 Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakoneshme si zjarre dhe tërmete. | 720 | 720 | 715 |
| P9.F1.F2.O3.A2 Sigurimi i objekteve te kopshteve | 80 | 80 | 80 |
| P9.F1.F2.O3.A3 Dizinfektimi i mjediseve të objekteve të shërbimeve mbështetëse. | 250 | 250 | 24 |
| P9.F1.F2.O3.A4 Dizinfektimi i mjediseve të objekteve ne arsimin parashkollor. | 50 | 50 | 50 |
| P9.F1.F2.O4.A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë | 410 | 410 | 410 |
| P9.F1.F2.O4.A2 Festivali i 54-t mbarëkombëtar për fëmije | 4,500 | 4,500 | 4,375 |
| P9.F1.F2.O4.A3 "Veprimtari masive" (sportive, artistike e shkencore) të Qëndrës Kulturore të Fëmijëve. | 280 | 280 | 280 |
| P9.F1.F2.O4.A4 Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore per vitin 2016. | 972 | 972 | 966 |
| P9.F1.F2.O4.A5 Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare. | 445 | 445 | 445 |
| **TOTALI** | **357,231** | **377,764** | **333,184** |

### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Blerje materiale shërbime mbështetëse kuzhine, meqense gjatë vitit 2017, ka patur kërkesa nga Konviktet , Shkolla Speciale dhe Kopshtet për enë kuzhine, nuk e kemi realizuar si shpenzim.
- Pajisja dhe instalimi i kaldajës në shkollën "Xheladin Fishta". Meqense gjate muajit dhjetor 2016 kemi realizuar projetin Hidro-termik te kaldajes, ne baze te ligjit per procedurat e prokurimit publik, u arrit te realizohet brenda vitit 2017
- Rikonstruksion i plotë i objektit arsimor "Oso Kuka". Në këtë objekt është parashikuar rikonstruksioni i plotë i rrjetit elektrik të brendshëm dhe të jashtëm, paisja e shkollës me rrjet LAN, sistem kamerash të brëndshme dhe rrjeti i ngrohjës i cili mungonte terësisht më parë. Si rrjedhojë e proceduarve të projektimit të projektit elektirk, është zgjatur dhe procesi I prokurimit të zbatimit të objektit. Objekti është prokuruar në vitin 2016 dhe u zbatua në vitin 2017.
- Rikonstruksion i pjesshëm shkolla ''Tringe Smajla'' Fshati Grudë e Re, Njësia Administrative Rrethina. Objekt në të cilin kanë filluar punimet. Këto punime përfshijnë rikonstruksionin e

plotë të terracës, zëvëndësimi i shtresave të pllakave të dyshemeve, riparimi i tualetëve, si dhe paisja e shkollës me një rrjet elektrik, sistëmi i brendshëm i kamerave dhe rrjeti LAN sipas kushtëve të MAS. Objekti ka pëfunduar në vitin 2017.

**P10 Strehimi dhe Shërbimet Sociale**

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.
***Vizioni i kësaj drejtorie është "Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë".***
Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

1. Sektori i Përfshirjes Sociale, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.
2. Sektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale, dhe Shëndetin Publik.

Shërbimet me bazë komunitare të krijuara gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. 7 qendra komunitare "Për Familjen" u krijuan dhe u vunë në funksion, nga një në çdo lagje të Shkodrës dhe 2 në njësinë administrative të Gurit të Zi dhe të Dajçit. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.
Në vitin 2017, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, është arritur sigurimi i financimit për krijimin e Qendrës së parë Rinore Publike në territorin e bashkisë së Shkodrës. Kjo qendër i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj.
Gjithashtu, gjatë vitit 2017 është projektuar dhe ka filluar zbatimi për ndërtimin e qendrës komunitare multifunksionale, e cila do të ofrojë shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian, por sigurisht do të jetë një qendër e gatshme dhe në shërbim të komunitetit të zonës.
Ndër shërbimet e rëndësishme, që vlen të theksohet, për vitin 2017, është koordinimi i ndërhyrjeve dhe burimeve në territor ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, për regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve rom në sistemin arsimor. Për herë të parë gjatë këtij viti, rreth 60 fëmijë rom janë regjistruar dhe kanë frekuentuar shkollën. Për secilin fëmijë dhe familje tyre janë siguruar mbështetje shumë planëshe, me synim fuqizimin dhe integrimin e tyre. Ndër shërbimet e ofruara janë; regjistrim në gjendjen civile, orientim për punësim dhe kurse profesionale, pajisje me karta shëndeti, sigurimi i materialeve didaktike të nevojshme për proçesin mësimor, ndihma veshmbathje, ushqimore dhe mjekësore.
Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

## I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", ligjit 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe aktet nënligjore përkatëse, veprimtaria e Drejtorisë është bazuar në katër funksione kryesore të ndara sipas objektivave specifike:

F1. Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, për përsonant me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit, etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F3. Ndërtimi dhe administrimi i qëndrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

F4. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.

F1.O1. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshë, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

F2.O1. Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat e komunitetit.

F2.O2. Bashkërendimi dhe harmonizimi I aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe Politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.

F2.O3. Partneritet i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

F2.O4. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.

F2.O5. Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

F3.O1. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.

F3.O2. Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.

F4.O1. Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.

## II Produktet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër.

F1.O1.A1. Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e çezmave publike
Punimet e për sigurimin e ujit të pijshëm, të kanalizimeve dhe administrimi i ujërave të zeza për familjet e komunitetit Rom&Egjiptian përtej urës është përfunduar.
Janë kryer punimet për ndërtimin e rrjetit të KUZ dhe të administrimit të tyre. Pusi për ujin e pijshëm është ndërtuar dhe është vënë në funksion, gjithashtu edhe rrjeti i shpërndajes së ujit të pijshëm dhe ndërtimi i çesmave publike pranë komunitetit në zonën përtej urës së Bunës është realizuar.

F1.O1.A2. Administrimi i apartamenteve sociale dhe ngritja e qendrës komunitare në mbështetje të jetimëve dhe nënave kryefamiljare në vështirësi ekonomike.

26 apartamente sociale të gatshme për jetimët dhe gratë kryefamiljare. Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”. Ky komision do të administrojë proçesin e përzgjedhjes dhe të adminstrimit të apartamenteve sociale për jetimët dhe gratë kryefamiljare. Gjatë vitit 2017 është krijuar komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Për administrimin e programeve të strehimit social pritet miratimi nga Këshilli Bashkiak.
F1.O2.A1. Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.
Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”. Ky komision do të administrojë proçesin e përzgjedhjes dhe të adminstrimit të apartamenteve sociale për jetimët dhe gratë kryefamiljare. Gjatë vitit 2017 është krijuar komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Për administrimin e programeve të strehimit social pritet miratimi nga Këshilli Bashkiak.
F1.O2.A2. Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës
Është realizuar vlerësimi mbi infrastrukturën e banimit dhe gjithashtu kostimi i ndërhyrjeve me synim përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian. Është realizuar shkrimi i draftit final mbi studimin vlerësues të kushteve të banimit të komunitetit rom e egjiptian, dhe kostifikimit të nevojave për ndërhyrje, në bashkinë e Shkodrës.
F2.O1.A1 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.
Shtrirja e shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Skuadra të terrenit, të përbëra nga punonjës të qendrave komunitare “Për Familjen” dhe policë Bashkiakë, funksionale në zonat kryesore ku janë identifikuar fëmijë në situatë rruge; në zonën urbane të Bashkisë së Shkodrës, në pikën kufitare Muriqan dhe në plazhin e Velipojës në njësinë Administrative Velipojë. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge është 100.
F2.O2.A1. Ndihma ekonomike dhe PAK.
Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë; në muajin janar 3905 familje, në shkurt, 3883, në mars 3865, në prill 3797, në maj 3744, në muajin qeshor kanë qenë 3655 familje në muajin korrik 3564 familje, në muajin gusht kanë qenë 3520, muaji shtator 3462 familje, muaji tetor 3427 familje, muaji nëntor 3428 familje dhe muaji dhjetor 3435 familje përfituese të ndihmës ekonomike.

Nr. I personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë në muajin janar 4044, në shkurt, 4097, në mars 4142, në prill 4162, në maj 4159, në muajin qeshor kanë qenë 4155, në muajin korrik kanë qenë 4114, në muajin gusht kanë qenë 4128 përfitues, në muajin shtator 4129 persona, muajin tetor 4141 persona, muajin nëntor 4195 persona dhe muajin dhjetor 4212 persona. Nr. I invalidëve të punës trajtuar me shtesë kempi ka qenë në muajin janar 3300, në shkurt, 3248, në mars 3228, në prill 3263, në maj 3303, në muajin qeshor kanë qenë 3325, në mujain korrik 3310, në muajin gusht 3297, në muajin shtator 3318 inv. pune, muajin tetor 3354 inv. pune, muajin nëntor 3382 inv. pune dhe në muajin dhjetor 3395 inv. pune.

Per kryerjen e ketyre pagesave mujore jane realizuar fondet e çelura nga Sherbimi Social Shteteror si me poshte:

| | | Plani Vjetor V.2017 | Fakti Vjetor V.2017 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| 1.Ndihma Ekonomike | Lek | 174.051.070 | 171.263.981 | -2.787.089 |
| 2.Paaftesia total | Lek | 743.470.419 | 746.250.376 | +2.779.957 |
| 3.Shperblimet e fund vitit | Lek | 13.302.000 | 13.288.000 | - 14.000 |
| TOTALE | Lek | 930.823.489 | 930.802.357- | 21.132 |

Duhet te theksojme faktin qe kujdestaret e personave me P.A.K ne numer prej 929 vetash per mungese fondi kane ngelur pa u paguar ne muajin Dhjetor 2017 ne masen prej 10.226.680 lek

F2.O2.A2.Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit, është ndarë e diskutuar me partnerët dhe aktorët vendore. Marrëveshja e bashkëpunimit për mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje, ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile e firmosur dhe në proces zbatimi.

Janë organizuar 8 trajnime për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje përkatësisht me psikologët e shkollave, administratorët socialë, punonjësit e shëndetësisë dhe me policinë e shtetit dhe me policinë bashkiake. Gjithashtu janë realizuar 11 takime të Grupit teknik të punës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

F2.O2.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

Gjatë javës së familjes, janë organizuar 9 aktivitete sensibilizuese me qëllim promovimin e vlerave të familjes dhe shërbimeve që ofrohen në fuqizim të familjes biologjike, promovimit të shërbimeve alternative me qëllim deinstitucionalizimin dhe parandalimin e institucionalizimit. Aktivitetet janë zhvilluar në qendrat komunitare "Për Familjen" nr 1, 4, 5 e në Dajç dhe gjithashtu në shtëpinë e foshnjes 0-3 vjeç.

F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë

11 studentë të vitit akademik 2016 - 2017; 6 nga dega e psikologjisë dhe 5 nga dega e punës sociale kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimit social dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare.

21 studentë të vitit akademik 2017 – 2018; 11 nga dega e punës sociale dhe 10 nga dega e

psikologjisë po zhvillojnë praktikën profesionale në institucionet e përkujdesit rezidencial dhe në qendrat komunitare “Për Familjen”.

F2.O2.A5. Trajtimi i qenve të rrugës

Gjatë vitit 2017 është lidhur kontrata për trajtimin e 138 qenve të rrugës që përfshin kapjen e qenve, sterilizimin, matrikulimin dhe vaksinimin e tyre. Kjo ndërhyrje ndikon në uljen e rrezikshmërisë së përhapjes së sëmundjeve ngjitëse tek qytetarët si dhe zvogëlon mundësinë e riprodhimit të tyre.

F2.O2.A6.Nënshkrimi dhe zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Karta Europiane Për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore është firmosur dhe është bërë pjesë shërbimeve dhe aktiviteteve të Bashkisë së Shkodrës.

F2.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar 13 takime konsultative. 25 organizata të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në këto takime.

F2.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

Në sallën e Këshillit Bashkiak, në bashkinë e Shkodrës, është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues, ku fokusi kryesor i këtij aktiviteti ka qenë mbi të drejtën themelore të fëmijëve “E drejta për edukim”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë rreth 120 fëmijë. Secilit prek tyre, në fund të aktivitetit u është dhuruar nga një libër nga Kryetarja e Bashkisë.

F2.O3.A3. “Shkodra n’fest”

Me rastin e festave të fundvitit janë planifikuar dhe zhvilluar një sërë aktivitetesh socio-kulturore, të shtrira përgjatë të gjithë muajit dhjetor. Në kuadër të Shkodra n’Fest është organizuar panairi i OJF-ve. Qendrat komunitare “Për Familjen” pranë BAshkisë së Shkodrës dhe organizatat e shoqërisë civile kanë prezantuar shërbimet, rezultatet dhe produktet e tyre, duke informuar kështu mbarë komunitetin, mbi mundësitë që ofrohen në territor.

F2.O3.A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për të moshuarit, janë planifikuar dhe organizuar aktivitete ndërgjegjësuese pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Gjatë javës, janë organizuar 4 aktivitete sensibilizuese me focus moshën e tretë. Në takimet e organizuara është bashkëbiseduar për problemet kryeasore shëndetësore që prekin moshën e tretë dhe janë dhënë këshilla parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të tyre. Në fund të takimeve janë reaizuar depistime të të moshuarve për matjen e presionit të gjakut dhe nivelit të glicemisë në gjak. Aktivitetet janë zhvilluar në qendrat komunitare “Për Familjen” nr 1, 3, 4 dhe 5. Numri i pjesëmarrësve në secilin prej takimeve ka qenë rreth 10 persona.

F2.O3. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.

3 dhjetori – dita botërore e personave me aftësi ndryshe synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile dhe mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integrimit të personave me aftësi ndryshe. Në kuadër të kësaj dite janë organizuar një sërë aktivitetesh sensibilizuese dhe argëtuese për personat me aftësi ndryshe. Në kuadër të ditës botërore për PAN-të janë organizuar 2 aktivitete sensibilizuese; në bashkëpunim me organizatën e para-tetra plegjikëve, në palestrën e shkollës “Ail Laçej” është zhvilluar një takim për të treguar punën në vazhdim mbi zhvillimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar fizike, në aktivitete sportive të përshtatshme me mundësitë e tyre. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë rreth 35 persona. Ndërsa pranë “Qendrës së Zhvillimit” është organizuar një aktivitet social kulturor, ku kanë performuar për të pranishmit përfituesit ditorë dhe rezidencial pranë këtij institucioni.

F2.O3.A6. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues për të Drejtat e Fëmijëve. Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve dhe shkollat 9 vjecare, organizoi aktivitet social, kulturor, sensiblizues dhe një panair me punimet e fëmijëve dhe të rinjve në institucionet rezidenciale dhe të organizatave të shoqërisë civile, në sheshin para Bashkisë së Shkodrës.

F2.O3.A7. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi

Gjatë gjithë javës së 8 Marsit, janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin, në qendrat komunitare "Për Familjen".

Gjithashtu është realizuar fushatë ndergjegjësimi duke përgatitë dhe shperndarë në median vizive dhe sociale videoklipi i këngës "Një Grua", kartolina, çanta, spila me synim informimin dhe sensibilizimin e komunitetit.

F2.O3.A8. Bashkëpunimi me Save the Children

Në vazhdim të vitit të dytë të zbatimit të aktiviteteve të parashkuara në Marrëveshjen me Save The Children, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuese për shërbimet alternative me qëllim parandalimin e institucionalizimit dhe deinstitucionlizimin e fëmijëve.

Po zbatohen aktivitete në mbështetje për familjet biologjike me synim parandalimin e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre. Gjatë këtij viti, është zhvilluar dhe ka përfunduar kursi i kujdesit alternativ, ku kanë marrë pjesë 4 specialistë të institucioneve rezidenciale, drejtorisë së shërbimit social dhe 4 specialiste të organizatave partnere.

26 familje kanë përfituar shërbime parandaluese dhe fuqizuese me synim rritjen e fëmijëve pranë familjeve biologjike.

F2.O3.A9. Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Bashkia e Shkodrës ka arritur marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën "Shpresë për botën", për mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; shtëpisë së foshnjes, shtëpisë së fëmijës shkollor dhe qendrës së zhvillimit. Në zbatim të marrëveshjes së arritur është përmirësuar cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre.

F2.O3.A10: Dita ndërkombëtare e romëve

Është organizuar aktiviteti ndërgjegjësues me pjesëmarrje të gjerë nga komuniteti, institucionet dhe organizatat. Synimi kryesor i këtij aktiviteti ka qenë integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian. Në bashkëpunim me shkollën "Edith Durham" është organizuar aktiviteti ndërgjegjësues, social-kulturor ku morën pjesë përfaqësues nga komuniteti rom, përfaqësues të organizatave partnere ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore. Në këtë aktivitet u prezantua "Cirku i Ëndrrave", trupë teatrore dhe akrobatike e përbërë nga fëmijë të komunitetit rom dhe të maxhorancës.

F2.O3.A11. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."

Bashkia e Shkodrës, ka rritur marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën Sos, Fshatrat e Fëmijëve, si një nga organizatat e rëndësishme partnere për mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve në vështirësi ekonomike dhe sociale. Në zbatim të marrëveshjes të bashkëpunimit janë përzgjedhur dhe po punohet për fuqizimin e familjeve biologjike, të fëmijëve të institucionalizuar, me qëllim deinstitucionalizimin e tyre dhe gjithashtu po punohet me familjet e fëmijëve të identifikuar në rrezik institucionalizimi.

F2.O4.A1. Lojra Popullore Fest, edicioni 9-të

Është zhvilluar aktiviteti “Lojra Popullore Fest”, ku synimi kryesor i këtij eventi ka qenë ruajtja, promovimi dhe përcimi i traditave kulturore tek brezat e rinj, nëpërmjet angazhimit tyre në këtë aktivitet. Në këtë vit ka patur pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha trevat shqiptare dhe për shkak të kushteve atmosferike u zhvillua në sallën e aktiviteteve të shkollës artistike “Prenkë Jakova”.
F2.O4.A2 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet. Gjatë vitit 2017 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare, “Për Familjen” nr. 4, për komunitetin rom dhe egjiptian. Janë orientuar për punësim dhe formim profesional dhe është arritur punësimi i 16 personave të komunitetit rom dhe egjiptian.

Ka vazhduar proçesi për regjistrimin civil dhe të vendbanimit të komunitetit rom. Janë realizuar 5 transferime të regjistrimit civil pranë bashkisë së Shkodrës dhe 7 regjistrime civile për herë të parë në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu gjatë vitit 2017, është filluar puna për ndërtimin e qendrës komunitare që do ofrojë shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Gjithashtu të gjithë fëmijët rom janë regjistruar në kopështe dhe shkolla, sipas vendbanimit tyre dhe po ndiqet e mbështetet frekuentimi  i tyre.
F2.O4.A3. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit
Për vitin 2017 është përgatitur dhe realizuar e gjithë procedura e nevojshme për lëvrimin e shpërblimit të jetimëve, me rastin e festive të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosphere sa më të mirë festive. Fond i planifikuar është 400 mijë lekë e realizuar kjo në masën 100%.
F2.O5.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndeteshëm
Gjatë vitit 2017 janë organizuar 16 tema të shëndetit bazuar në ditët ndërkombëtare, si: Kanceri i qafës së mitrës, Kanceri “Ne mundemi, unë mundem”, Fëmijët dhe higjiena e gojës, Autizmi, Martesat e hershme tek komuniteti rom dhe egjiptian, Aktiviteti fizik tek fëmijët dhe adoleshentët, Duhani vret, Jo punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Këto tema janë prezantuar në 50 takime të organizuara në qendrat komunitare “Për Familjen”, në shkolla, në qytet dhe në njësitë administrative Dajc, Guri i Zi, Postribë dhe Bërdicë. Numri total i pjesëmarrësve në këto takime është 913 persona.
F3.O1.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Sociale Komunitare “Për Familjen”

Gjatë kësaj periudhe është punuar për konsolidimin e shërbimeve në qendrat e vëna në funksion dhe gjithashtu është realizuar  ngritja dhe vënia në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen” përkatësisht në  Njësitë Administrative Shalë, në Theth, Velipojë dhe Rrethina. 7 qendra Komunitare “Për Familjen” të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet. 3 qendra të reja, të gatshme për të ofruar shërbime në njësitë administrative Shalë, Rrethina dhe Velipojë.

Ne totalin e shpenzimeve për qëndrat komunitare realizmi ne total  eshte 66 %. Jane realizuar pagat me rreth  70 %, shpenzimet operative me rreth 46 % dhe investimet  me rreth 98 %.

*000/leke*

| Emertimi | Plani fillestar | Plani i korigjuar | Fakti | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Paga dhe Sigurime | 6 758 | 6 758 | 4 243 | 63% |
| Shpenz.Operative | 1 650 | 1 650 | 756 | 46 % |
| Investime | 250 | 250 | 244 | 98 % |
| **Totali** | **8 658** | **8 658** | **5 243** | 61 % |

F3.O1.A2 Çerdhet

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjet që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 3 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 148.

1. „Shpenzime per paga e sigurime"
Fondi i planifikuar per mbulimin e shpenzimeve ne paga eshte 21.584.mije leke dhe realizimi paraqitet ne vleren 20.210.mije leke dhe fondi i planifikuar per sigurime shoqerore eshte 3.370.mije leke dhe realizimi paraqitet ne vleren 3,334.mije leke.

2. .Shpenzime per Mallra dhe Sherbime te tjera.
Fondi i planifikuar per kete ze eshte 8.551.mije leke dhe realizimi i ketij artikulli paraqitet me vleren 8.287mije leke. .
Ne zerin"Materjale zyre dhe te pergjithshme" „ realizimi eshte 167.mije leke,kjo vlere perfaqson shpenzimet qe jane bere per blerje kancelarie dhe blerje dokumemntacioni.
Ne zerin „Materjale per pastrim ngrohje dhe ndriçim" realizimi perfshin vleren 936.mije nga 940.mije leke qe ishin planifikuar per te blere materjale pastrimi, gaz per ngrohje e gatim.
Ne zerin „Materjale dhe sherbime speciale" realizimi eshte 4493.mije leke nga 4.600mije leke qe ishte planifikuar..Ne kete vlere perfshihet shuma prej 4296.mije leke qe perfaqson realizimin e „Kontrates se Furnizimit me Ushqime" si dhe shuma prej 197.mije leke qe perfaqson realizimin e „Blerjeve te materjaleve te tjera „si batanije,ene guzhine etj .
-Ne zerin „Sherbime nga te trete" realizimi eshte 2068.mije leke.Kjo vlere e perfaqson faturat e energjise elektrike qe perfshin shumen prej 774 mije leke, faturat e konsumit te ujit me vlere prej 858 mije lekedhe faturat epageses se internetit prej 36.mije leke.Ne kete shume perfshihet edhe realizimi i blerjeve te druve te zjarrit e planifikuar me nje vlere prej 400.mije leke e cila eshte realizuar 100%..
Ne „Zerin „Shpenzime Transporti".realizimi perfshin vleren prej 236.mije.leke ne te cilen perfshihet shpenzimet qe jane bere per blerje karburanti dhe pagesa e siguracionit dhe te tjera shpenzime transporti..
Ne zerin "Mirembajtje e zakonshme" fondi i planifikuar prej 415 mije leke eshte realizuar ne masen 93% me nje vlere prej 387 mije leke ku perfshihet vlere prej 321.mije qe perfaqson realizimin e "Mirembajtjese ndertesave (lyerjes me boje) si dhe vlerat perj 66 mije leke qe perfaqsojne shpenzimet qe jane bere per mirembajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike dhe paisjeve te zyres.
3. Ne zerin *"Investime"* fondi planifikuar prej 475.mije leke eshte realizuar ne vleren 410 mije leke.Tek kjo vlere perfshihet shuma prej 166 mije leke qe eshte perdorur per te blere orendi per zyren e Drejtorise si:(tavolina,karriga,raft) ,vlera prej prej 87 mije leke eshte shpenzuar per te blere kondicionere dhe **67** mije leke per blerje kompjuteri dhe vlera prej **90** mije lek qe eshte perdorur per te blere 1 raft per zyre,banak per kuzhine dhe 1 fshese me korrent.

F3.O1.A3. Shërbimi i Kujdestarisë Familjare

Gjatë kësaj periudhe, janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve të mundshme që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim, deinstitucionalizimin e tyre. Janë organizuar gjashtë takime informuese dhe ndërgjegjësuese me komunitetin, mbi shërbimin e kujdestarisë familjare, ku janë shpërndarë materialet promocionale të përgatitura posacërisht për këtë shërbim. Gjithashtu kemi 5 raste të familjeve kujdestare të mbyllura dhe 5 raste të familjeve kujdestare në proces.

F3.O2.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes"

Gjatë vitit 2017, është bërë përzgjedhja dhe rekrutimi i stafit që do punojë për qendrën rinore dhe stafi është trajnuar për ofrimin e shërbimeve. Është realizuar hartimi i planit të komunikimit për qendrën rinore. Është realizuar database për mbledhjen e të dhënave për nevojat e të rinjve në bashkinë e Shkodrës dhe mundësitë që ofrohen për to në territor. Gjithashtu është mbyllur prokurimi për rikonstruksionin e qendrës rinore, është shpallur fituesi dhe kanë filluar punimet.
Për qëndrën Rinore për vitin 2017 është planifikuar vlera 20 930 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 6 695 mijë lekë që çon në një realizim në masën 32 %. Gjatë punimeve për rikonstruksionin e objektit ka pasur vonesa të punimeve për shkaqe të ndryshme të cilat do të përfundojnë në vitin 2018 për zbatimin me sukses të këtij projekti.
Rikonstruksioni i Qëndrës së parë publike është në proçes finalizimi .
Meqënëse ky projekt financohet nga programi Italo-Shqiptar i konvertimit të borxhit për zhvillim, afati i realizimit është gjysma e vitit 2018.

*000/leke*

| Emertimi | Plani fillestar | Plani i korigjuar | Fakti | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|
| Paga dhe Sigurime | | 5 227 | 549 | 10.5 % |
| Transferime | | 8 593 | 2 148 | 25 % |
| Investime | | 7 110 | 3 998 | 56 % |
| **Totali** | | **20 930** | **6 695** | 32 % |

F4.O1.A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe
Funksionimi i shtëpi – familjeve dhe ofrimi shërbimeve në përputhje me standartet e shërbimeve shoqërore. Mbështetja dhe financimi i aktiviteteve të 7 shtëpi – familjeve, të administruara nga organizata “Projekti Shpresa”. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetsore 58 individë me aftësi ndryshe.

Në transfertën specifike të vitit 2017 te Bashkisë Shkodër i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për qendrën “Shpresa” Shkodër. Shuma e alokuar për këtë qendër ishte 17 385 mije lekë nga të cilat 16 145 mijë lekë per paga dhe sigurime dhe 1 240 mijë për shpenzime operative. Vlera e realizuar në total është 17 372,77 mijë lekë duke u realizuar në masën 99.9 %.

F4.O1.A2.“Asnjë Fëmijë Jashtë”
Ky aktivitet nuk është zhvilluar sepse operatori ekonomik fitues nuk u paraqit dhe duke qenë aktivitet i parashikuar në fund të vitit, nuk kishte kohë për paraqitjen e operatorëve tjerë.
F4.O1.A3.Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”

Banda muzikore gjatë vitit 2017 ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë vitit. Mbështetja e aktiviteteve të bandës muzikore e përbërë nga Trupë Muzikore me pjesëmarrjen e 25 të rinjve me aftësi ndryshe.

### III Fondet e financimit të programeve

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të Programit të hartuar gjatë procesit të miratimit të Buxhetit të vitit 2017. Ky program konsiston në mbulimin sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.
Buxheti i akorduar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së programit. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017**

1.Fondet e miratuara për këtë program për aktivitetet e planifikuara nga Drejtoria e Shërbimeve sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik janë 1,018,508 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 995,244 mijë lekë që përbëjnë 98 % .
Nga këto fondet për shpenzime korrente sipas planit 2017 janë:

a. Paga dhe sigurime janë realizuar në masën 28 337 mijë lekë nga 37 728 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 76 %.

b.Shpenzime operative janë realizuar në masën 11,379mijë lekë nga 15 572 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 73 %.

c. Transferta jane realizuar ne masen 950 878 mije leke nga 957,373 mije leke qe ka qene e parashikuar dhe perben 99 %.

d.Investime janë realizuar në masën 4,651 mijë lekë nga 7,835 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 59 %.

**Fondet e rishikuara për këtë program:**

Meqënëse fondi i parashikuar për Blerje paisje zyre u vlerësua si i pamjaftueshëm në raport me nevojat e konstatuara për ndërhyrje, me Vendim nr. 366, datë 09.10.2017, të Kryetares së Bashkisë është miratuar rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve dhe investimeve në P10F3O1A1 "Ngritja dhe vendosja në funksion e qendrave komunitare per familjen" me pakësim te paisje zyre në vlerën 100 000 lekë dhe shtesë në Blerje paisje TIK në vlerën 100.000 lekë.
Në po këtë vendim rishperndarje ndërmjet zërave në P10.F4.O1.A2 "Asnje femijë jashtë" me pakësim të "Honorare për inspektorët e muzikës 10 x 4" në vlerën 40.000 lekë dhe " Honorare punëtorë skene 10 x 3 në vlerën 30.000 lekë dhe shtim ne 'Shpenzim për marrje me qira të skenografisë në vlerën 70.000 lekë.
Gjithashtu është pakësuar ne P10.F2.O3.A3 pika A.1 "Shkodra nFest në vlerën 500.000 lekë dhe shtim Shkodra nfest po 500.000 duke i bere nje detajim shpenzimeve të aktivitetit.

Nga rishperndarja e fondit te vitit 2016 është miratuar Pershtatja e ambjenteve per krijimin e Qendres se Autizmit në vlerën 1 000 lekë

Plani fillestar i Çerdheve i vitt 2017 per Llog.„600" me te ardhurat ka qene 10886.mije leke pastaj me „Vendimin e Kryetarit nr."375" dt.16.10.2017 jane bere ndryshimet e planit ne baze te shkreses nr/15932 prot. dt.25.10.2017 si me poshte: eshte paksuar llog."600" per 100.mije leke dhe eshte shtuar llog."601" per 100.mije leke.ndersa ne baze te „U.Brendshem nr.375 dt.31.5.2017 per rast dalje ne pension sipas shkreses nr 8874/prot. dt 08.06.2017 jane bere transferimet e planit nga llog."600" tek „606" per vleren 87.500.leke..Plani i korigjuar eshte 10.698.5.leke

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

| Aktivitete/Projekte | Plani Fillestar | Plani Korrigjuar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| P10.F1.O1.A1 Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e çezmave publike | - | - | - |
| P10.F1.O1.A2 Administrimi i apartamenteve sociale dhe ngritja e qendres komunitare në mbështetje të jetimeve dhe nënave kryefamiljare në vështirësi ekonomike sociale. | **1789** | **1789** | 0.00 |
| **P.10.F1.O2.A1** Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje. | 300 | 300 | 0.00 |
| **P.10.F1.O2.A2** Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës | - | - | - |
| **P10.F2.O1.A1** Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge | - | - | - |
| **P10.F2.O2.A1.** Ndihma ekonomike dhe PAK | 958,758 | **930,823** | **930,802** |
| **P10.F2.O2.A2.** Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. | 300 | 300 | 219 |
| **P10.F2.O2.A3.** Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj | 50 | 50 | 37 |
| **P10.F2.O2.A4.** Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë | - | - | - |
| **P10.F2.O2.A5.** Trajtimi i qenve të rrugës | 800 | 800 | 580 |
| **P10.F2.O2.A6.** Nënshkrimi dhe zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. | 100 | 100 | 82 |
| **P10.F2.O3.A1.** Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës. | - | - | - |
| **P10.F2.O3. A2.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori. | 50 | 50 | 49 |
| **P10.F2.O3. A3.** "Shkodra n'fest" | 500 | 500 | 459 |
| **P10.F2.O3. A4.** Dita ndërkombëtare e të moshuarve. | - | - | - |
| **P10.F2.O3. A6.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, | 100 | 100 | 87 |

më 3 Dhjetor.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **P10.F2.O3. A7.** Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori | - | - | - |
| **P10.F2.O3. A8.** Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi | 150 | 150 | 123 |
| **P10.F2.O3. A9** Bashkëpunimi me Save the Children | - | - | - |
| **P10.F2.O3. A10** Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë. | - | - | - |
| **P10.F2.O3. A11**: Dita ndërkombëtare e romëve | 100 | 100 | 90 |
| **P10.F2.O3. A12:** Pershtatja e ambjenteve per krijimin e Qendres se Autizmit<br>**P10.F2.O3. A13.** Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve." | 0.00 | 1000 | 0.00 |
| **P10.F2.O4.A1.** Lojra Popullore Fest, edicioni 9-të | 207 | 207 | 188 |
| **P10.F2.O4.A4.** Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit | 400 | 400 | 400 |
| **P10.F2.O5.A1** Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndeteshëm | - | - | - |
| **P10.F3.O1.A1.** Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Sociale Komunitare "Për Familjen" | 8658 | 8658 | 5243 |
| **P10.F3.O1.A2** Çerdhet | 34152 | 34152 | 32396 |
| **P10.F3.O1.A3.** Shërbimi i Kujdestarisë Familjare | 100 | 100 | 80 |
| **P10.F3.O2.A1** Qendra Rinore "Po të Ardhmes" | 0 | 20929,9 | 6695 |
| **P10.F4.O1.A1.** Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe; | 17385 | 17385 | 17373 |
| **P10.F4.O1.A2.** "Asnjë Fëmijë Jashtë" | 266 | 266 | 0.00 |
| **P10.F4.O1.A3.** Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe" | 348 | 348 | 342 |
| **Total** | **1.024.513** | **1.018.508** | **995.244** |

## IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

Për drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik lëvrimi i fondeve të parashikuara është realizuar në masën prej 98 %.

Sa i përket aktiviteteve të administrimit të apartamenteve sociale dhe programeve të strehimit social, është krijuar Komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Nuk është realizuar fondi i parashkiuar pasi pritet vendimi nga Këshilli Bashkiak për miratimin e sistemit të pikëzimit.

Ndërsa sa i përket aktivitetit "Asnjë Fëmijë Jashtë", i parashikuar në kuadër të festive të fundvitit me synim gjithpërfshirjen e fëmijëve të familjeve vulnerabël e në vështirësi socio –ekonomike, nuk është

realizuar sepse operatori ekonomik i shpallur në vend të parë nuk u paraqit de duke qenë në ditët e fundit të vitit, nuk kishte më kohë për të pritur operatorët e tjerë, sipas procedurave administrative ligjore operatorët e tjerë në vazhdim.
Ndërsa mos realizimi i plotë i projektit "Ngritja dhe vendosja në funksion e qendrave komunitare" ka qenë për arsye të mos plotësimit në kohë të stafit që punojnë në këto qendra, për pasojë nuk është realizuar zëri paga dhe sigurime. Gjithashtu në vitin 2017 ishtë parashikuar pagesa e borxheve për energjinë elektrike dhe ujin si rezultat i keqmenaxhimit që kanë pasur në të shkuarën këto qëndra. Po vlerësohen përgjegjësitë ligjore për të siguruar likujdimin e këtyre borxheve, për pasojë zëri shpenzime operative është realizuar në masën 46%.

## P11 Kultura dhe shërbimet rekreacionale

Shkodra, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore do të bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor.

Kjo trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me shtrirje nga Alpet deri në bregdet, do të bëhet faktor kyç për rritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve.
Njëqind e dyzet e dy monumente kulture janë sot të përfshira në hartën e re administrative territoriale të Bashkisë së Shkodrës. Programi ynë synon fuqizimin e strukturës administrative dhe mirë organizimin e institucioneve aktuale të kulturës së Bashkisë.

Një nga kolonat kryesore të programit ka qene rivitalizimi i institucioneve aktuale të kulturës.
Shkodra ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në art dhe kulturë, me të cilat ajo merr kuptim. Këto vlera kanë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Pjesë e programit ka qene mbështetësja dhe nxitësja e zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet institucioneve dhe enteve lokale.
Pikënisja e programit tonë është mirë menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore-artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellë në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, të fotografisë, muzikës, teatrit etj. Si dhe ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës.
Muzika folklorike dhe qytetare shkodrane, promovimi dhe organizimi i festivaleve të përvitshme dhe aktivitetet kulturore kanë pasuruar traditën muzikore të qytetit me kompozime dhe shfaqje të reja duke gjallëruar jetën artistike në Shkodër.
Kemi synuar promovimin e formave alternative të administrimit dhe marketingut të Arteve pamore dhe institucioneve të tjera kulturore në Shkodër pjesë e rrjetit muzeve dhe institucioneve kulturore për t'u vizituar.

Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive ka qene një nga politikat e programit.

Bashkia e Shkodrës, Drejtoria e Kulturës bashkë me Bibliotekën Marin Barleti, ka mbështetur në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij me synimin e ndërthurjes së politikave vendore dhe strategjive ndërkombëtare për bibliotekat publike.

## I. Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave

Drejtoria jonë me qellim kryesorë atë të zhvillimit të sektorit të kulturës, në zbatim të kuadrit ligjor, synon në mbulimin e këtyre funksioneve kryesore:
F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
F2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
F3. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetareve.

*Objektivat për secilin funksion janë:*

F1 O1: Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimise kulturore dhe mirë administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.
F2 O1 :Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës.
F2 O2: Pasurimi dhe gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.
F3 O1: Promovimi dhe nxitja e leximit si instrument edukimi duke rritur aksesin dhe cilësinë e shërbimit pranë Bibliotekës "Marin Barleti".
F3 O2: Ruajtja, mirë administrimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës "Marin Barleti".

## II. Produktet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017, për realizimin e funksioneve dhe objektivave përkatës të mësipërm, drejtoria e jonë ka realizuar produktet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme, të parashikuara në Buxhetin 2017 të Bashkisë Shkodër për programin e Kulturës.
P11.F1.O1.A1: Java e pavaresise, ekspozite etnografike me elemente kostumografie e zejesh:
Trashëgimia materiale që ruan muzeu në rrafshin e etnografisë dhe arkivit është shumë disiplinare. Qëllimi i aktivitetit ishte të korrigjonte deri diku një kostumografi të përcudnuar larg vlerave origjinale që rrezikon figurën identitare te trashëgimisë tonë prodhuar nga tregu aktual të lidhura kryesisht me figuren femerore por që janë në thelb fenomene të një shpirti krijues dhe të pasur artistikisht. Shto këtu dhe humbjen e ngadalte të shumë zejeve që plotësojnë panoramën e plotë të kësaj tradite. Llojshmëria e materialeve flet dhe për diapazonin e gjerë të rajonit të Shkodrës dhe kontakteve që ka zhvilluar me botën anembanë
P11.F1.O1. A2: Prodhim dhe shtypje biletash
Nisur nga trend ku vit pas viti grafiku I vizitave ka shënuar rritje, per vitin 2017 u rrit prodhimi ne 20 000 copë bileta seria D. Prodhimi dhe shtypja e Biletave u krye pranë Shtypshkronjës së letrave me vlerë në Tiranë.Biletat u prodhuan me të gjitha parametrat ligjor dhe informues duke pasur në trup të tyre përvec informacionit bazë si çmimi dhe destinacioni edhe të dhëna mbi faqen zyrtare web të

Muzeut Historik Shkodër me logon pershkruese te Muzeu ,"Oso Kuka", I Kalasë dhe Vendi I Dëshmisë dhe Kujtesës, ne dy tipe 50 dhe 150 lekeshe.

P11.F1.O1. A3: Dita nderkombetare e monumenteve dhe siteve arkeologjike:

Në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 25 "Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese", Bashkia Shkodër këtë vit ka kryer disa investime në përmirësimin dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.Problematika e krijuar tek Muzeu i Keshtjellës, si pasojë e lagështirës, bëri të domosdoshëm ndërhyrjen nga ana jonë edhe këtë vit. Lyerja e mureve të këtij Muzeu me gëlqere është nevojë e përvitshme, në mënyrë që të minimizohen pasojat që sjell lagështira. Gjithashtu, lyerja me vaj lini e dyshemesë, të përbërë prej dërrasash, është domosdoshmëri për jetëgjatësinë e tyre. Këtë vit u realizuan edhe riparime të vogla të suvasë në muret e brëndshme të këtij Muzeu.

P11.F1.O1. A4: Mbeshtetje per funksionimin e aktivitetit dhe sherbimin ne vazhdim te Muzeut Historik Shkoder:

Muzeu Historik i Shkodrës ka nisur të organizohet që në vitin 1947, nën emërtimin "MuzeuPopullor" dhe mori formë të plotë në vitin 1949.

Në vitin 1996, Muzeu Historik i Shkodrës u transferua në banesën "Oso Kuka", ku ndodhet edhe sot. Paralelisht me të vazhdon të funksionojë edhe Muzeu i Kalasë "Rozafa" i vendosur në godinën e Kapitenerisë.Këto dy vitet e fundit strukturës organike të Muzeut i është shtuar edhe ajo e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës.

Gjatë këtij viti janë realizuar: Përmirësimi i dukshmërisë së sallave të Muzeut të Kalasë. Lyerje me gëlqere dhe vaj lini i ambjenteve të brendshme. Blerje kamera sigurie dhe shërbim për kamerat ekzistuese të Muzeut të Keshtjellës dhe të Banesës "Oso Kuka". Blerje 3 hard disqe për dixhitalizim të fondit të Muzeut Historik,Shkodër. Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik, Shkodër.

P11.F1.O1. A5: Ribotim i guides te muzeve te Bashkise Shkoder:

Muzeu botoi guidën e vet duke u kthyer në një element promovimi të denjë në prezantimin e kulturës së rajonit tonë.Hapësira informuese me shkrim dhe fotografi që ka modeli i guidës, shtrihet gjerësisht që nga koha e neolititit deri në shekullin XX-të.Informacioni është gjithëpërfshirës dhe prezantimi i parë me publikun ka qenë tepër dashamirës. Situata Muzeale në Shkodër dhe më gjerë ka ndyshuar vitet e fundit rrjetit muzeal në Shkodër i janë shtuar rikonstruksioni i muzeut të Keshtjellës, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës dhe Foto Muzeu Kombëtarë Marubi.

Ribotim i guidës së Muzeve të Bashkisë Shkodër me çdo risi që është shtuar në vite, përbën një nevojë për njohjen dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të vëmendjes së publikut vendas dhe të huaj.

P11.F1.O1.A6: Risistemim i ekspozimit te objekteve te gurta ne Muzeun Oso Kuka.

Risistemim I ekspozimit te objekteve te gurta në Muzuen Oso Kuka me anë të prodhimit të suporteve metalik mbajtës dhe montimi i tyre për objektet e gurta që ndodhen të shpërndarë në oborrin e muzeut me dimensioneve të ndryshme rezistent ndaj lagështirës, të aftë të mbajnë elemente prej guri të rëndë ishte zgjidhja optimale që respekton kushtet më minimale te konservimit.Punimi artizanal në hekur të rrahur risistemoj mënyrën ekspozuese të shumë objekteve prej guri që ndodhen në muze duke i larguar ata nga ambientet e jashtme këtë radhe nën strehat e muzeut.

P11.F1.O1.A8: Publikime promocionale, fletepalosje e guide per Vendin e Deshmise dhe te Kujteses:

Ky investim parashikonte pergatitje dhe printim materialesh promovuese te aktivitetit te Muzeut. Keto materiale jane realizuar ne muajt e pare te vitit 2017, duke qene te gatshem per sezonin turistik. Duhet thene qe keto materiale kane rezultuar shume te vlefshme per aktivitetin tone te

perditshem, sepse vizitoret i kane marre ato dhe nepermjet tyre eshte bere dhe promovimi i Muzeut ne vendet e ndryshme te Botes.

P11.F1.O1. A9: Cikel bisedash dhe ndergjegjesimi i te rinjve nen fokusin e librave me tematike mbi te kaluaren komuniste.

Gjate vitit kalendarik jane realizuar disa takime me ish te burgosur politik, te cilet kane rrefyer kujtimet e tyre para grupeve te ndryshme me te rinj, te cilet ishin studente te Universitetit te Shkodres, apo nxenes te shkollave te mesme. Keto takime i kane sherbyer te rinjve per te kuptuar me mire realitetin e kohes dhe mekanizmat e pushtetit komunist. Jane nje tradite e bukur te cilen do e zhvillojme edhe kete vit kalendarik. Lektoret qe moren pjese ne keto takime jane:Fatbardha Saraçi, Zenel Drangu, Gjeto Vocaj.

P11.F1.O1. A10 Mirembajtje e nderteses se Vendin e Deshmise dhe te Kujteses:

Ne muajt e pranveres te vitit 2017 jane eshte realizuar mirembajtja e nderteses se Muzeut. Konkretisht nderhyrja ka qene ne zonen e tunelit, qe ben lidhjen mes zones hyrese dhe zones se qelive. Ky tunel ne vite ka shfaqur probleme me lageshtiren, sepse reshjet atmosferike ne zona te caktuara depertonin brenda. Situata eshte permiresuar ndjeshem, pasi eshte nderhyre me katrama ne pjesen e siperme. Megjithate ka disa pjese te cilat ne vazhdimesi duhet te mirembahen, duke permiresuar me shume cilesine e sherbimit qe i ofrohet vizitorit.

P11.F1.O1.A11: Dita nderkombetare e muzeumeve: Ekspozita me titull “Edhe ne luanim dikur”.

Aktiviteti kishte ne themel natyrë pedagogjiko-edukative dhe u organizua për herë të parë permes nje thirrje, ku u përfshine studentë të shkollave parauniversitare e më lart deri tek moshat madhore. Lodrat janë kanë qenë e janë bashkëudhëtare në jetën e çdo njeriu. .Ato janë edhe simbol I zhvillimit të caktuar të një shoqërie.

Qellimi I aktivitetit ishte promovimi dhe implikimi I publikut ne ruatjen e vlerave te trashigimise kulturore materiale e shpirterore. Ne realizimin e ketij aktiviteti u konceptuan banere, ftesa, fletepalosje dhe materiale kancelerike.

P11.F1.O1. A12: Ekspozita Salloni i Vjeshtës

Ekspozita vjetore e arteve pamore “Salloni i vjeshtës” është kthyer tashmë në një aktivitet tradicional. Ajo zhvillohet në Galerinë e Arteve të qytetit të Shkodrës në fund të muajit nëntor duke qenë pjesë e eventeve që organizohen nga Bashkia e Shkodrës në kuadër të “Javës së Pavarësisë”. “Salloni i vjeshtës”, që në 2017 arrin në edicionin e tij të11-të, me pjesmarrjen e gjërë që e karakterizon, përbën një nga momentet kulmorë të kalendarit vjetor të GASH si dhe një ngjarje të rëndësishmë për të gjithë krijuesit e artit pamor të qytetit të Shkodrës. Akordimi i çmimeve fituese për krijimet më të spikatura të ekspozitës ndihmon në rritjen e koleksionit të galerisë me vepra bashkëkohore.

P11.F1.O1. A13: Çmimi Idromeno

Galeria e Arteve e Shkodrës, me mbështetjen e Bashkisë së Shkodrës, organizon çdo dy vjet konkursin kombëtar të artit pamor “Çmimi Idromeno” për artistët e rinj (deri 35 vjec). Në realizimin e 4 edicioneve të deritanishme të këtij konkursi (2008, 2010, 2013, 2015) kanë bashkëpunuar si kuratorë apo anëtarë të komisioneve të vlerësimit studjues, historianë arti dhe personalitete të shquara të artit shqiptar. Njëkohësisht një brez i ri artistësh të talentuar janë prezantuar me veprat e tyre para publikut shkodran.

Çmimi Idromeno konsiston në një shpërblim financiar për fituesin, vepra e të cilit bëhet pjesë e fondit të GASH, si dhe në mbështetjen që Galeria e Shkodrës i jep atij vitin pasardhës në organizimin e një ekspozite personale.

P11.F1.O1.A14: Personazh i ftuar – Ekspozite personale e nje personaliteti te artit pamor shqiptar te ftuar nga Galeria e Arteve Shkoder.

Në Galerinë e Arteve të Bashkisë së Shkodrës, dt. 17 tetor 2017, ora 18:00, u përurua ekspozita personale e artistit Andi Hila me titull: "Ekzaltim". Në hapjen e ekspozitës morën pjesë artdashës të shumtë, media lokale dhe personalitete të spikatur të artit dhe kulturës. Ekspozita qëndroi e hapur për publikun deri me dt. 17 nëntor. Gjatë periudhës së ekspozimit pati interes shumë të lartë nga publiku. Vizitorët e shumte ishin nga kategori te nxenesve dhe studenteve si dhe grupe te ndryshme moshe.

P11.F2.O1.A1: Nje piano per qytetin e artit.

Prej shumë vitesh artistëve dhe instrumentistëve shkodranë dhe të ftuarve, që nuk mungojnë në qytetin e Shkodrës, u mungoi një piano koncertore cilësore. Blerja e ketij instrumenti u realizua ne Gusht 2017 dhe mundesoi organizimin e koncerteve ku nevojitet pianoja, në nivelin e duhur artistik.

Per realizimin e ketij projekti u hap një fushatë sensibilizuese për dhurime për projektin "Një piano për qytetin e artit" ku u bashkuan shume donatorë dhe qytetarë të ndryshëm te cilet dhuruan fonde dhe bashke me fondet e investuara nga Bashkia Shkoder bene te mundur realizimin e projektit.

P11.F2.O1.A3: Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unikale që ka qyteti ynë, me fillimet e hershme që nga viti 1876. Bashkia Shkodër e mbështet çdo vit me honorare këtë formacion, i cili gjatë gjithë vitit është prezent në pothuajse të gjitha aktivitetet artisko-kulturore si dhe në datat e rëndësishme historike zyrtare kombëtare dhe lokale. Formacioni i Orkestrës Frymore të Bashkisë Shkodër, përbëhet prej 40 muzikantëve.

P11.F2.O1.A4: Prodhim dhe shtypje biletash per Teatrin Migjeni:

Eshte kryer blerja e biletave per aktivitetet e Teatrit dhe blerja e kancelarive te nevojshme per ecurine normale te procesit te punes.

P11.F2.O1.A5: Administrimi dhe menaxhimi i Teatrit Migjeni.

Institucioni i Teatrit "Migjeni" është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 35 personash. Kjo fishe ka të bëjë me pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit "Migjeni".

P11.F2.O1.A6: Sherbime nga te trete per furnizim me energji, uje etj.

Shërbimet nga të tretë si energji, ujë etj. janë shërbime që financohen nga Bashkia Shkodër çdo vit, të cilat janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e Teatrit "Migjeni".

P11.F2.O1.A7: Shërbime administrative për Teatrin "Migjeni"

Kjo fishe e realizuar konsiston në administrimin e aktivitetit të përditshëm të Teatrit "Migjeni", siç janë pritje-përcjelljet, të nevojshme për aktivitete të ndryshme; siguracioni i ndërtesës së Teatrit "Migjeni", i cili është detyrim ligjor; pjesëmarrje në konferenca të ndryshme te stafit te teatrit.

P11.F2.O1.A8: Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike

Trupat artistike të atashuara pranë Teatrit "Migjeni" shpesh herë ftohen të marrin pjesë në aktivitete apo konkurse të ndryshme, brenda dhe jashte vendit. Në shumicën e rasteve, këto trupa kthehen me çmime të fituara me meritë nga këto aktivitete. Bashkia Shkodër e nxit dhe e mbështet çdo vit Teatrin "Migjeni" për të qenë pjesë e këtyre aktiviteteve. Jane realizuar dhe udhetime jashte shteti si ne : Podgorice te Malit te Zi,Presheve, Prizren, Gjakove, Ferizaj te Kosoves. Jane realizuar dhe udhetimet brenda vendit si ne Tirane 3 here, ne Elbasan, Korçe, Butrint dhe Fier.

P11.F2.O1.A9 : Rregullimi dhe sistemimi i arkives dhe gardarobes te Teatrit Migjeni:

Ambjenteve i jane riparuar muret, eshte kryer suvatimi dhe lyerja e tyre. Gjitashtu dyshemeja eshte shtruar me parket duke krijuar kushte te mira dhe ne perputhje me standartet e mirembajtjeve te materialve qe ato permbajne.

P11.F2.O1.A10: Rikonstruksion i godines te Teatrit Migjeni:

Eshte likuiduar kontrata rikonstruksion i godines Teatri Migjeni sipas projektit te hartuar ne vitin 2016 dhe fondeve te celura nga Ministria e Kultures gjate vitit 2017.

P11.F2.O2.A1: Dita e Luleve 6 Maj

“Dita e Luleve 2017”, u zhvillua në datën 6 maj 2017 në disa pika të qytetit të Shkodrës, në sheshin para Bashkisë Shkodër, në sheshin “Nënë Tereza” dhe përgjatë rrugës “28 nëntori”.

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata “Acli-Ipsia në Shqipëri”. Media partner i këtij aktiviteti ishte Star Plus.

“Dita e Luleve 2017”, e titulluar “Festa e Luleve. Tanë ditën n’festë” nga subjekti, u konceptua mbi tema të ndryshme: “Panairi i luleve” – I vendosur në Sheshin “Nënë Tereza”, panairi i luleve u hap në orën 10:00-21:00 të datës 6 maj.Në këtë organizim u ftuan subjekte dhe qytetarë të ndryshëm që merren me kultivimin e luleve.“Parada e luleve” – Kjo temë ishte e dedikuar për fëmijët. Në aktivitet u angazhuan fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar, të cilët të veshur në përshtatje me tematikën e ditës, performuan gjatë gjithë pedonales “28 nëntori”, deri tek sheshi para Bashkisë Shkodër. “Zanat e luleve” - Pranë ish-kafes së madhe ishte vendosur një kënd i veçantë, i zbukuruar me lule dhe i ideuar si një ministudio fotografike për fotografimin e fëmijëve dhe të rriturve.“Lulet e qytetit tim përmes fotografisë” – Konkurs i cili konsistonte nëzhvillimin e një gare fotografie, mes të apasionuarve dhe fotografëve profesionistë, të cilët do të shkrepnin foton më të bukur me tematikë lulet e Shkodrës.Fotografitë më të realizuara, në ditën e festës u ekspozuan në sheshin para Bashkisë Shkodër, ndër të cilat me votim të hapur nga publiku përzgjodhën edhe fituesin. “Poezia e luleve” –Konkurs i cili kishte të bënte me krijimin e Poezisë Gegë, kushtuar luleve. Këtu morën pjesë 22 poetë të rinj dhe të afirmuar.“Miss biçikleta”-Shkodra, e cila njihet ndryshe edhe si qyteti i biçikletave, e ka në traditën e saj përdorimin në masë të gjërë të këtij mjeti lëvizës. Për këtë arsye, organizatorët disa ditë para zhvillimit të aktivitetit shpallën edhe konkurimin për biçikletën e zbukuruar më bukur me lule të freskëta.“Koncerti i Luleve” – U zhvillua në skenën qëndrore të “Festës së Luleve”në sheshin para Bashkisë Shkodër , filloi në orën 20:00. Në këtë koncert ishin të ftuar emra të njohur të skenës,si dhe grupe dhe solistë të rinj.Repertori i përzgjedhur nga artistët ishte në harmoni të plotë me tematikën e ditës.

P11.F2.O2.A2: “Ndërmendje 2017”

“Ndërmendje 2017”, organizuar nga Bashkia Shkodër dhe Fondacioni “Arte”, i shpallur fitues nga Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër, i cili është zhvilluar me datën 28 dhjetor 2017 në sallën e Teatrit “Migjeni” Shkodër.Projekti që Fondacioni “Arte” solli në qytetin e Shkodrës një aktivitet me një cilësi të lartë artistike. Me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike të Radio Televizionit Shqiptar. E veçanta e këtij viti ishte përzgjedhja e solistëve, të cilët i kishin munguar qytetit të tyre të lindjes prej shumë vitesh:FRANO LUFI – Këngëtar lirik (bas) ka lindur në Shkodër. HAJREDIN HOXHA – Violonçelist - i lindur në Shkodër. ELVIN HOXHA GANIYEV – Violinist i rangut të parë ndërkombëtar. Babai i tij është violonçelisti i njohur shkodran Hajredin Hoxha. ARMANDO LIKAJ – Bas/Bariton i njohur, lindur në Shkodër.“Ndërmendje 2017” arriti të ruajë traditën e zhvillimit të një koncerti me karakter klasik në fund të vitit. Koncerti në aspektin artistik pati shumë sukses tek publiku i pranishëm në sallë. Media-partner i këtij aktiviteti ishte Radio Televizioni Shqiptar. Koncerti u pasqyrua edhe në media kombëtare dhe lokale, të shkruara dhe vizive.

P11.F2.O2.A3: Fjala artistike me nxenesit e shkollave te mesme ne nderim te figurave te shquara.

Aktiviteti “ Fjala artistike me nxenesit e shkollave te mesme“ ka filluar ne muajin Mars 2017 dhe ka mbaruar ne Nentor 2017, duke perfshire pothuaj te gjithe shkollat e mesme te qytetit te Shkodres.

Ky aktivitet ka si qellim jo vetem perkujtimin e figurave te shquara shqiptare por edhe evidentimin e brezit te ri te aktoreve dhe nxitjen e nxenesve qe ne moshe te re te marrin pjese ne aktivitetet e Teatrit “ Migjeni”.

P11.F2.O2.A4 : Aktivitete me rastin e 2 Prillit

“2 prilli” është një aktivitet përkujtimor, I cili organizohet çdo vit nga Bashkia Shkodër, në përkujtim të 4 Dëshmorëve të Demokracisë, Arben Broci, Bujar Bishanaku, Besnik Ceka dhe Nazmi Kryeziu. Aktiviteti këtë vit filloi në orën 10:00 në sheshin para Memorialit “2 prilli” me vendosjen e kurorave nga të pranishmit pranë këtij memoriali, për të vazhduar më pas me aktivitetin përkujtimor artistik të zhvilluar ne hollin e Bashkise Shkoder.

P11.F2.O2.A5: “Festival Jazz”

“Festival Jazz-it” projekt i titulluar “Shkodra Jazz Festival” nga subjekti fitues, u zhvillua në datat 17 – 22 korrik 2017.Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër, Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj” dhe “Optional Music International”.Media partner i këtij aktiviteti ishte Televizioni Publik Shqiptar. Data 17-22 korrik 2017- Në ambjentet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, Shkodër u bë prezantimi i projektit më të ri të integruar në “Shkodra Jazz Festival”, “Rrok Academy”. “Rrok Academy” ka të bëjë me kurse të avancuara për muzikantë, dhe ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën jazz, përmes leksioneve intensive të drejtuara nga profesionistë të fushës.Morën pjesë rreth 35 nxënës dhe studentë nga vende të ndryshme.Datë 20 korrik 2017 – “Shkodra Jazz Festival”, Koncert në sheshin para Bashkisë Shkodër me grupet e ftuara jazz. Në këtë natë performuan: Grupi “The Dream”,Kamela Islamaj, e shoqëruar nga Markelian Kapidani, Di Battista Fasano Duo; Ora: 22:30 D.J. Set në sheshin para Bashkisë Shkodër.Datë 21 korrik 2017 – “Shkodra Jazz Festival”, Koncert në sheshin “Nënë Tereza” me grupet e ftuara jazz. Në këtë natë performuan: “One man shoë” – Gigi Biolcati, Nico di Battista - Trio, duke vijuar më pas me “Jam Session” në Restorant “Tradita”. Datë 22 korrik 2017 – “Shkodra Jazz Festival”, Koncert në sheshin para Bashkisë Shkodër me grupet e ftuara jazz. Në këtë natë performuan: Markelian Kapidani“Euphonia Jazz Group”, Sokol Prekalori, Nico di Battista, Gigi Biolcati, Davide Liberti, Gaetano Fasano; Më pas “Jam Session” në Bar “Millenium”, ku performuan të gjithë grupet e ftuara.

P11.F2.O2.A6: “Karnavale 2017”

“Karnavale 2017”, u zhvilluan në datat 8-9-10-11 shkurt 2017 prane muzeut Oso Kuka, në sheshin para Bashkisë Shkodër dhe në sheshin “Nënë Tereza”. Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata Kulturore Teatrore “Zef Jubani”. Data 08.02.2017 – E titulluar “Dita e bijave”,tradita e kësaj dite, është e hershme në qytetin e Shkodrës dhe konsiston në “kthimin e bijave në gjini”, të cilat priten në familje me petulla dhe pije të ëmbla,Në këtë kontekst, shoqata kishte ndërtuar një panoramë të kësaj tradite përmes shërbimit të petullave për gratë dhe vajzat prezente në këtë aktivitet.Data 09.02.2017 – Kjo ditë ishte një paradë karnavaleske mes shkollave të sistemit arsimor 9 vjeçar. Në këtë ditë morën pjesë 19 shkolla të Bashkisë Shkodër, nga të cilat u përzgjodhen tre prej tyre për të marrë pjesë në ditën finale të Karnavaleve.Data 11.02.2017 – Festa e Karnavaleve. Ky aktivitet filloi në orën 10:00 me nisjen e karvanit shëtitës karnavalesk nga qendra e shoqërisë “Illyricum” në Gjuhadol për të përshkuar më pas pedonalen “Kolë Idromeno”, lagjen Gjuhadol, Sarreq, sheshi “Isa Boletini”, Parrucë, pedonale “13 dhjetori” për të përfunduar në ndalesën e fundit në sheshin “Nënë Tereza” ku edhe u mbajt festa kryesore e Karnavaleve.

P11.F2.O2.A7: Koncertet e verës

“Koncertet e verës”u zhvilluan në muajin Korrik – Gusht në gjashtë të marta rresht, konkretisht në datat: 11-18-25 Korrik 2017 dhe 1-8-15 Gusht 2017, në pika të ndryshme të Bashkisë Shkodër. Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe “Kuju Studio” .

Në datën 11 Korrik 2017 u mbajt koncerti i parë, në sheshin “NënëTereza” me pjesëmarrjen Grupit muzikor “NA”. Repertori i zgjedhur, rreth 20 këngë, Shqiptare dhe të huaja ishte i zhanrrit Rock dhe Pop.

Koncerti i dytë (18 Korrik 2017)

Nëdatën 18 Korrik 2017 u mbajt koncerti i dytë i “Koncerteve të verës” në Gjuhadol, pranë Bulldog Hostel & Club, I ftuar në këtë koncert ishte Gjergj Kaçinari. Repertori iz gjedhur nga “Katchinari” për të performuar në këtë koncert ishte i zhanrrit Rock, Pop dhe muzike shqiptare.

Koncerti i tretë (25 Korrik 2017)

Nata e tretë, të ftuar ishin grupi më i ri muzikor nga Shkodra ”Brios”. Vendi që u zgjodh për tu zhvilluar ky koncert ishte ish-Lapidari. Në repertorin tyre pati muzikë të huaj dhe shqiptare.

Koncerti i katërt (1 Gusht 2017)

Koncerti i katërt i koncerteve të verës u mbajt në sheshin“ Nënë Tereza” të ftuar ishin Jozefina Simoni and Band. Repertori i përzgjedhur nga grupi muzikor ishte i larmishëm, ku u kënduan rryma të ndryshme si Rock, Pop, Rock and Roll, muzike Latine etj.

Koncerti i pestë (8 Gusht 2017)

Në datën e pestë të koncerteve të verës ishte i ftuar Kuarteti “Pasion”. Ky kuartet klarinetash është një formacion i përbërë nga 4 instrumentistë profesionistë.

Koncerti i gjashtë (15 Gusht 2017)

Në natën e fundit të koncerteve të verës të ftuar ishin grupi “Revolt Klan”. Koncerti u zhvillua në plazhin e Velipojës, tek shëtitorja. Repertori i zgjedhur nga grupi “Revolt Klan” ishte rreth 17 këngë të zhanreve të ndryshme si Pop, Folk, R & B etj.

P11.F2.O2.A8: Aktivitetet e fundvitit

Bashkia Shkodër , në vitet e fundit,për festat e fundvitit ka organizuar një treg artistik, festiv, dëfryes. Në qendër të qytetit vendosen disa shtëpiza të vogla druri të cilat ofrojnë shërbime dhe atraksione të ndryshme artistiko-kulturore për qytetarët dhe turistët që zgjedhin qytetin tonë për të kaluar festat e fundvitit.

Duke parë eksperiencën e mirë të viteve të shkuara, Bashkia Shkodër ka vendosur t’a kthejë në traditë të përvitshme këtë projekt i cili i jep kaq shumë gjalleri qytetit tone, duke ndryshuar rutinen e ditëve të zakonshme. Gjatë ketij muaji organizohen minikoncerte, performancave të grupeve të ndryshme muzikore, kërcimtarë, animatorë, hapësira argëtimi për femijë, duke e kthyer qendrën e qytetit në një vend të vertetë argëtimi.

Te rinjtë e qytetit po ashtu edhe profesionistet kanë mundesi të bëhen pjesë e këtij projekti.

Eksperienca ka treguar që ky aktivitet i shërben jo vetëm pasurimit të jetës kulturore në fundvit, por edhe nxitjes së bizneseve të jenë pjesë e këtij projekti, përmes shërbimit të shpejtë që mund të ofrohet gjatë një muaji në shtëpizat prej druri.

Gjithashtu ky projekt nxit dhe zhvillon turizmin në territorin e Bashkisë Shkodër.

P11.F2.O2.A9 : Festa e Muzikes

Çdo vit është organizuar një koncert me muzike klasike per te sensibilizuar rinine me vlerat e padiskutueshme të muzikës ne edukimin e njerezve. Aktiviteti u zhvillua nga shoqata artstike Vox Baroque e cila e dha performancen e saj ne Muzeun e Kalase qe qe solli emocione tevecanta e te bukura tek spektatoret e ketij aktiviteti.Ky koncert u realizua me nje cilesi te lartë artistike, dhe u vleresua se tepermi nga komuniteti dashamires shkodran i artit barok si dhe turisteve.

P11.F2.O2.A10: Opera e Skenderbeut Prenk Jakova

Kjo fishe konsiston në propozime të ndryshme që vijnë në Bashkinë Shkodër nga subjekte të ndryshme kulturore, apo nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këtë vit kjo fishe buxheti, u realizua përmes Teatrit Kombetar te Operas dhe Baletit.Viti 2017 eshte shpallur nga Ministria e Kultures si viti i Prenke Jakoves, kompozitor i shquar dhe themeluesi i gjinisë së operas kombëtare shqiptare, ne perkujtim te 100 vjetorit te Tij te lindjes. Bashkia Shkoder, ne nderim te ketij artisti te madh, ka ftuar Teatrin Kombetar i Operas dhe i Baletit (TKOB) te shfaqë prane Teatrit Migjeni operan “Skenderbeu”

Muzika e Prenkë Jakovës tingllon me gjithë pasion dhe inteligjencë, e bazuar mbi një teknikë kompozimi madhështore të asaj Opere për konceptin modern të së cilës duhet të kemi respekt. Me një zë të fuqishëm, ekspresiv dhe stilin e tij personal, Prenka i dha popullit dhe vendit të tij një vepër të madhe.

Opera Skënderbeu mbetet një vepër madhështore jo vetëm për nga muzika e pasur por edhe orkestracioni i përsosur, për nga rolet, personazhet dhe karakteri i saj madhështor.Në këtë mënyrë TOB Tiranë ne bashkepunim me Bashkine Shkoder realizoi kete shfaqje prane Teatrit Migjeni me date 27 Qershor 2017 , date qe perkon me perkujtimin e 100 vjetorin e ditelindjes te ketij kompozitori te shquar.

P11.F2.O2.A11: Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik

Gjate 2017 Këshilli Artistiko Kulturor i Bashkise Shkoder i përbëre prej 7 anëtarësh funksionoi rregullisht. Ai mori në shqyrtim në bazë të një proçedure të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shkodër te reflektuar ne 15 vendime te tij ne lidhje me zhvillimin e ketyre eventeve per 2017.

P11.F2.O2.A12: Lëvizja e Postribës

"Lëvizja e Postribës" e njohur si lëvizje antikomuniste në Shqipëri, e ndodhur më 9 shtator 1946, ishte lëvizja e atyre që nuk besuan kurrë tek komunizmi internacionalist shqiptar. Qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, të cilët patën vetëdijen dhe e parashikuan se komunizmi do të sillte vetëm regres në vendin tonë, u ngritën kundër forcës së madhe të diktatorit më të egër që njohu Europa..

Bashkia Shkodër e përkujton çdo vit datën 9 shtator dhe këtë vit përveç ceremonialit zyrtar, organizoj një konferencë shkencore mbi "Lëvizjen e Postribës". Pjesëmarrës në konferencë ishin studiues dhe historian,të cilët mbajtën kumtesa ku mund të përmendim: Hamza Kazazi, Agron Tufa, Uran Butka, Marsel Nilaj gjitashtu kishim rreth 150 pjesmares ne konference dhe vizitues te ekspozites se organizuar me kete rast. Ne fund te ketij eventi u organizua nje pritje e thjeshte ku njerez te ndryshem u takuan e mikpriten lektoret e mesiperm. Ne kete takim doli e nevojshme qe te gjitha materialet e mesiperme te permblidhen ne nje publikim te Muzeut te Deshmise e Kujteses.

P11.F2.O2.A13: Koncert – Muzike e filmit shqiptar – orkestra frymore e qytetit te Shkodres.

Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore"Pjetër Gaci", ditën e martë, dt. 28.11.2017 ora 18:00, në Teatrin "Migjeni", organizuan koncert festiv me pjesëmarrjen e Orkestrës Frymore të qytetit me rastin e festive të nëntorit.Në këtë aktivitet ishin artistët pjesëmarrës:Dirigjent: Kujtim Alia (Mjeshtër i Madh)SOLISTË: Bujar Qamili (Mjeshtër i Madh), Mukades Çanga (Mjeshtër i Madh), Rrezarta Smaja, Brikeno Burgia, Anton Guri, Xhuliana Pjetraj, Riad Bashi dhe Eugjen Marku.Të ftuar pjesëmarrës ishin: Xhovana Marku (Oboe) Fituese e çmimit special"P.Gaci" 2017, Dorina Saraçi (Piano), Juri Dajani (Violin) dhe Rina Lami (Piano).Veçanti ishte përshendetja e aktivitetit nga grupi i famshëm, i rikthyer "Karajfilat që ka Shkodra".Ky aktivitet pati spektatorë të shumtë dhe personalitete të artit, kulturës dhe politikës.

P11.F2.O2.A14: Çmimi "Pjetër Gaci", Edicioni 16-të

Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore"Pjetër Gaci", me datë 29 prill 2017 mbyllën Edicioni in e 16-të të Çmimit "Pjetër Gaci", i zhvilluar gjatë katër ditëve në Teatrin "Migjeni".

Në këtë edicion morën pjesë 132 konkurentë nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e më gjërë, të cilët konkuruan në katër disiplina muzikore: Piano, Harqe, Kanto dhe për herë të parë edhe në disiplinën e Instrumentave Frymorë. Nga audicionet e zhvilluara në tre ditë, 26-27-28 prill 2017,u shpallën 19 fitues nga të gjitha disiplinat, të cilët konkuruan në natën finale për Çmimin "Pjetër Gaci". Këtë vit, në kuadër të 100 vjetorit të lindjes së Prenkë Jakovës, kompozitorit të Operas

së parë shqiptare “Mrika”, u dha çmimi për interpretuesin më të mirë të një vepre lirike të kompozitorit, të cilin e fitoi basi Eugjen Marku, nxënës në shkollën e mesme artistike “Prenkë Jakova”, Shkodër. Çmimin special “Pjetër Gaci” e fitoi studentja e Universitetit të Arteve, Tiranë, Xhovana Marku, e disiplinës së Frymës, e cila luajti në Oboe Koncert - Hayden. Juria e këtij viti ishte e përbërë nga personalitete të disiplinave të ndryshme muzikore: Për disiplinën e Kantos: 1. Josif Gjipali – Tenor me karrierë ndërkombëtare. 2. Frano Lufi – Bas, me karrierë ndërkombëtare. 3. Marjana Leka – Soprano në Teatrin e Operas dhe Baletit. Pedagoge në Universitetin e Arteve.

Për disiplinën e Pianos: 1. Vladimir Milosevic – Pianist. Pedagog në Universitetin e Arteve, Beograd 2. Kristina Laço – Pianiste. Pedagoge në Universitetin e Arteve, Tiranë. Zëvendës dekane e muzikës; 3. Daniela Dikova – Pianiste. Pedagoge në Universitetin e Arteve në Sofie të Bullgarisë.

Për disiplinën e Harqeve: 1. Hajredin Hoxha – Violonçelist. Pedagog në Universitetin e Arteve në Ankara dhe Koncert-maestër I sektorit të violoncelëve në orkestrën simfonike të Ankarasë; 2. Sihana Badivuku – Violiniste. Pedagoge në Universitetin e Prishtinës; 3. Xhoan Shkreli – Violinist në Teatrin “La Fenice” në Venezia, Itali. Për disiplinën e Instrumentave Frymorë: 1. Venera Kajtazi-Mehmetagaj – Flautiste. Pedagoge në Universitetin e Prishtinës; 2. Sokol Toto – Klarinetist. Drejtor Artistik I orkestrës së Radio Televizionit Shqiptar. 3. Sokol Marku – Trombonist. Mësues në shkollën e mesme artistike “Prenkë Jakova”, Shkodër. Aktiviteti pati interesim të madh nga artdashësit e shumtë.

P11.F2.O2.A15: “Ahengu Shkodran”

Pjesë e traditës së këngës popullore shkodrane është dhe Ahengu Shkodran, i cili me të drejtë është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, organizohet aktiviteti tradicional “Ahengu Shkodran”. Vitin që kaloi në kuadër të këtij aktiviteti iu bashku edhe Qenda Kulturore Veprimtarive Folklorike si dhe Ministria e Kulturës. Me 28 shtator u organizua tryeza e diskutimeve mbi historinë dhe traditën e “Ahengu Shkodran”, ku të ftuar ishin Zef Çoba, Ridvan Karakaçi, Ferid Bala, Arben Prendi. Konferenca u mbajt në ambjentet e muzeut historik banesa “Oso Kuka”, ndërsa aktiviteti u zhvillua në teatrin Migjeni me datë 29 shtator, ku morën pjesë edhe artista nga Kosova, Mali i Zi.Aktivitetika një ndjeshmëri të lartë artistike për qytetin. Aty janë të përfshirë forcat më të mira krijuese dhe interpretuese të kësaj trashëgimie. Vihet re që vitet e fundit në ambjentet festive familjare të qytetit ka devijime të shijeve muzikore,ndaj ky aktivitet ka një kontribut të rëndësishëm në kultivimin e muzikës qytetare, sidomos për edukimin e brezit të ri.

P11.F2.O2.A16:“Honorare " Grupi i Valleve”

Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesëmarrësish dhe drejtuesish të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë. Eshte viti i dyte qe me mbështetjen financiare të Bashkisë Shkodër, pranë Qendrës kulturore “Pjetër Gaci” funksionon Grupi i Valleve. Ky grup mori pjesë në shumicën e aktiviteteve që organizojnë institucionet e kulturës të Bashkisë Shkodër. Ai përbëhet prej 12 personash, të cilët trajtohen me honorare për 10 muaj.

P11.F2.O2.A17: Festivali i Këngës Qytetare, me krijimtari të re Lule Borë.

Bashkia Shkodër organizoi për të dytin vit me radhë, pas 27 viteve mungesë, Festivalin e Këngës Qytetare “Luleborë”.

Drejtor Artistik i këtij viti ishte muzikanti shkodran, Markelian Kapidani

Dirigjenti Jetmir Barbullushi, u bë pjesë e stafit të Festivalit edhe si dirigjent ashtu dhe si regjizor.Orkestra “Luleborë”, u drejtua nga spala, Sokol Prekalori.

Këngët finaliste për tre netët e festivalit, ishin 22. Festivali u mbajt në Teatrin “Migjeni” në datat 13-14-15 nëntor 2017.

*Në këtë festival u ndanë 4 çmime:*

Çmimi i parë – "Me ty u rrit kanga shkodrane" kompozuar nga Edmond Zhulali, tekst të Agim Doçit, kënduar nga Mifarete Vekshari ( Laze) ;
Çmimi i dytë – "Vajza shkodrane", muzika: Enrik Çefa, teksti Denisa Domnori, kënduar nga Lidia Young;
Çmimi i tretë–"Petalet si kunorë", muzika Oleg Gjerga, teksti: Alfred Çapaliku,kënduar nga Blerta Cina dhe kompleksi "Karajfilat që ka Shkodra".
Juria dha edhe një çmim inkurajues, i cili shkoi për këngëtaren e re Artemisa Mithi, e cila këndoi këngën "Lulja e dashtun" të kompozitorit Enis Mulla.
Stafi i Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit u mor me çdo detaj organizativ.
Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë", pati jehonë në median e shkruar dhe vizive.
P11.F2.O2.A18: Orkestra frymore honorare vjetore
Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unikale që ka qyteti ynë.Fillesat e saj datojnënë vitin 1876.Ky formacion ka realizuar aktivitete të shumta duke filluar nga koncerte-recitale, koncerte me rastin e festave kombëtare, parakalime në qytet, inagurime të ndryshme, përkujtime të figurave historike, pjesëmarrje në aktivitete jashtë vendit etj. Prandaj ky formacion duhet të mbrohet dhe të mbështetet ashtu siç i takon. Bashkia Shkodër çdo vit e ka financuar rregullisht për 11-të muaj të vitit, por edhe duke i siguruar realizimin e aktiviteteve të shumta. Orkestra Frymore e qytetit duhet të vazhdojë të financohet edhe për vitin 2017 me të njëjtat honorare dhe kushte që ka aktualisht.
P11.F2.O2.A19: Koncert premiere i orkestes frymore:
Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore"Pjetër Gaci",", ditën e enjte, dt. 13.04.2017,ora 19:00, në pedonalen "Kole Idromeno", organizuan koncert festiv me pjesëmarrjen e Orkestrës Frymore të qytetit.Në këtë aktivitet ishin artistët pjesëmarrës:Dirigjent: Kujtim Alia (Mjeshtër i Madh) soliste: Mukades Çanga (Mjeshtër i Madh), Blerta Cina, Ilsi Ademi, Leonard Guga,Riad Bashi dhe Marjana Begu.
Performanca e ketij koncerti ne ambjente te hapura u pelqye shume nga publiku duke kerkuar dhe shfaqje te tjera te ketij lloji.
P11.F2.O2.A23: Riparime dhe blerje e instrumenteve muzikore tek Qendres "Pjeter Gaci"
Në Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" ishte e rëndësishme që të investohej në blerje dhe riparime të instrumentave muzikorë, për një paraqitje sa më të mirë të formacioneve artistike, dhe të plotësimit të mungesave të këtyre instrumenteve, ose të zëvendësohen për arsye të konsumimit.
Prandaj ne e realizuam këtë projekt, me blerjet dhe riparimet e instrumentave duke i qendruar specifikimeve të kërkuara që i kemi përmendur më poshtë.Blerje Komplet legjio portative(support) – (40 cope). - Te jene cilesore dhe te pershtateshme per çdo instrument te orkestres frymore.Blerje Daulle - (1 cope). Blerje Dajre – (1 cope). - Të jenë sa më afër origjinalitetit popullor në paraqitje dhe në tingëllim.Riparime:Riparim, Firzamonikë e kuqe. – (1 cope) - Riparim i rregjistrave që ndryshojnë timbret e tingujve.Zëvendësim i fryesave të dëmtuar. Pastrim i përgjithëshëm.Riparim, Firzamonikë e zezë CANTOS 5. - (1 cope) - Rregjistrim i rregjistrave që ndryshojnë timbret e tingujve. Pastrim i përgjithëshëm. Rregjistrim i sistemit të basaveRiparim, Sharki. – (1 cope) - Riparim i kupës së sharkisë. Nivelim i bishtit dhe akordim i rregullit. Zëvendësim i telave dhe i çelësave.Riparim, Qifteli tip sharki. – (4 cope) - Riparim i pjesëve të dëmtuara. Zëvendësim i telave dhe i çelësave. Pastrim i përgjithëshëm dhe llakosje.Riparim, Kontrabas popullore. – (3 cope) - Riparim i pjesëve të dëmtuara. Zëvendësim i telave dhe i çelësave. Pastrim i përgjithëshëm dhe llakosje.Riparim, Grankasa. – (1 cope) - Zëvendësim i lëkurave të dëmtuara. Plotësimi me çelësa ku mungojnë.
P11.F2.O2.A24: "Nje zjarrfikes ne oborrin e teatrit"

Muaji Shkurt eshte hapur me shfaqjen “ Nje zjarrfikes ne oborrin e Teatrit “ , shfaqje Premiere e cila ka patur naten e hapjes me dt 26.02.2017 dhe eshte shfaqur per 7 here nga ku , 4 here ne Teatrin “ Migjeni “ Shkoder, 2 here ne Festivalin Ballkanik ne Bursa, Turqi dhe nje here ne festivalin nderkombetar te teatrove ne Butrint.

P11.F2.O2.A25: “Hidrocentrali ne thatesiren e poshteme”

Ne muajin Shtator eshte vene ne skene shfaqja “Hidrocentrali ne thatesiren e poshtme “ me regjizor Kushtrim Bekteshi , shfaqje premiere shume e suksesshme e cila eshte shfaqur 9 here nga te cilat Premiera ne Teatrin “ Migjeni “ me dt 15.09.2017 tre nete rresht si dhe festivale kombetare dhe mbarekombetare ne Teatrin Kombetar Tirane 2 here, ne Ferizaj, ne Presheve , ne Prizren dhe ne Korçe. Kjo shfaqje eshte vleresuar me 5 çmime , nga te cilat Shfaqja me e mire, Regjisori me i mire , 2 çmime aktori me i mire dhe kostumografia me e mire.

P11.F2.O2.A26: Se tane puna asht te hunda

Monodrama “ Se tan puna asht te hunda “ eshte shfaqja permbyllese e Teatrit Migjeni per vitin 2017 , shfaqje Premiere e cila eshte vene ne skene per nje nate dhe ka mbyllur keshtu nje vit mjaft te sukseshem te Teatrit “ Migjeni.

P11.F2.O2.A27: Show 2017

Show 2017 “ Lumturi ne fukarallek “ eshte vene ne skene per here te pare ne muajin Dhjetor dhe eshte shfaqur per 9 nete rresht duke u pritur shume mire nga rreth 3000 spektatore.

P11.F2.O2.A29: Pranvere me kange.

Ne muajin Mars eshte vene ne skene koncerti “ Prandevere me Kange “, aktivitet i pervitshem i cili eshte vene ne skene me dt. 24.03.2017 dhe eshte shfaqur per dy nete rresht.

P11.F2.O2.A30: Shfaqje per femije Piter Pan

Ne muajin Maj eshte vene ne skene premiera per femije “ Piter Pan “ , shfaqje e cila ka qene shume e suksesshme dhe eshte shfaqur per 17 dite rresht ne Teatrin “ Migjeni “. Kjo shfaqje eshte shikuar nga rreth 5000 spektator , te gjithe nen moshen 14 – Vjeç.

P11.F2.O2.A31: Teater kukullash

Po ne muajin Shtator eshte vene ne skene Teatri i Kukullave “ Datelindja e Lulushes” risi kjo e kthyer ne Teatrin “ Migjeni “ pas shume vitesh dhe ka kenaqur spektatorin e vogel per 9 dite rrjesht , dhe eshte shikuar nga 1100 femije.

P11.F2.O2.A 32: “Maratona e Këngës Popullore”

“Maratona e Këngës” është një event kulturor që organizohet çdo vit nga Shoqata Artistike “QZHK, Sot për të Ardhmen”, në bashkëpunim me Televizionin Kombëtar Klan. Ky aktivitet është një nga ngjarjet më të rëndësishme të muzikës moderne shqiptare, i cili zhvillohet në pikun e sezonit turistik në qytete të ndryshme të Shqipërisë. “Maratona e Këngës” sjell tek publiku artistët më të suksesshëm të momentit dhe hitet e tyre, gjithashtu kontribuon në promovimin e turizmit shqiptar, përmes transmetimit të plotë të aktivitetit dhe videove promocionale të qytetit përkatës.

P11.F3.O1.A2: Feste per 100 vjetor te i krijimit e bibliotekes popullore te Shqiperise.

Eshte organizuar një seminar shkencor titulluar :”100- vjet biblijotekë popullore shqiptare” pranë bibliotekës “Marin Barleti” mbi fakte historike të cilat vërtetojnë jetëgjatësinë dhe identitetin e Bibliotekës “Marin Barleti”. Lektoret e ftuar ne kete konference ishin: Dr. Arben Prendi, Dr. Gezim Puka, Olimpia Kakarriqi dhe Ermira Alija.

P11.F3.O1.A3 : Periodiku gegnisht

Kjo revistë ka karakter kulturor dhe përfshin një gamë të gjërë artikujsh që kanë lidhje me gjuhën, letërsinë, artin, albanologjinë, historinë etj. Promovimi i kësaj reviste pati jehonë pozitive dhe

interesi për të ishte i lartë. Revista "Gegnia" ka arritur ne numrin e katert te saj, i regjistruar me ISSN përkatëse, me orientim kulturor dhe është e hapur për të gjithë shkrimtarët e rinj dhe profesionistë.
P11.F3.O1.A4: Festivali letrar i Shkodrës
Përveç punës kërkimore shkencore që Biblioteka "Marin Barleti" ka në punën e saj të përditshme, ajo gjatë gjithë vitit organizon edhe veprimtari kulturore që kanë ndikim tek publiku. "Festivali letrar i Shkodrës" zhvilloi edicionin e dhjetë të tij këtë vit. Ky festival, i konceptuar si një forum letrar, i dedikohet kryesisht shkrimtarëve shkodranë që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por gjithashtu synimi i këtij festivali është edhe të jetë një urë lidhëse me shhkrimtarë të hapësirave shqiptare.
Këtë vit festivali u zhvillua i ndarë në pesë takime me shkrimtarë të ndryshëm dhe target grupe të ndryshme.
P11.F3.O2.A1: Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës
Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin e nevojavë për edukim dhe çlodhje të komunitetit.
Bashkia Shkodër çdo vit mbështet Bibliotekën "Marin Barleti" në pasurimin e fondeve të saj. Edhe këtë vit Biblioteka "Marin Barleti" shtoi numrin e fondeve të saj, në letërsi të huaj, në fondin për fëmijë, fondin e autorëve shqiptar, albanologji dhe fondin e gjuhëve të huaja.
P11.F3.O2.A2: Administimi dhe menaxhimi i Deges ekonomike te kultures:
Dega Ekonomike e Kulturës ka strukturën e mëposhtme prej 32 punonjesish ku jane paguar Paga dhe Sigurimet Shoqërore per punonjesit e meposhtem: ne Biblotekën Publike "Marin Barleti" 14 punonjës; Sektori i Librit dhe Mediatikes 8 punonjës, Muzeu Historik 6 punonjës;Qendra e Kultures "Pjeter Gaci" dhe Galeria e Arteve 4 punonjës, si dhe gjithashtu jane mbuluar shpenzime per sherbim nga te trete;materiale kancelarie;materiale te ndryshme mirembajtje;siguracion ndërtese; rimbushje fikse zjarri,sistem kondicionimi dhe kondicionere;eshte realizuar dhe mirëmbajtja e 5 webpage dhe i faqes O-PAC.

## III. Fondet e financimit te programit:

Fondet e miratuara për këtë program jane 90 761 mije lekë dhe realizimi për periudhën 12 mujore është 73 577 mije lekë, në masën 81% .
Fondet për shpenzimet korrente sipas planit 2017 janë:

- Paga e sigurime janë realizuar në masën 37 445 mijelekë nga 45 918 mije lekë që ka qene e parashikuar. Realizimi në masën 82%.
- Shpenzime operative janë realizuar në masën 24 062 mijelekë nga 31 078 mijelekë që ka qene e parashikuar. Realizimi në masën 77.4%.
- Transferta janë realizuar në masën 4,260 mije lekë nga 4 260 mijelekë parashikuar. Realizmi në masën 100%.
- Investimet janë realizuar në masën 7 810 mije lekë nga 9 505 mije lekë të parashikuara. Realizimi në masën 82%.

Sipas kërkesës të Drejtorise se Kultures, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me vendim nr prot 160 date 23.05.2017, u pakesua fondi prej 200 000 leke tek fishprojekti Ndermendje dhe u shtua fondi i fishprojekti Festival Jazz .
Sipas kërkesës të Teatrit Migjeni, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me vendim nr prot 163 date 29.05..2017 eshte eshte pakesuar fondi prej 1 000 000 leke tek fishprojekti Zinxhiri i keqkuptimeve

dhe ai eshte ndare ne dy fishprojekte : Projekti Piter Pan – 700 000 leke dhe projekti Teater kukullash 300 000 leke.

Sipas kërkesës të Teatrit Migjeni, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me vendim nr prot 162 date 29.05.2017 u pakesua fondi prej 1 000 000 leke fishprojekti Aktivitete te ndryshme gjate vitit dhe u shtua ne shpenzime operative, Art 602, Opera Skenderbeu – Prenke Jakova.

Sipas kerkeses se Qendres kulturore Pjeter Gaci, te miratuar nga Kryetarja e Bashkise me vendim nr prot 301 date 11.08.2017 eshte pakesuar fondi prej 320 000 leke brenda programit 8250, Art 602, shpenzime operative dhe eshte shtuar tek programi 8250, Art 602, shpenzime operative "Maratona e Kengs Popullore"

Sipas kërkesës të Teatrit Migjeni, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me vendim nr prot 335 date 13.09.2017, kemi patur pakesim nga zeri shpenzime korrente-shpenzime per paga, Art 600 dhe shtese ne zerin shpenzime korrente-shpenzime operative, Art 602, shtese per shpenzime per veshje tek "Hidrocentrali ne thatesiren e poshtme" me shumen 350 000 leke.

- **Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017**.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Plani i korigjuar | Realizimi 2017 në mijë lekë |
|---|---|---|---|
| P11.F1.O1 .A1 "Java e Pavaresise" Ekspozitë etnografike me elemente kostumografie dhe zejesh | 30 | 30 | 24.2 |
| P11.F1.O1.A2 Prodhim dhe Shtypje Biletash | 150 | 150 | 120 |
| P11.F1.O1.A3 Dita nderkombetare e monumenteve dhe siteve arkeologjike | 100 | 100 | 0 |
| P11.F1.O1.A4 Mbeshtetje per funksionimin e aktivitetit dhe sherbimin ne vazhdim te Muzeut historik Shkoder | 410 | 410 | 319.42 |
| P11.F1.O1.A5 Ribotim i guides te Muzeve te Bashkise Shkoder | 300 | 300 | 205.8 |
| P11.F1.O1.A6 Risistemim i ekspozimit te objekteve te gurta ne Muze "Oso Kuka" | 150 | 150 | 116.16 |
| P11.F1.O1.A7 Rikonstruksion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër. | 1,000 | 1,000 | 0 |
| P11.F1.O1.A8 Publikime promocionale, fletepalosje e guide per Vendin e Deshmise e Kujteses | 150 | 150 | 126.4 |
| P11.F1.O1.A9 Cikel bisedash dhe ndergjegjesim i te rinjve nen fokusin e librave me tematike mbi te kaluaren komuniste. | 70 | 70 | 50 |
| P11.F1.O1.A10 Mirembajtje nderteseses VDK | 300 | 300 | 197.17 |
| P11.F1.O1.A11 Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve. Ekspozita me titull "Edhe ne luanim dikur" | 30 | 30 | 24.2 |
| P11.F1.O1.A12 Ekspozita "Salloni i vjeshtës " | 465 | 465 | 405.87 |
| P11.F1.O1.A13 Çmimi "Idromeno". | 350 | 350 | 342.81 |
| P11.F1.O1.A14 "Personazh i ftuar"- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës. | 140 | 140 | 82.03 |
| P11.F1.O1.A15 Takime e biseda publike mbi artin dhe workshop me artiste te rinj. | 150 | 150 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P11.F1.O1.A16. Aktivitet me partneritet me subjekte kulturore te trete. | 100 | 100 | 0 |
| P11.F2.O1.A1 Një Piano për Qytetin e Artit | 2700 | 2700 | 2367.79 |
| P11.F2.O1.A2 Blerje impiant audio per koncerte. | 0 | 0 | 0 |
| P11.F2.O1.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore | 3,674 | 3,674 | 3517.99 |
| P11.F2.O1.A4 Prodhim dhe shtypje biletash per Teatrin "Migjeni". | 150 | 150 | 149.52 |
| P11.F2.O1.A5 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni" | 24,148 | 23,798 | 19,534.25 |
| P11.F2.O1.A6 Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj. | 1,711 | 1,711 | 1,711 |
| P11.F2.O1.A7 Shërbime administrative për Teatrin "Migjeni" | 603 | 603 | 500.38 |
| P11.F2.O1.A8 Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike. | 1,000 | 1,000 | 957.6 |
| P11.F2.O1.A9 Rregullimi dhe sistemimi i arkives së Teatrit dhe garderobes. | 665 | 665 | 663.6 |
| P11.F2.O1.A10 Rikonstruksion i godines Teatri Migjeni | 0 | 3545 | 3545 |
| P11.F2.O2.A1 "Dita e Luleve" 6 Maj | 500 | 500 | 500 |
| P11.F2.O2.A2 "Ndërmendje" | 1,300 | 1,100 | 1100 |
| P11.F2.O2.A3 Fjala artisitke me nxenesit e shkollave te mesme ne nderim te figurave te shquara. | 300 | 300 | 255 |
| P11.F2.O2.A4 Aktivitete me rastin e "2 Prillit" | 270 | 270 | 266 |
| P11.F2.O2.A5 Festival Jazz-it | 800 | 1000 | 1000 |
| P11.F2.O2.A6 Karnavalet | 560 | 560 | 560 |
| P11.F2.O2.A7 Koncertet e verës | 600 | 600 | 600 |
| P11.F2.O2.A8 Aktivitetet e fundvitit | 300 | 300 | 300 |
| P11.F2.O2.A9 Festa e Muzikës | 200 | 200 | 200 |
| P11.F2.O2.A10 Opera e Skenderbeut Prenk Jakova | 1,000 | 1,000 | 850.68 |
| P11.F2.O2.A11 Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik | 200 | 200 | 153 |
| P11.F2.O2.A12 "Lëvizja e Postribës", aktivitet përkujtimor | 100 | 100 | 79.03 |
| P11.F2.O2.A13 Koncert – muzike e filmit shqiptare - Orkestra Frymore e qytetit të Shkodrës | 300 | 300 | 296.65 |
| P11.F2.O2.A14 Çmimi "Pjetër Gaci", Edicioni 16-të | 1,309 | 1,309 | 1262.32 |
| P11.F2.O2.A15 "Ahengu Shkodran" | 478 | 478 | 461.1 |
| P11.F2.O2.A16 "Honorare "Grupi i Valleve" | 720 | 720 | 720 |
| P11.F2.O2.A17 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë". | 2,500 | 2,500 | 2493.33 |
| P11.F2.O2.A18 Orkestra frymore, honorare vjetore | 3,674 | 3,674 | 100 |
| P11.F2.O2.A19 "Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore" | 234 | 234 | 234 |
| P11.F2.O2.A20 "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare" | 320 | 0 | 0 |
| P11.F2.O2.A21 Festivali i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë | 70 | 70 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P11.F2.O2.A22 Riparimi i Hyrjes se Qendres Pjeter Gaci | 140 | 140 | 0 |
| P11.F2.O2.A23 Riparime dhe blerje instrumenta muzikore tek Qendra Kulturore Pjeter Gaci | 497 | 497 | 209.4 |
| P11.F2.O2.A24 "Nje zjarrfikes ne oborrin e teatrit" | 1,170 | 1,170 | 1,018.81 |
| P11.F2.O2.A25 "Hidrocentrali ne thatesiren e poshtme" | 1400 | 1750 | 1694.27 |
| P11.F2.O2.A26 "Se tane puna asht te hunda" | 350 | 350 | 294.4 |
| P11.F2.O2.A27 "Show 2017" | 800 | 800 | 781.86 |
| P11.F2.O2.A28 "Zinxhiri i keqkuptimeve" | 1,000 | 0 | 0 |
| P11.F2.O2.A29 "Pranvere me kange" | 650 | 650 | 580.75 |
| P11.F2.O2.A30 "Piter Pan" | 0 | 700 | 634.8 |
| P11.F2.O2.A31 Teater Kukullash | 0 | 300 | 299.84 |
| P11.F2.O2.A32 Maratona e kenges | 0 | 320 | 320 |
| P11.F3.O1.A2 Feste per 100 vjetor i krijimit te bibliotekes popullore te Shqiperise. | 108 | 108 | 61.2 |
| P11.F3.O1.A3 Botim Periodiku "Gegnia" e përkohshme kulturore-artistike | 270 | 270 | 216 |
| P11.F3.O1.A4 Festivali letrar i Shkodrës | 50 | 50 | 40 |
| P11.F3.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi I fondit të bibliotekës | 1,000 | 1,000 | 989.4 |
| P11.F3.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi I Degës ekonomike të kulturës | 25,500 | 25,500 | 20,044.43 |
| **Total** | **87,216** | **90,761** | **73,577** |

## IV. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12-mujorin 2017

- Mosrealizimi i fishprojektit dita nderkombetare e monumenteve dhe siteve arkeologjike, projekt i Muzeut Oso Kuka te planifikuar per tu kryer pa u parashikuar sic duhet niveli i ujrave nentoksore si dhe rrezikshmeria e realizimit te tij ne nje nga puset e Kalase. Per shkak te rezikshmerise se larte te zbatimit te tij u hoq dore nga realizimi.
- Rikonstruksion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër nuk eshte realizuar per shkak te kompleksitetit te projektimit te tij dhe pamundesise se hartimit te nje projekti sipas standarteve te duhura.
- Takime e biseda publike mbi artin dhe workshop me artiste te rinj dhe Aktivitet me partneritet me subjekte kulturore te trete kane qene te pamundura per tu realizuar per shkak te mungeses se stafit ne Galerine e Arteve.
- Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare dhe Festivali i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë nuk kane realizuar per 2017 per shkak te realizimit te tyre çdo dy vite nga Ministria e Kultures dhe jo çdo vit.
- Riparimi i Hyrjes se Qendres Pjeter Gaci nuk eshte realizuar si projekt per shkak te nderhyrjeve konstuktive nga ana e nje projekti te ndertimit te nje qendre rinore ne kete ndertese. Sapo te mbaroje ky rikonstruksion, riparimi i hyrjes duhet te kete nje projekt tjeter qe duhet te shkoje ne harmoni me rikonstuksionin qe po kryhet.

**P12 Rinia dhe Sportet**

Programi për rininë ofron shërbime specifike në lidhje me a) Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj., b) Vlerësimin e nevojës për mbështetje të të rinjve; c) Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore; d) Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

Nëpërmjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumësportësh "Vllaznia" dhe Klubi i futbollit "Vllaznia".
Në përbërje të Klubit shumësportësh "Vllaznia" mbështeten ekipet ne disiplina të ndryshme sportive.

Pjesë përbërëse e programit në mbështetje të sportit të futbollit është mbështetja dhe financimi i ekipeve zinxhirë te grupmoshave të ndryshme pjesë e Akademisë së Futbollit "Vllaznia".

## I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjate vitit 2017, për synimet e saj ne zhvillimin e sportit është përqendruar ne këto funksione zhvillimi:

F1.Programet dhe projektet rinore.
F2.Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale,zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhem me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat për secilin funksion janë si më poshtë:

F1.O1.Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësore në zhvillimin e territorit.
F2.O1. Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet
F2.O2 Garantimi i pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit "Vllaznia" në Kampionatet kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore.

## II. Produktet për vitin 2017

Drejtoria e Kulturës, Arsimit Rinise dhe Sportit, gjatë vitit 2017 ka punuar për përmbushjen e funksioneve dhe objektivave të caktuara sa më sipër nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

P12.F1.O1.A1 Dita e vullnetarizmit
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2017 ishte iniciatore për organizimin e disa ditëve të veçanta të vullnetarizmit. Në bashkëpunim me shkollat e qytetit arriti të organizojë disa ditë ku të rinjtë së bashku u angazhuan të ofrojnë punë vullnetare në shërbim të qytetit. Vlen për tu theksuar angazhimi në muajin Dhjetor 2017 për pastrimin e Liqenit të Shkodrës u realizua pastrimi i disa qindra metër katror, duke dhënë kështu një shembull sensibilizimi edhe për qytetarët për një ambient të përbashkët më të pastër. Aktiviteti u krye ne bashkepunim me PNUD ne kuader te projektit ESERE. Të rinj të përfshirë në këto aktivitete numërohen rreth 2300 vetë.

P12.F1.O1.A2 Kampionati I lojërave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka oraganizuar kampionatin e lojërave me dorë mes shkollave të Bashkisë Shkodër në Javën e Pavarësisë. Kampionati u zhvillua në datat 25dhe 26 nëntor mes 6 shkollave, përkatësisht 'Mati Logoreci', 'Ismail Qemali', 'Pjetër Meshkalla', ' Zemra e Krishtit', 'Peter Mahringer' dhe ekipi i para të rejave të SK 'Vllaznia'. Ky kampionat po kthehet në traditë tashmë për qytetin ku përveç angazhimit të të rinjve në fushën e sportit, shërben edhe për evidentimin e talenteve të reja. Në përfundim të aktivitetit ishte shkolla 'Pjetër Meshkalla' e cila doli fituese mes gjashtë ekipeve pjesëmarrëse

P12.F1.O1.A3 Maratona e pavarësisë Ulqin - Shkodër 2017
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit pranë Bashkisë me datën 28 Nëntor 2017, në kuadrin e festimeve të Javës së Pavarësisë, ka organizuar Maratonën e Pavarësisë, me nisje nga Shkodra për në Ulqin, 42 km e gjatë, me pjesëmarrjen e 113 sportistëve maratonistë, nga të cilët 87 meshkuj dhe 26 femra. Në këtë maratonë , në kategorinë meshkuj dolën fitues 3 sportistë përkatësisht në vend të parë Ilia Kellezi, Korcë Shqipëri, në vend të dytë Aleksandar Kiradjev, Shkup Maqedoni, vendi i tretë Igor Jakimovski, Strumicë Maqedoni. Ndërsa në kategorinë e femrave ku vendi i parë ishte Teodora Simovic, Novi Pazar Serbi, vendi I dytë Biljana Kiradzieva, Beograd Serbi, dhe vendi I tretë Qëndresa Ramadani nga Kosova. Vlen të theksohet se këtë vit kishte edhe një risi si Maratona e Fëmijëve 7-15 vjec e cila ishte vetëm 2 kilometrat e parë.
Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Komunën Ulqin dhe Këshillin Kombëtar i Shqiptarëve ne Ulqin. Aktiviteti u ndoq nga mbi 500 qytetarë të mbledhur para sheshit të Bashkisë që ndiqnin dhe programin kulturor me rastin e Festës së Pavarësisë organizuar me këtë rast si dhe sportdashës të ndryshëm që kishin ardhur posaçërisht për të shprehur mbështetjen e tyre për sportistët pjesëmarrës.

P12.F1.O1.A4 Promovimi i lojës së shahut në Shkodër.
Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar.
Sporti i shahut është një nga sportet që ndihmon në zhvillimin pozitiv të aftësive njohëse të fëmijëve dhe nxënësve. Njëkohësisht ndikon në krijimin e besimit në vetvete, rritjen e kujtesës e të menduarit, rritjen e përqendrimit dhe të përmirësimit të rezultateve në mësime tek fëmijët dhe të rinjtë. Gjatë viti 2017 Bashkia Shkodër u angazhuar për të realizuar një aktivitet të madh, gjithëpërfshirës.

P12.F1.O1.A5 Aktivitete sportive në plazhin e Velipojë .
Sektori i Arsimit Rinisë dhe sportit pranë Bashkisë gjatë muajit Gusht 2017 ka mbështetur aktivitete sportive ( beach vollej) ne plazhin e Velipojes, aktivitete që kane kulmuar në datën 20 Gusht, nga ora 08.00- 20.30 , kur është organizuar dhe zhvilluar kampionati i këtij sporti me pjesëmarrjen e 38 sportistëve nga të cilët 14 vajza dhe 24 djem. Nga këto ndeshje rezultuan fitues 8 sportistë nga të cilët 4 sportistë ( 2 vajza e 2 djem) çmim të parë dhe 4 sportistë çmim të dyte ( 2 vajza e 2 djem) .
Ky aktivitet u mbeshtet dhe nga katërshja e arbitrave të cilët dhanë një mbështetje me vlerë në mbarëvajtjen e kampionatit që konsistuan në mbajtjen e ndeshjes, zgjidhjen e kontestimeve të dala

here pas here nga sportistët, mbajtjen e rregullt të pikëve, përcaktimin e skuadrave fituese si në fazën pre eliminatore, eliminatore dhe ne atë finale.
Aktiviteti u ndoq nga 850 pushues ne plazhin e Velipojes si dhe sportdashes te ardhur enkas per kete event. Ato u përfshinë te gjithe në mbështetje të sportisteve dhe skuadrave të ndryshme.

P12.F1.O1.A6 Turneu i tenisit për salla të mbyllura për fëmijë dhe të rinj 2017.
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizoi nga data 21-27 Dhjetor 2017 ne pallatin e sportit "Qazim Dervishi" turneun e tenisit "SHKODRA INDOOR 2017" me pjesmarjen 110 tenisjeresh ne kategori e klube te ndryshme te Prishtines, Gjakoves ,Prizrenit ,Ulqinit ,Tiranes ,Durresit,Shkoders Ndeshjet u ndoqen nga nje numer I kosiderushem tifozesh dhe dashamirsish te tenisit.
Ndeshjet me te spikatura i shin ndeshjet finale te veteraneve ndermjet Tedi Beni-Ardian Bleta dhe ndeshja finale e vajzave U 12 ndermjet Juna Dani -Gresi Bajri

P12.F1.O1.A8 Revista Sportive Vllaznia
Duke vazhduar traditën dhe duke qënë një nga SK me rezultate më të larta në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare, Bashkia Shkodër në projektet e saj për 2017 pati edhe Revistën e parë sportive “Vllaznia”. Në këtë Revistë u pasqyruan disiplinat dhe sportistët që luajnë nën logon e KF Vllaznia dhe SK Vllaznia. Me anë të kësaj reviste synohet promovimi i sporteve dhe sportistave të qytetit të Shkodrës.

P12.F2.O2.A9 Aktivitet sportiv ndërkombëtar, "Memorial Vllaznia 2017" në boks.
Ekipi i të rriturve i Vllaznisë perbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 3 trajnerë.
Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 13 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marrë madalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithsej 42 medalje. Ky aktivitet ndërkombëtar ka 13 vite që organizohet në qytetin e Shkodrës duke promovuar kështu vlerat e kesaj disiplinë, të qytetit dhe sportistave elitare dhe atyre që duan të promovohen.

P12.F2.O1.A10 Mirënjohje për sportistët dhe trajnërët më të mirë.
Në fund të cdo viti si traditë që vazhdon, evidentohen sportistët dhe trajnerët më të mirë duke i dhënë një mirënjohje për punën e palodhur të tyre, si dhe duke i promovuar edhe me shumë para qytetit.

P12.F1.O1.A11 Shpërblim për ekipet kampion.
Duke qënë se Bashkia Shkodër është donatori i parë dhe më i rëndësishëm për të gjitha disiplinat në fushën e sportit për cdo ekip pjesë të Sport Klub Vllaznia, vazhdon mbështetjen nëpërmjet shpërblimeve për sportistat dhe trajnerët të cilët përfaqësojnë qytetitn në nivele të larta sportive me rezultate te theksuara.

P12.F2.O1.A1 Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia:
Eshte realizuar menaxhimi i Sport Klubit Vllaznia duke përfshirë, paga, siguracione, shërbime postare, shërbime internet dhe telefonie, energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu paisja e zyrave me materiale për zyra, si dhe kancelari, mundësimi i materiale të pastrimit. Është siguruar mbështetja për ekipin e ciklizmit me naftë për shoqërimin e sportistave gjatë stërvitjesme makinë. Ndërsa për mirëmbajtjen e Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi” janë siguruar vendosja e kamerave të sigurisë dhe lyerja e parketit. Për sportistat janë siguruar materialet sportive për të zhvilluar stërvitjen në kushte të pranueshme. P12.F2.O1.A3 Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia
Është realizuar administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shërbim të sigurimit të standarteve për drejtimin e tij. Për shkak të mosdorëzimit të Stadiumit “Loro Boriçi” nga FSHF dhe mospërdorimit të fondeve të planifikuara për menaxhimin e tij, si dhe me kërkesë të Klubit Futbollit Vllaznia u miratua nga Këshilli Bashkiak ne baze te VKB nr. 48 date 03.08.2017 rishpërndarja e fondeve, paksimi i tyre nga administrimi dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi”, shtesë tek Administrimi I Klubit të futbollit Vllaznia në shumën 17 000 000 lekë.

P12.F2.O2.A1 Mbështetje të Ekipi i basketbollit meshkuj të rritur

Ekipi i Bashketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967, 1969, 1990, 1993, 1994, 1995, 2000, 2014, 2015, 2016. Fitues i kupës së Republikës 8 herë në vitin 1957, 1959, 1965, 1989, 2001, 2008, 2013, 2014. Në vitin 2017 u rëndit në vend të dytë sin ë Kampionat Kombëtar, ashtu edhe në Kupë.

P12.F2.O2.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj.

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajnerë. Ky ekip ka dale kampion kombetar 6 here ne vitet 2005, 2006, 2008, 2010, 2013 dhe kampion aktual në fuqi për vitin 2017.

P12.F2.O2.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura.

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka arritur në vazhdimësi rezultate të larta në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fitues i kupës së Republikës 2 herë në vitet 1962,1988. Sezonin sportiv 16-17 e mbylli në vendin e pestë.

P12.F2.O2.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja

Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra SK "Vllaznia" përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Gjatë historisë së tij ky ekip ka zënë gjithnjë vende të kënaqshme në renditje në aktivitetet e zhvilluara. Kampion kombëtar në vitin 2016 dhe ne vend të dytë për vitin 2017.

P12.F2.O2.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.

Ekipi i të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973. Kampion kombëtar për vitin 2017 dhe finalistë të kupës së Shqipërisë.

P12.F2.O2.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura.

Ekipi i volejbollit të të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 3 herë në vitet 1947, 1957, 1960. Fitues I Kupës së Republikës 3 herë, në vitet 1962, 1963, 1964. Për vitin 2017 ekipi rënditet në vendin e 5.

P12.F2.O2.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj.

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka fituar tre kampionate kombëtare në vitet 1997, 2001, 2012. Në sezonin sportiv 16-17 ka zënë vendin e 6.

P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja.

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zëneë vende të treta dhe të katërta në kampionatet kombëtare. Në vitin 2016 dhe 2017 ekipi shpallet kampion kombëtar.

P12.F2.O2.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur.

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 20 herë, në vitet 1951, 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013 dhe 2015. Fitues i kupës së Republikës 20 herë në vitet 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013. Si ekip rënditen në vendin e 2 në kampionat dhe në kupë.

P12.F2.O2.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur.

Ky ekip ka dalë kampion 18 herë në vitet 1993, 1994, 1997, 1998, 1999, 2003, deri në 2005, 2009 deri në 2017 kampion absolut. Fitues i Kupës së Republikës në 26 vitet e fundit në vitet 2005, 2007,

2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016. Kampion absolute për vitin 2017 duke marrë disa medalje të arta si në kampionat kombëtar, ashtu edhe në kupë të republikës.

P12.F2.O2.A11 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur.
Ekipi i ciklizmit të të rriturve të Vllaznise përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zëne vende të para në kampionatet kombëtare (Rrethi ciklistik i Shqipërisë) 7 herë në vitet 1982, 1984, 1985, 1998, 1989, 1995, 1997. Kampion kombëtar për vitin 2017, dhe vend të parë në Kupë.

P12.F2.O2.A12 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura.
Ekipi i futbollit të femrave për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 25 sportiste dhe 2 trajnerë.
Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 2 herë në vitet 2013, 2014. Kampion absolut për 2017.

P12.F2.O2.A13 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura
Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ekipi i gjimnastikës i të rriturve për meshkuj ka zënë vendin e parë në vitet 1976-1977, ndërsa ekipi i gjimnastikës i të rriturve për femra ka zënë 8 herë vendin e parë në kampionatet në vitet 2005, 2006, 2008, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017.

P12.F2.O2.A14 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur
Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 1994. Ky ekip mbas vitit 1994 deri në vitit 1998 nuk merr pjesë në asnjë aktivitet për arsye financiare dhe fillon aktivitet në vitin 1999 e në vazhdim. Ekipi i të rriturve në vitin 2014, 2015, renditet në vendin e dytë dhe të tretë duke patur rezultate shumë të mira në aktivitetet kombëtare dhe merr pjesë disa here në aktivitetet miqësore ndërkombëtare. Zë vendin e 3 në kampionat kombëtar për vitin 2017.

P12.F2.O2.A15 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj të rritur
Ekipi i të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë N/kampion 2 herë në vitet 2009, 2010, nga vitit 2010 dhe deri 2015 renditet në e vendin e tretë. Gjithashtu për vitin 2017 është rënditur në vendin e tretë.

P12.F2.O2.A16 Mbështetje e ekipit te Notit të rritur dhe të rritura
Ekipi i notit për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.Në gara individuale ka pasur shumë rezultate të larta, gjithsej 30 medalje ari, argjendi dhe bronzi. Rënditet në vedin e tretë dhe të katërt për vitin 2017.

P12.F2.O2.A17 Mbështetje e ekipit te peshngritjes meshkuj të rritur
Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 3 trajnerë. Ky ekip ka daleë kampion 8 herë në vitet 1972, 1973, 1976, 1978, 1991, 2004, 2008, 2009. Në vitin 2017 rënditet në vendin e katërt.

P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit te Ping - Pong të rritur
Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 6 here në vitet 1966, 1968, 1970, 1975, 1982, 1983.
Ky ekip, që në vitin 1990 merr pjesë rregullisht në kampionatin kombëtar dhe kupat e Republikës duke zënë vende të dyta dhe të treta. Këtë vit u rëndit në vend të 3 si në kampionat, ashtu edhe në kupë.

P12.F2.O2.A19 Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur
Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 2008. Vend i tretë në 2017.

P12.F2.O2.A20 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja/ të rritur/të rritura

Ekipi përbëhet nga 40 kadet (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 5 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 10 herë kampioni Kupës së Republikës, dhe vazhdon të jetë kampion absolut në 2017.

### III. Fondet e financimit te programit:

Fondet e miratuara për vitin 2017 janë 114,887 mije lekë.
Realizimi për periudhën 12 mujore është 103 233 mije lekë, në masën 90% ndaj planifikimit vjetor .
Fondet për shpenzimet korrente sipas planit 2017 janë:

- Paga e sigurime shoqërore janë realizuar 10 319 mije lekë nga 11 797 mije lekë te planifikuara. Realizimi është në masën 87%.
- Shpenzime operative janë realizuar 28 327 mije lekë nga 37 780 mije lekë te planifikuara. Realizimi është në masën 75 %.
- Transferta janë realizuar në masën 63 160 mije lekë nga 63740mije lekë.Te planifikuara. Realizimi është në masën 99 %.
- Investime janë realizuar në masën 1 427 mije lekë nga 1 570 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 91 %.

**Fonde te rialokuara 2017:**

Për shkak të mosdorëzimit të Stadiumit "Loro Boriçi" nga FSHF dhe mospërdorimit të fondeve të planifikuara për menaxhimin e tij, si dhe me kërkesë të Klubit Futbollit Vllaznia u miratua nga Këshilli Bashkiak ne baze te VKB nr. 48 date 03.08.2017 rishpërndarja e fondeve, paksimi i tyre nga administrimi dhe mirëmbajtje e Stadiumit "Loro Boriçi", shtesë tek Administrimi I Klubit të futbollit Vllaznia në shumën 17 000 000 lekë.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2017**:

- Tabela e produkteve dhe realizimit të tyre nga pikëpamja financiare

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Plani i korrigjuar | Realizimi 2017 në mijë lekë. |
|---|---|---|---|
| P12.F1.O1.A1 Dita e vullnetarizmit | 200 | 200 | 135.2 |
| P12.F1.O1.A2 Kampionati i lojrave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës. | 65 | 65 | 30 |
| P12.F1.O1.A3 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër 2017 | 170 | 170 | 137.8 |
| P12.F1.O1.A4 Promovimi i lojës së shahut në Shkodër | 90 | 90 | 89.9 |
| P12.F1.O1.A5 Aktivitete sportive beach voley masive dhe profesioniste. | 493 | 493 | 310.6 |
| P12.F1.O1.A8 Turneu i tenisit për salla të mbyllura për fëmijë dhe të rinj. | 44 | 44 | 26.3 |
| P12.F1.O1.A7 Turneu i basketbollit, aktivitet masiv dhe profesionist. | 1104 | 204 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| P12.F1.O1.A8 Revista sportive "Vllaznia" | 100 | 100 | 96.8 |
| P12.F1.O1.A9Aktivitet sportive ndërkombëtar, "Memorial “Vllaznia” 2017" nëboks. | 410 | 410 | 346.8 |
| P12.F1.O1.A10 Mirenjohje per sportistet dhe trajneret me te mire | 30 | 30 | 25.2 |
| P12.F1.O1.A11 Shperblim per ekipet kampion | 1,660 | 1660 | 600 |
| P12.F2.O1.A1 Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia | 14,622 | 15522 | 13814.11 |
| P12.F2.O1.A2 Administrimi dhe mirembajtje e Stadiumit “Loro Borici” | 8,800 | 8800 | 0 |
| P12.F2.O1.A3 Administrimi i Klubit te futbollit Vllaznia | 45000 | 62000 | 62,000 |
| P12.F2.O1.A4Vlersim i aseteve dhe pergatitja e dokumentacionit per shitjen me ankand te aksioneve te Bashkise Shkoder ne KLUBI i FUTBOLLIT “VLLAZNIA” sh.a me NIPT: L17029001S | 1,000 | 1000 | 1000 |
| P12.F2.O2.A1 Ekipi i basketbollit i te rriturve per meshkuj | 3,135 | 3,135 | 3,089.25 |
| P12.F2.O2.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj te rinj | 576 | 576 | 572.25 |
| P12.F2.O2.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura | 1,400 | 1,400 | 1396.25 |
| P12.F2.O2.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja | 480 | 480 | 476.25 |
| P12.F2.O2.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur. | 3,600 | 3,600 | 3506 |
| P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura | 1,250 | 1,250 | 1250 |
| P12.F2.O2.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj | 470 | 470 | 430 |
| P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja | 470 | 470 | 470 |
| P12.F2.O2.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur | 2,900 | 2,900 | 2900 |
| P12.F2.O2.A11 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur | 2,800 | 2,800 | 2800 |
| P12.F2.O2.A12 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur | 1,250 | 1,250 | 1250 |
| P12.F2.O2.A13 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura | 600 | 600 | 600 |
| P12.F2.O2.A14 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura | 1000 | 1000 | 970.4 |
| P12.F2.O2.A15 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur | 186 | 186 | 182 |
| P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj te rritur | 745 | 745 | 745 |
| P12.F2.O2.A17 Mbështetje e ekipit te Notit te rritur dhe te rritura | 197 | 197 | 197 |
| P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit te peshngritjes meshkuj te rritur | 1,530 | 1,530 | 1530 |
| P12.F2.O2.A19Mbështetje e ekipitte Ping - Pong territur | 160 | 160 | 160 |
| P12.F2.O2.A20Mbështetje e ekipitteShahutterritur | 300 | 300 | 300 |
| P12.F2.O2.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja/ të rritur/të rritura | 1050 | 1050 | 1050 |
| **Total** | **97,227** | **114,887** | **103,233** |

## IV. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12-mujorin 2017

Vështiresite e ndëshura përgjatë realizimit të Buxhetit 2017 në programin Rinia e Sportet janë si më poshtë:

| Problemet për tu adresuar | Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugën "Rragam - Sheldi" Loti 1 dhe ndodhet në Njësia Administrative Guri i Zi. Kjo rrugë lidh fshatin Rragam me fshatin Sheldi . Përgjithsisht përgjatë kësaj rruge ka banesa 1-2 katëshe. Gjatësia e këtij segmenti është 3 800 ml dhe gjerësia 5 m. Me një sipërfaqe 19 000 m2, rruga i shërben rreth 400 banorëve. Ky projekt ka parashikuar ndërtimin nga e para e të gjithë elementevë të nevojshëm për krijimin e kushteve optimale në shërbim të komunitetit.<br>Projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit janë hartuar në terësi duke përfshirë si infrastrukturën rrugore ashtu dhe infrastrukturën nëntokësore (kanalizime K.U.B.-rrjeti i kanalizimeve të ujrave të bardha). Rikonstruksioni i rrugës synon krijimin e hapësirave më miqësore për funksionimin e kësaj zone.<br>Përfituesit direkt të projektit janë 400 banorët e zonës. | |
| Emri i Programit | Infrastrukturë rrugore | |
| Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen | Qëllimi i projektit konsiston në përmirësimin e mjedisit rural dhe në mënyrë të veçantë të kthimit në një rrugë me standartet e duhura në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, mbitokësor, ujësjellës, etj, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve. Rikonstruksioni i rrugëve, blloqeve të pallateve dhe rrugicave mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim. Realizimi i projektit te zbatimit duhet të sigurojë respektimin e standarteve si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare.<br>Me zbatimin e këtij projekti do te përfitohen rreth:<br>19000 m2 sipërfaqe rruge e rikualifikuar/asfaltuar<br>3800 ml kanalizime K.U.B të rikonstruktuara;<br>Sinjalistikë e plotë për lëvizshmërinë;<br>400 banorë përfitojnë;<br>Vlera totale e investimit është 99,024, nga kjo për vitin 2018 parashikohet investimi sipas vlerave në tabelën mëposhtë.<br>Jemi të gatshem për bashkëfinancim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe donator të tjerë. | |

0.3. Kostot e Projektit të Investimit

| | Totali | Investimi | Projektim |
|---|---|---|---|
| Kosto e zbatimit | 2417 | 2417 | |
| Kosto supervizim | | | |
| Kosto kolaudim | | | |
| Kosto e projektimit | | | |
| Kosto Totale e Projektit - 000/lekë | 2417 | 2417 | |

4. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>Statusi i Projektit Idesë |
|---|---|---|---|---|
| Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB) | Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve | | | |
| Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka) | | | | |
| Sekretari i Përgjithshem | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë |
| Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka) | | | | |

**11. Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe(Shtese)**
**Kodi në matricë: P3.F1.O4.A13.**

**01. Personat e Kontaktit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit të projektit** | Bashkia e Shkodrës | **Firma e propozuesit të Projektit** | |
| **Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit** | Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve | | |
| **Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori** | Bashkia Shkodrës | **Vendodhja e Projektit** | Bashkia Shkodër<br>NJ.A. Berdice |

**02. Identifikimi i Idesë së Investimit**

| | | |
|---|---|---|
| **Projekt Idea** | Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe | Viti 2018 |
| **Problemet për tu adresuar** | Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme dhe rruga e Palokajve Berdice e Madhe jane dy segmente te rendesishme ne NJA Berdice.<br>Rruga Gjergj Jakin me nje gjatesi rreth 670 m, eshte nje rruge me bazament te mire, me mundesi kullimi. Gjate sezonit te dimrit, per shkak te reshjeve, kjo rruge me gropa veshtireson jetene familjeve. Investimi qe projektojme te realizojme ben fjale per sistemimin, shjtresat dhe asfaltimin rrugor si dhe ndricimin publik.<br>Kjo rruge i sherben rreth 680 banoreve te lagjes gjergj jakin dhe e lidh kete lagje me rrugen kryesore te Velipojes.<br>Rruga e Palokajve Berdice e Madhe, me gjatesi rreth 650 m i sherben rreth 800 banoreve te kesaj lagjeje, nje rruge me taban, pa kanalizime te ujrave te bardha dhe pa ndricim rrugor.<br>Investimi qe projektojme do te marre ne konsiderate kerkesat e banoreve ne kete zone me dendesi te madhe te banesave, per te permiresuar infrastrukturen e kullimit te rruges, ndricimin publik dhe shtresat asfaltike.<br>Ne te dyja keto rruge nuk eshte nderhyre asnjehere prej vitesh. | |
| **Emri i Programit** | Infrastrukturë rrugore | |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen** | Qëllimi i projektit konsiston në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe në mënyrë të veçantë të ofrimit të një rruge me akses shume te mire në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin mbitokësor, etj, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.<br>Me zbatimin e këtij projekti do te përfitohen rreth 1.3 km rruge e rikualifikuar/asfaltuar me kullim të ujrave të bardha<br>Sinjalistikë e plotë për lëvizshmërinë;<br>Përfitojnë rreth 680 banore ne Berdice te Siperme dhe rreth 800 banore ne berdice te Madhe. | |

**0.3. Kostot e Projektit të Investimit**

| | **Totali** | **Investimi** | **Projektim** |
|---|---|---|---|
| **Kosto e zbatimit** | **9684** | **9684** | |
| **Kosto supervizim** | **133** | **133** | |
| **Kosto kolaudim** | **11.5** | **11.5** | |
| **Kosto e projektimit** | **309** | | **309** |
| **Kosto Totale e Projektit - 000/lekë** | **10137.5** | **9828.5** | **309** |

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë**

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>*Statusi i Projektit Idesë* |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve | | | |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)** | | | | |
| **Sekretari i Përgjithshem** | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë |
| **Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka)** | | | | |

**13.Rikonstruksion i rrjetit kryesor te ujsjellesit dhe ndertim i rrjetit te brendhshem te ujesjellesit ne fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj I Vjeter, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re,**

**Kodi në matricë: P4.F3.O1:A2:**

**01. Personat e Kontaktit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i propozuesit të projektit** | Bashkia e Shkodrës | **Firma e propozuesit të Projektit** | |
| **Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit** | Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve | | |
| **Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori** | Bashkia Shkodrës | **Vendodhja e Projektit** | Bashkia Shkodër Njesia Administrative Rrethina |

**02. Identifikimi i Idesë së Investimit**

| | | |
|---|---|---|
| **Projekt Idea** | Rikonstruksion i rrjetit kryesor te ujsjellesit dhe ndertim i rrjetit te brendhshem te ujesjellesit ne fshatin Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj I Vjeter, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re, dhe ndertim i stacionit te ri te pompimit depos se re punime elektrike ne stacionin e ri. | Viti 2018 |
| **Problemet për tu adresuar** | Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në riparimim dhe venien ne funksion te tubacionit kryesor te linjes se ujsjellesit nga depo ne shatin Kullaj deri ne fshatrat Guci, Shtoj i Ri, Shtoj I Vjeter, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), ndertimin e nje depo te re prane stacionit te pompmimit, vendosjen ne eficence te dy puseve te reja ne Kullaj, vendosjen e dy pompave zhytese, vendosjen e nje pompe te re per dergimin e ujit nga depo ne stacionin e pompimit deri ne depon 1000m3 dhe 200m3 ne Kullaj.<br>Perfituesit e ketij investimi jane rreth 16000 banore te ketyre fshatrave. | |
| **Emri i Programit** | Ujesjelles kanalizime vendore | |
| **Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen** | Qëllimi i projektit konsiston në furnizimin me uje te nje zone me mbi 16000 banore. Rritjen e sigurise per cilesine e furnizimit me uje te popullates dhe administrimin me te mire te burimeve ujore te zones.<br>Me zbatimin e këtij projekti do te përfitohen:<br>• Depo e re pranestacionit te pompimit<br>• Dhoma e klorinimit<br>• Stacionpompimiir<br>• Linjastacionpompimideri ne depon 1000m3 ekzistuese<br>• Punimetelektrike per stacionin e ri te pompimit<br>• Linjatshperndarese per Fshatin e Ri<br>• Riparimpjesor te linjeskryesore<br>• Venien ne eficence te dypuseve te ujitekzistues<br>• Linjatshperndarese per fshatrat Guci, Shtoj i Ri, Shtoj I Vjeter, Vinoteka<br>• Vendosja e matesave per konsumatoret<br>Kostoja per pjesen e parashikuar per nderhyrje ne projektt lekë | |
| | | |

Kostoja per pjesen e parashikuar per nderhyrje ne projektt lekë

| | **Faza e I-re** | **Faza e II-te** | **Totali** |
|---|---|---|---|
| **Kosto e zbatimit** | **9,000,000** | **51 000 000** | **60,000.000** |
| **Kosto supervizim** | **472, 500** | **661 500** | **1,134,000** |
| **Kosto kolaudim** | **70, 875** | **99 225** | **170,100** |
| **Kosto e projektimit** | **4,365,900** | | **4,365,900** |
| **Kosto Totale e Projektit - 000/lekë** | **13,909,275** | **51,760,725** | **65,670,000** |

**0.3. Kostot e Projektit të Investimit**

| | **Totali** | **Investimi** | **Projektim** |
|---|---|---|---|
| **Kosto e zbatimit** | **9,000,000** | **9,000,000** | |
| **Kosto supervizim** | **472,500** | **472, 500** | |
| **Kosto kolaudim** | **70, 875** | **70, 875** | |
| **Kosto e projektimit** | **4,365,900** | | **4,365.900** |
| **Kosto Totale e Projektit - 000/lekë** | **13,909, 275** | **9,543.375** | **4,365.900** |

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë**

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit<br>*Statusi i Projektit Idesë* |
|---|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)** | | | | |
| **Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)** | | | | |
| **Sekretari i Përgjithshem** | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë |
| **Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka)** | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 12 | **P4.F7.O1.A1(Shtese)**<br>Dekorimi i mjediseve publike | **Llojet e programit : P4.** Shërbimet Publike<br>**Funksioni : P4.F7.** Shërbimi i dekorit publik |

a) **Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Dekori i mjediseve publike realizohet nga Buxheti i Bashkisë, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Në strukturën e Drejtorisë janë tre specialistë për dekorin që punojnë me kohë të plotë për realizimin e shërbimit dhe specialistat e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave. Gjithashtu me kohë të pjesshme për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.

Puna që kryhet:

Ky shërbim realizohet kryesisht për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkise gjatë vitit. Sipërfaqja e shesheve dhe e rrugëve të dekoruara në territorin e Bashkisë së Shkodrës është rritur progresivisht nga viti në vit. Pjesa më e madhe e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Gjithsej janë gjendje 450 aksesorë zbukurues me të cilët dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, gjithashtu do të realizohet dekorimi i shëtitoreve rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.

Këtë vit është realizuar blerja zbukurimeve që kanë bërë të munduar shtimin e sipërfaqeve të dekoruar për festat e fundvitit në sheshet kryesore dhe akset kryesore në qendër të qytetit.

Dekori është realizuar dhe për aktivitete tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, etj.

<u>Problemet e paraqituara</u>

Në konteksin e ri territorial të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në njësitë administrative të bashkisë si dhe rritja e cilesisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane.

Mungesa e dekorit për disa aktivitetet tradicionale.

**ii. Synimi i projektit**

**Viti 2018** Përmirësimi i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave.
Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ.
Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

**I.Dekorimi i mjediseve publike**
**Viti 2018**
Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fund vitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit.

1. Blerje aksesor dekori për festat:
   - Blerja e aksesorëve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesor të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto aksesorë për festat e fundvitit do të realizohen dekorimi i akseseve kryesore të rrugëve të qytetit, sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, gjithashtu do të realizohet dekorimi i shëtitoreve rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.
   - Gjatë këtij viti për herë të parë parashikojmë dekorimin e ambjenteve publike për festa të ndryshme fetare. Kjo do të realizohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve fetare në mbështetje të aktiviteteve që ato zhvillojnë.
2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin:
   - Këtu përfshihen materialet e domosdorshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:
   - Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm) gjithsej 900 ml;
   - Tel percjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm gjithsej 900 ml;
   - Lidhëse kabllosh plastike gjithsej 45 kuti;
   - Pistole saldimi plastik gjithsej 2 copë dhe elektroda saldimi plastike gjithsej 480 copë;
3. Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.
4. Blerje bredha, të cilët do të vendosen në sheshet kryesore.

**b) Rezultatet që prisni**

**Viti 2018**
Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane;

- Krijimi i dekorit festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare.
- Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tëkontribuojëpërkëtëprojekt, financiarisht, etj.) |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.<br>• Administratorët e NjA | Bashkia Shkodër<br>Donatoret |

e) Shpenzimet e llogaritura

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | Totali<br>( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferi me | Kapitale |
| A.1.1 | Blerje aksesor dekori për festat | **45** | | | 45 | | |
| | **Shuma** | **45** | | | **45** | | |
| **f) Periudha e zbatimit**<br>Gjatë viti 2018 | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës | | | | | |

| Nr. 13 | **P6.F1.O1.A5.** Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare**(Shtese)** | **Llojet e programit: P6** Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit<br>**Funksioni: P6.F1.** Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal. |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Procesi i integrimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së.Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qellim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafruara europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Europian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nevojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zerat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

**ii. Synimi i projektit**

Të parashikojë fondin për bashkëfinancimet në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Europian për përiudhën 2018 – 2020.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë me mjete financiare projektet në të cilat është shpallur fituese nga BE, sipas marrëveshjeve financiare të nënshkuara nga Bashkia Shkodër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane
- Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje
- Rritje e transparencës me publikun

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vlerë e bashkëfinancimit e programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të BE-së:<br>- Ekspertë të fushës (honorar 2700 lekë/ orë)<br>- Shpenzime operative, etj.<br>-Pajisje kompjuterike | **2000** | | | 1800 | | **200** |
| | **Shuma** | **2000** | | | **1800** | | **200** |

| **f) Përiudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>**2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit |
|---|---|

| Nr. 14 | **P10.F4.O1.A1 (Shtese)**<br><br>Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe | **Llojet e programit: P10.** Strehimi dhe Shërbimet Sociale<br><br>**Funksioni:P10.F4.O1** Në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Mirëqenien Sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Projekti Shpresa, është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAN-të e braktisur nga familja dhe të deinstitucionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 6 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 60 persona me aftësi ndryshe.

Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi ndryshe, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.

Në vitin 2017, bashkia Shkodër, projektit "Shpresa", i ka mbuluar përvec fondit për paga dhe sigurime shoqërore për 24 punonjës të personelit, gjithashtu ka mbuluar dhe pagat për administratorin e shtëpi familjes, si dhe psikologun klinik dhe infermierin.

Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër ka mbështetur Projektin "Shpresa" duke mbuluar, kuotën ushqimore për personat me aftësi ndryshe të sistemuar pranë kësaj shtëpi Famije dhe energjinë elektrike sipas marrvëshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe Projektit Shpresa .

Projekti Shpresa me shkresen, nr.9/2018, administruar nga ne Nr.1484 prot dt.31/01/2018, në zbatim të Ligjit të Buxhetit nr.109 datë 20.12.2017 " Për Buxhetin e vitit 2018" Aneksi 4 "Për funksionet që financohen me transferta specifike për vitin 2018,pika 2 "Qëndrat e Shërbimeve Sociale", për vitin 2018 dhe shkresës së dërguar nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 48 dt. 03.01.2018 në lidhje me llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore për Institucionet Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror ka kerkuar që të bëhet ndryshimi i shperndarjes se fondeve dhe shtesa perkatese, ne mbeshtetje te ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, (lidhja II, klasa VIII për Kujdestarët Social).

VKM nr. 187, datë 08.03.2017 „Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë/nënpunësve, zëvëndësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, KQZ, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit, Lidhja I, klasa IIIb për Titullarin dhe IVb për Psikologun klinik dhe Infermierin.

VKM nr.822 date 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore".

VKB Nr. 85, Datë 26.12.2017 "Për miratimin e Buxhetit 2018 dhe Afatmesëm 2019-2020".

Udhëzimi nr. 5 datë 01.08.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror"i ndryshuar.

**ii. Synimi i projektit**

- Synojmë ofrimin e shërbimeve alternative për PAN-të, si shërbimin e deinstitucionalizimit dhe parandalimin e institucionalizimit për PAN-të në rrezik, në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa" sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi ndryshe.
- Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë projektit "Shpresa" për PAN-të e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Nënshkrimi i marrëveshjes midis bashkisë Shkodër dhe projektit "Shpresa" për fondin e 2018.

Përgatitja e dokumentacionit nga projekti "Shpresa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë zyrës së shërbimit social, çdo fillim muaji. Aktualisht në shtëpitë-familje të projektit "Shpresa" jetojnë 58 persona me aftësi ndryshe, nga të cilët 33 prej tyre përfitojnë pensionet e invaliditetit, për të cilët nuk kërkohet kuotë ushqimore nga organizata. 15 persona janë pa pensione invaliditeti për shkak të problematikave dhe mungesave të dokumentacionit. Ne baze të udhëzimit Nr.5 datë 1.8.2012 , "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime", duke u mbeshtetur në pikën 4 të nenit të Kushtëtutës së Republikës të Shqipërise në zbatim të nenit 24 të ligjit 9355 , datë 10.3.2005, konkretisht pika d ku përcakton: kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit është 340 lekë në ditë. ( 365 ditë x 15 persona x 340 leke/ditë = 1,861,500 leke/vit)

- Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për Drejtorinë e Financës.
- Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në projektin "Shpresa".

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësim i shërbimit të ofruar për PAN-të qe jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa".
- Parandalimi i institucionalizimit të personave me AN.
- Mbështetje afatgjatë e sigurtë për klientët që jetojnë në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa".
- Bashkëpunim i ngushtë me organizatën projekti "Shpresa".
- Përmirësim i situatës së PAN-ve të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja, duke i sistemuar në projektin "Shpresa".

| c) Aktorët e mundshëm (grupetqëlidhen me projektin dhe që ndikohen) | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit “Shpresa”<br>Komuniteti<br>Institucionet publike<br>Organizatat | MMSR<br>Bashkia<br>Projekti “Shpresa” |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Paga për 24 kujdestarë | 773.068 | | | | 773.068 | |
| A.2 | Paga për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin | (304.772) | | | | (304.772) | |
| A.3 | Kuota ushqimore | 947.500 | | | | 947.500 | |
| A.4 | Energji Elektrike | 569.790 | | | | 569.790 | |
| | **Shuma** | **1,985.586** | | | | **1,985.586** | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Viti 2018 | Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social Strehimit dhe Shëndetit Publik<br>Stafi i Drejtorisë së Financës<br>Projekti “Shpresa”<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |

| Nr 15 | **Projekti P10.F3.O1.A5**<br>Park lojrash per femije ne lulishtet dhe parqet e qytetit të Shodrës. | **Llojet e programit: P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale**<br>**Funksioni: F3.** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Në një sondazh të realizuar në vitin 2017 nga Konrad Adenauer Siftung dhe Friedrich Ebert Siftung, ku u pyetën rreth 1400 qytetarë rezultoi se ata klasifikonin si një ndër prioritetet për t'u marrë në konsideratë nga Bashkia e Shkodrës në tre vitet e ardhshme është krijimi i parqeve dhe këndeve të lojrave për fëmijët dhe të rinjtë.




Grafiku 1 Cili duhet të jetë përparësia nr.1 e Bashkisë në tre vitet e ardhshme?

Nga vlerësimi i realizuar në hapësirat publike në qytetin e Shkodrës, disa parqe të ndërtuara përpara disa vitesh në saje të kontributit të donatorëve janë dëmtuar rëndë dhe nuk janë më në funksion për fëmijët dhe familjet. Kështu mund të përmendim parkun e lojrave të lulishte në sheshin "Isa Boletini" realizuar nga bashkëpunimi me Pro Credit Bank, parkun e lojrave në lulishten qendrore të qytetit pranë shatërvanit realizuar nga bashkëpunimi e dldp, apo këndin e lojrave pranë lulishtes në afërsi të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ndërtuar nga bashkëpunimi me Regione Emilia Romagna

Për këtë qëllim, propozohet ndërtimi i këndeve të lojrave në shërbim të familjeve dhe fëmijëve në qytetine Shkodrës aty ku kjo është e mundshme të realizohet.

Instumente dhe lojra të sigurta dhe të përshtatme për fëmijët dhe të rinjtë do të jenë pjesë e investimit të këndeve të lojravve në parqet e qytetit.



loje me dy rreshkitese 6.3x3.5 cmimi=450.000 leke



shtepi e mahe cmimi=70.000 leke



lisharse me dy rreshkitese 6.5x4.5 cmimi=390.000 leke



pelikundese per 4 femije 3x2 cmimi=70.000

Ndërtimi dhe krijimi i hapësirave publike të lojës do t'u shërbejë fëmijëve dhe të rinjve.

**ii. Synimi i projektit**

Krijimi i hapësirave të përshtatshme publike për edukimin, argëtimin dhe përfshirjen e të rinjve dhe fëmijëve për aktivitete sociale dhe integruese.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Rehabilitimi dhe ndërtimi i këndeve të lojrave në parqet dhe lulishtet e qytetit të Shkodrës.

- Hartimi i projektit
- Përcaktimi i termave të referencës
- Prokurimi
- Realizimi i projektit të rehabilitimit dhe ndërtimit të këndeve të lojrave
- Organizimi dhe monitprimi i funksionimit të këtyre hapësirave

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësim i imfrastrukturës publike në shërbim të familjeve, të fëmijëve dhe të rinjve

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|

| | |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit<br>• Qytetarët | Buxheti i Bashkisë<br>Organizata dhe donatorë të mundshëm |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet sipas aktiviteteve 2018** | | Totali(000/lekë) | Nga kjo : | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga.sigurime | Operative | Kapitale |
| A1 | Rehabilitimi dhe ndërtimi i këndeve të lojrave në parqet dhe lulishtet e qytetit të Shkodrës. | 1668.156 | | | 1668.156 |
| | **Shuma 2018** | 1668.156 | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon**<br>Gjatë vitit 2018 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria Shërbimeve Sociale dhe Strehimit |

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 16 | **P11.F2.O2.A30 P11.F1.O1.A18**<br>"Pregatitje e ekspozim te portreteve te kryetareve te Bashkise Shkoder ndër vite" | **Llojet e programit: P11.** Kultura dhe shërbimet reakrecionale<br><br>**Funksioni: P11.F2.**<br>Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës |

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bashkia Shkoder ka qene e drejtuar nder 48 vite nga kryetaret e saj ku sejcili ka lene gjurmet e veta ne zhvillimin e kesaj bashkie.
në shpalljen e Pavarësisë këtë institucion e kanë drejtuar; Ibrahim Idriz Hoxha, Selim efendi Çoba, Isuf efendi Golemi, Bektash agë Kazazi, Shaqir beg Bushati, Riza beg Kopliku e Muharrem Gjylbegaj. Ky i fundit, përveç të tjerave, ka meritën që ngriti flamurin kombëtar me 28 nëntor 1913 në institucionin që drejtonte, si simbol i bashkimit të Shkodrës e krahinave të saj me qeverinë e parë shqiptare të krijuar në Vlorë nga Ismail Qemali një vit më parë. Po ashtu edhe për ngritjen e këtij flamuri në Kalanë e Shkodrës më 19 mars 1914.Më 1916, kryetar i bashkisë së Shkodrës u zgjodh Musa Juka, i cili, në këtë vit, rikonstruktoi ndërtesën, që edhe sot është selia e Bashkisë së qytetit.
Këtë funksion, Musa Juka e mbajti gjatë periudhës së sundimit austro-hungarez (1916-1918), në atë të protektoratit të forcave ndër-aleate (1918-1920) dhe atë të qeverisë shqiptare që doli nga Kongresi i Lushnjes (1920-1924).Në periudhën qershor - dhjetor 1924, kryetar i bashkisë ishte Muhamet Gjyrezi, kurse në janar 1925, Mehmet Shpuza. Me 24 gusht 1928 në këtë post vjen Rustem Ymeri, që pas disa muajsh, zëvëndësohet nga Izet Dibra (deri në qershor 1930). Prej kësaj kohe (deri në janar të vitit 1931) vjen në këtë detyrë Zenel Prodani. Për dy vjet (janar 1931-mars 1933) kryetar i bashkisë së Shkodrës rikthehet Rustem Ymeri. U zëvëndësua nga Zenel Prodani gjatë periudhës prill 1935 - gusht 1937). Për dy vjet (gusht 1937- qershor 1939) në këtë post ishte Ndoc Çoba.Për tre vjet (1939-1942) ishte Mark Kakarriqi e pas tij; Zef Shiroka, (maj 1942-shkurt 1943), Loro Suma (Shkurt 1943-prill 1943), Zef Gjeta (prill 1943 - korrik 1944), dhe i fundit, Dhimitër Bojaxhiu (deri në 1945).
Struktura e bashkisë, në formën më përparuar të paraluftës (1928-1939) përbëhej nga Kuvendi i Bashkisë, Këshilli i Bashkisë, Kryetari i Bashkisë dhe Personeli i Bashkisë.
Më shndërrimet demokratike të viteve '90, zgjedhjet e para pluraliste për postin e kryetarit të Bashkisë së Shkodrës (26 korrik 1992), në mes të 5 grupimeve politike, fitoi kandidati i PD, z. Filip Guraziu.. Gjatë këtij mandati u miratua edhe stema e qytetit. 20 tetor 1996 u zgjodh në postin e Kryetarit të Bashkisë z. Bahri Boriçi. Zgjedhjet e treta u bënë më 1 tetor 2000 ku fitoi kandidati i PD, z. Ormir Rusi. Në zgjedhjet që u zhvilluan me 12 tetor 2003 fitoi Z. Artan Haxhi i PD. Në zgjedhjet që u zhvilluan me 18 shkurt 2007 fitoi Z. Lorenc Luka i PD. Ne zgjedhjet e vitit 2016 fitoi e u zgjodh Zj, Voltana Ademi.
Duke u nisur nga ky fakt, eshte ne nderin e Bashkise Shkoder te pregatise dhe te ekspozoje portretet e tyre ne ambjentet e saj.
Nje ekspozim i tille sjell me prane kujtimin e tyre dhe nderon figurat te tyre si frymezuese per te ecur perpara ne sherbim te zhvillimit te Bashkise Shkoder.
Jane 25 kryetarë bashkie nder keto vite qe portretet e tyre do te ekspozohen si nderim per punen e kryer.
Keto portrete do te ekspozohen ne ambjentete e Bashkise Shkoder ne shenje nderimi per kontributin e dhene nga ana e sejcilit ne peridhen perkatese te drejtimit te Bashkise Shkoder.

ii. Synimi i projektit

- Nderim per figurat drejtuese kryetar bashkie nder vite per Bashkine Shkoder.
- Edukimi i brezit të ri me shembuj konkrete qe kane punuar ne sherbim te zhvillimit te Bashkise Shkoder.
- Nxitja e motivimit per gjithe qytetaret e Bashkise Shkoder per kontribut pozitiv ne zhvillimin e komunitetit kudo ku kontribuojne.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Ngritja e grupit organizator.
- Përzgjedhja e materialeve historike, percaktimi i portreteve te pershtatshme.
- Bashkërendimi i punëve për realizimin.

b) Rezultatet që prisni

- Perforcimi i kujteses per figura qe kane kontribuar ne zhvillimin e Bashkise Shkoder nder vite.
- Promovimi i shembullit pozitiv ne brezin e ri nepermjet ekspozimit te ketyre figurave të njohura per komunitetin e Bashkise Shkoder.
-Rritje e motivimit per kontribut pozitiv nga sejcili qytetar per zhvillimin

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshmenëprojekt |
|---|---|
| - Drejtoria e Kultures. | - Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (000 lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Honorare per perzgjedhje te materialit historik, pregatitje dhe ekspozim te portreteve te kryetareve te bashkise nder vite ne hollin e Bashkise Shkoder 1portret x 35000 lekë | 875 | | | 875 | | |
| | **Shuma** | **875** | | | **875** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br><br>**Viti 2018** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit<br>Institucion Likuidues:Bashkia Shkoder |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.17 | **P11.F2.O2.A35**<br><br>**Viti Kulturor Shqiperi – Austri 2018** | **Llojet e programit: P11**. Kultura dhe shërbimet reakrecionale<br><br>**Funksioni: P11.F2.**<br>Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës |

**a)Përshkrimi i shkurtër i projektit** : Vënia në skenë e dy shfaqjeve

**i. Situata**

Viti kulturor Austri-Shqipëri 2018 sjell në vendin tonë zhvillimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme artistike dhe kulturore. Arti dhe kultura kanë treguar se shërbejnë si ura komunikimi mes popujve dhe njerëzve dhe si instrumentet më të mirë për t´i bërë bashkë ata. Bashkëpunimi kulturor mes Shqipërisë dhe Austrisë ka një traditë të gjatë dhe mund të cilësohet si një ndër pjesët më të rëndësishme të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy vendeve dhe siç ka cituar dhe Ambasadori Austriak ne Shqiperi Z. Johann Sattler : "Nëse do të krijohej edhe një herë Bashkimi Europian do ta fillonte me kulturën, sepse kultura nuk është luks, por është baza për një bashkëjetesë të frytshme "
Ne kuader te ketij bashkepunimi gjate vitit 2018 ne Teatrin " Migjeni ", ne bashkepunim me Ambasaden Austriake ne Shqiperi dhe me TKOB do te organizohet nje koncert madheshtor dhe do vihet ne skene dhe shfaqja me titull " Reinge " e autorit Arthur Schicel dhe me regjizor Alois Gale, e perkthyer ne shqip "Sillu e pshtillu, bjer ne kuj e lidhu", shfaqje kjo e perbere nga 10 personazhe , nga te cilet 5 aktore te Teatrit " Migjeni " dhe 5 aktore te jashtem.

**ii. Synimi i projektit**

- Të argëtojmë dhe të vëmë në dukje spektatorin e të gjitha moshave me vlerat kulturore qe percjellin shfaqjet
- Të rrisë numrin e spektatorëve.
- Të promovojë vlerat e patjetersueshme të bashkepunimit nderkulturor.
- Të gjenerojë të ardhura që të përdoren për vazhdimin e shfaqjeve të tjera.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Procedurat e pergatitjes së shfaqjeve
   - Akomodimi I artisteve dhe instrumentisteve shqiptar Përzgjedhja/përshtatja e tekstit letrar.
   - Perzgjedhja e materialeve letrare e muzikore.
   - Shtrimi i platformës regjizoriale.
   - Përzgjedhja e artistëve pjesmarrës.
   - Përzgjedhja e skenografit.
   - Përzgjedhja e kostumografit.
   - Perzgjedhja e muzikes
   - Efektet speciale (ndriçimi, fonia, videoprojeksioni, audioprojeksioni etj.).
   - Përcaktimi i figurës artistike nga ana pamore (grimi, parukjeria).
   - Puna në tavolinë me tekstin.
   - Paraqitja e punës në tavolinë.
   - Puna në skenë e koordinuar me të gjithë elementet skenik (ndriçim, foni, efekte speciale,grim, parukeri, video, audio, publiciteti, banera, postera etj ).
   - Prova gjenerale përmbyllëse.
2. Realizimi i pagesave honorareve per regjizorin, muzikantin, skenografin, kengetaret, balerinet, etj (sipas roleve).

Blerje materiale për realizimin e shfaqjes

**b) Rezultatet që prisni**

- Vënia në skenë e dy shfaqjeve me cilësi te larte kulturore
- Rreth 1500 spektatorë shkodranë do ta shijojnë veprat.

| c) Aktoret e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| • Artistët<br>• Instrumentistët<br>• Stafi mbështetës<br>• Persona të kontraktuar për sigurimin e një shfaqje sa më cilësore<br>• Artdashësit | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: Paga | Siguri me | Operati ve | Transferi me | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Akomodim I te ftuarve, shpenzime operative per Viti Kulturor Shqiperi – Austri 2018 | 1500 | | | 1500 | | |
| | **Shuma** | **1500** | | | 1500 | | |

| f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Viti 2018 | Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit<br>Teatri Migjeni<br>Institucion Likuidues:Teatri Migjeni |

| Nr. 18 | **Projekti : P13.F2.O1.A2 (Shtese)**<br><br>Shërbimi i MZSH | **Llojet e programit: P13**Emergjencat civile<br><br>**Funksioni : P13.F2** Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në ligjin Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", pika 2, parashikon "*Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së* përcaktuar me ligj" sipas këtij ligji, ky funksion i kaloi Bashkisë së Shkodrës

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut (LIGJ Nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 2)

Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse

merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;

Drejtoria e Shërbimit të MZSH-së Shkodër ka ne dispozicion në luftën ndaj zjarrit vetem 3 automjete dhe përkatësisht mjetin tip Benz Bot me kapacitet 2700 litra ujë me vit prodhimi 1986 , Iveko 8-ton me kapacitet 8000 litra ujë me vit prodhimi 1990 , iveko 10-ton me kapacitet 10000 litra ujë me vit prodhimi 1993.

Vlen të theksohet se vetëm mjeti tip Benz Bot është një automjet i mirëfilltë zjarrfikës ndërsa mjetet tip Iveko janë Bota uji që janë modifikuar nga ana jonë në mjete zjarrfikëse dhe nuk mund të përdoren për fikjen e të gjitha zjarreve sidomos zjarreve specifike siç janë karburantet etj , pasi nuk kanë depozita shkume , material që përdoret për fikjen e zjarreve specifike.

Duke analizuar këtë situatë është e nevojshme blerja e një mjeti zjarrfikës për Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së Shkodër pasi do na ndihmojë shumë në përballimin e situatave të zjarrit që mund të ndodhin në territorin e Bashkisë Shkodër duke ju përgjigjur më mirë nevojave që kanë qytetarët për fikjen e zjarreve dhe ndërhyrjeve për shpëtim.

Ne vitin 2017 me vendim te kryetarit te bashkise nr 310, date 21.08.2017 "Per nje rishperndarje ndermjet zera ve te shpenzimeve korente dhe projekteve te investimeve per vitin 2017 . (program 10910 "Emergjenca Civile"). U rishpernda fondi prej 3000 mije leke duke u vene ne dispozicion te Drejtorise se MZSH-se per blerje automjet zjarrfikes. Nga testimi dhe navigimi ne internet, rezultoi qe nuk ka asnje automjet zjarrfikes qe ploteson parametrat ne gjendje pune, I cili te gjendet ne treg me kete cmim.

**ii. Synimi i projektit**

*Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor*

Pajisja me mjetet e duhura per nje shërbim më te mirë dhe eficient i MZSH.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Procedura përgatitore
   - Hartimi i specifikimeve teknike per automjetin zjarrfikes
   - Hartimi i procedurave për kryerjen e shpenzimeve

**b) Rezultatet që prisni**

- Rritja e sigurisë së jetës dhe të pronës së qytetarëve
- Minimizimi i dëmeve që mund të shkatohen nga zjarri apo emergjencat e tjera
- Kryerjesipaskërkesaveishërbimit

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi | BashkiaShkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Blerje automjet zjarrfikses | 2000 | | | | | 2000 |

| **f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)**<br>Gjate vitit 2018 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria MZSH |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 19 | **Projekti : P3.F1.O1.A2 Riveshje e riparime me asfalt në rrugët kryesore dhe dytësore Qytet.**<br>**Buxheti i Bashkisë** | **Llojet e programit P3: Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në bashkine Shkodër.**<br><br>**Funksioni P3F1: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;** |

**a) Përshkrimi I shkurtër I projektit:**

**i. Situata ( Shpjego në menyrë të detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)**

**Problematika**

- Rritja e amortizimit vjetor në rrugët kryesore dhe dytësore të qytetit Shkodër sjell dhe nevoja per nderhyrje ne shtresat asfaltike;
- Shtimi i sipërfaqeve të asfaltuara në qytet si rezultat I investimeve të bashkisë Shkodër, të cilet kanë nevoj për ndërhyrje në shtresat asfaltike.
- Dëmtimet për shkak të shtrimit të rrjeteve të reja nëntokesore dhe riparimin e defekteve të tyre.
- Rritjen e standarteve të rrugëve për të ju përgjigjur rritjes së sigurisë rrugore.

**ii. Synimi I projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi I grupit të synuar)**

**Për vitin 2018.**

- Të sigurojë administrimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të bashkisë.
- Të përmirësoje infrastrukturen rrugore si dhe te rrise aksesin ndaj shërbimeve bazë në qytet.
- Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të automjeteve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni per të prodhuar rezultate)**

**Për vitin 2018**

- Riparimin e rreth 5000 m2 shtresa asfaltike në rrugët më të amortizuara dhe që kanë qarkullim më të madh për përdoruesit dhe bizneset në qytet;
- Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve;
- Përcaktimi i volumeve të punës;
- Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuar.
- Administrim te infrastruktures rrugore.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

**Për vitet 2018.**

- Sigurimi i qëndrueshmerise dhe funksionalitetit afatgjate te rrjetit rrugor nepermjet riparimit te shtresave.
- Rritjen e sigurise rrugore.
- Permirësimin e infrastruktures ne qytet.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| • Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.<br>• Sektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës.<br>• Inspektoret e lagjeve: 1, 2, 3, 4 dhe 5. | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018**<br>**Fondi tepricë nga prokurimet e vitit 2016 të transfertës specifike** | | Totali<br>( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.2 | **Riveshje e riparime me asfalt rruge kryesore dhe dytesore ne qytet.** | **12,000** | | | **12,000** | | |
| | **ShumaTotale** | **12,000** | | | **12,000** | | |

| | |
|---|---|
| **Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)**<br>Deri në fund të vitit 2018 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, Sektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës. |